

VJETARI STATISTIKOR RAJONAL 2019

Vjetari Statistikor Rajonal, 2019

Drejt看 botimi:
ELSA DHULI, PHD

Punoi: INSTAT

© *Copyright INSTAT 2019*

The views and conclusions contained in this publication do not necessarily reflect those of the Swiss Government or of the Swiss Agency for Development and Cooperation, SDC.

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2233358 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

PARATHËNIE DHE FALËNDERIME

Instituti i Statistikave ka kënaqësinë të prezantojë për përdoruesit e statistikave Vjetarin Statistikor Rajonal 2019, i cili përmban të dhëna për vitet 2016-2018. Nëpërmjet këtij publikimi, INSTAT paraqet një vështtrim gjithëpërfshirës të treguesve statistikorë më të rëndësishëm të vendit, në nivel qarku dhe bashkie.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është të paraqesë në një vëllim të vetëm një përmbledhje të plotë të statistikave sociale dhe ekonomike për të gjithë qarqet dhe bashkitë e vendit, për një periudhë të caktuar.

Vjetari Statistikor Rajonal është një botim i përbërë prej 160 faqesh, i ndarë në 18 kapituj, një kapitull përmbledhës për secilin qark dhe 17 kapituj tematikë, socialë dhe ekonomikë.

Risia e këtij botimi është pasurimi me tregues të rinj në nivel bashkie, duke përmbushur kështu premtimin se ky botim do të vijë duke u përmirësuar nga viti në vit me tregues dhe të dhëna të reja.

Statistikat e prezantuara janë përgatitur me kujdes të veçantë nga sektorët e specializuar të INSTAT dhe me mbështetjen dhe këshillimin e vazhdueshëm nga ekspertët e projektit SALSTAT “Për Statistika të forta Lokale Shqiptare”, në mënyrë që ky botim të jetë i krahasueshëm me vendet e tjera të Evropës. Falë numrit të konsiderueshëm të treguesve në nivel qarku dhe bashkie, Vjetari Statistikor Rajonal mbetet një nga botimet më të rëndësishme të INSTAT, pasi i vjen në ndihmë të gjithë përdoruesve, shoqërisë, vendimmarrësve lokalë dhe qendrorë, administratorëve, komunitetit të biznesit, studiuesve etj.

Ky botim është gjithashtu i disponueshëm në formatin PDF në faqen zyrtare të INSTAT.

Gjejmë rastin të falënderojmë SALSTAT dhe SDC “Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim” për partneritetin afatgjatë me INSTAT dhe mbështetjen e vazhdueshme që i është dhënë këtij institucioni për fuqizimin e statistikave lokale në Shqipëri.

Gjithashtu një falënderim i veçantë i dedikohet stafit të INSTAT për realizimin e këtij botimi.

Elsa Dhuli, PHD

Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar i INSTAT



PËRMBAJTJA

STRUKTURA ADMINISTRATIVE DHE NJËSITË TERRITORIALE TË SHQIPËRISË	5
PREFEKTURAT	11
1. POPULLSIA	23
2. LEJET E NDËRTIMIT	39
3. STATISTIKAT E TREGUT TË PUNËS	43
4. STATISTIKAT E KONSUMIT TË FAMILJEVE	51
5. NIVELI I JETESËS	61
6. ARSIMI	65
7. TREGUESIT SHËNDETËSOR	71
8. MBROJTJA SOCIALE	81
9. STATISTIKAT E KRIMEVE DHE DREJTËSISË PENALE	85
10. REGJISTRI STATISTIKOR I NDËRMARRJEVE	91
11. STRUKTURA E SHITJEVE NETO SIPAS RAJONEVE, 2017	99
12. BUJQËSIA	101
13. BLEGTORIA	127
14. TURIZMI	133
15. TRANSPORTI	139
16. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO	145
17. FINANCAT PUBLIKE	153



STRUKTURA ADMINISTRATIVE DHE NJËSITË TERRITORIALE TË SHQIPËRISË

(Një prezantim i strukturës administrative dhe njësive territoriale për qëllime statistikore në Shqipëri)

Pozita e përgjithshme gjeografike

Shqipëria është e pozicionuar në Evropën Juglindore, në perëndim të gadishullit të Ballkanit. Ajo ndodhet ndërmjet koordinatave gjeografike 39 gradë e 38 minuta (Konispol) dhe 42 gradë e 39 minuta gjerësi gjeografike (Vermosh) dhe 19 gradë e 16 minuta (Sazan) dhe 21 gradë e 40 minuta gjatësi gjeografike (Vernik).

Shqipëria ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 28.748 kilometra katrorë. Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 1094 km, nga të cilat 657 km kufi tokësor, 316 km kufi detar, 48 km kufi lumor dhe 73 km kufi liqenor. Kryeqyteti i vendit është Tirana.

Në pjesën veriore, Shqipëria kufizohet me Malin e Zi, në veri-lindje kufizohet me Kosovën, në lindje kufizohet nga Maqedonia e Veriut, ndërsa në jug kufizohet me Greqinë. Në pjesën perëndimore, Shqipëria ka si kufij natyrorë detet Adriatik dhe Jon.

Ndarja administrativo-territoriale e Shqipërisë

Ndarja administrative dhe tokësore e Shqipërisë ka pësuar ndryshime të vazhdueshme përgjatë të gjithë ekzistencës së shtetit shqiptar si për sa i përket shtrirjes gjeografike ashtu edhe sa i përket funksioneve të strukturave. Në mjaft raste, ndarja administrative ka qenë e karakterit eksperimental.

Ajo ka pësuar ndryshime që nga formimi i qeverisë së parë shqiptare në vitin 1912 dhe për të vijuar me një varg të pafund ndryshimesh. Ndryshime të shumta kanë ndodhur në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore dhe veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore.

Ndryshime jo të pakta kanë ndodhur dhe pas ndryshimeve politiko-ekonomike të vendit pas vitit 1990. Vetëm në periudhën 1992-2014, ndarja administrative-territoriale e vendit ka pësuar tri ndryshime rrënjësore, qoftë nga përbërja strukturore dhe ashtu nga ajo funksionale e njësive administrative.

Në 31 korrik 2014, me vendim të Parlamentit shqiptar u miratua organizimi i ri administrativo-territorial që e

ndan vendin në 12 qarqe dhe 61 bashki me nëndarjet e parashikuara në ligj¹. Ligji i ri nuk bëri ndryshime lidhur me qarqet; numri i tyre mbeti 12. Rrethi si nëndarje e qarkut, u shkri, por ai u mor si një nga kriteret bazë për përcaktimin e ndarjes së re administrative. Ndërsa ish-komunat dhe bashkitë e vjetra vazhdojnë të jenë funksionale dhe njihen si njësi administrative përbërëse të bashkive të reja.

Me ligjin e ri, bashkia e Tiranës formohet nga bashkimi i 14 ish-komunave e bashkive, teksa njësité e mëparshme minibashkiake kanë ndërruar emërtim dhe funksion, pasi tani ato kanë statusin e njësive administrative.

Në tabelën 1 jepet lista e qarqeve sipas ndarjes administrativo-territoriale e vitit 2014, ndërsa në tabelën 2 jepen bashkitë në përbërje të qarqeve. Ndërkohë që referuar ligjit 115/2014, vetë bashkitë ndahen në nënjësi më të vogla të cilësuar si njësi administrative. Në përbërje të tyre janë qytetet dhe fshatrat.

Tabela 1 - Lista e qarqeve

01	Berat
02	Dibër
03	Durrës
04	Elbasan
05	Fier
06	Gjirokastrë
07	Korçë
08	Kukës
09	Lezhë
10	Shkodër
11	Tiranë
12	Vlorë

Burimi: Fletorja Zyrtare 137/2014

1. Ligji 115/2014 "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

Tabela 2 - Lista e bashkive në përbërje të qarqeve

01	Berat	32	Dropull
02	Ura Vajgurore	33	Korçë
03	Kucovë	34	Pogradec
04	Skrapar	35	Maliq
05	Poliçan	36	Pustec
06	Dibër	37	Kolonjë
07	Bulqizë	38	Devoll
08	Mat	39	Kukës
09	Klos	40	Tropojë
10	Durrës	41	Has
11	Shijak	42	Lezhë
12	Krujë	43	Mirditë
13	Eelbasan	44	Kurbin
14	Cërrik	45	Shkodër
15	Belsh	46	Vau i Dejës
16	Peqin	47	Malësi e Madhe
17	Gramsh	48	Pukë
18	Librazhd	49	Fushë Arrëz
19	Prrenjas	50	Tiranë
20	Fier	51	Kamëz
21	Lushnje	52	Vorë
22	Patos	53	Kavajë
23	Roskovec	54	Rrogozhinë
24	Divjakë	55	Vlorë
25	Mallakastër	56	Himarë
26	Gjirokastër	57	Sarandë
27	Libohovë	58	Konispol
28	Përmet	59	Delvinë
29	Këlcyre	60	Finiq
30	Tepelenë	61	Selenicë
31	Memaliaj		

Burimi: Fletorja Zyrtare 137/2014

Shkalla e urbanizimit (DEGURBA)

Shkalla e urbanizimit (DEGURBA) është një klasifikim i njësive të qeverisjes vendore (Local Government Units - LAU), që tregon karakteristikat e një hapësire të caktuar bazuar në popullsinë e rrjetit të qelizave prej 1 km².

Ky klasifikim është aprovuar nga Eurostat-i (Zyra e Statistikave e Bashkimit Evropian) në vitin 2011 dhe që aplikohet për njësitë e qeverisjes vendore të Bashkimit Evropian. Klasifikimi përditësohet çdo vit, duke marrë

në konsideratë ndryshimet e mundshme në kufijtë e njësive vendore.

Sipas këtij klasifikimi, njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë në rastin e Shqipërisë) ndahen në tre kategori:

1. Zona me dendësi të lartë (qytete apo zona të mëdha urbane): të paktën 50% e popullsisë jeton në grumbullime me densitet të lartë.

2. Zonat me dendësi të ndërmjetme (qytetet dhe periferitë apo zonat e vogla urbane): më pak se 50% e popullsisë që jeton në rrjetin e qelizave rurale dhe më pak se 50 % e tyre jeton në grumbullime me densitet të lartë.

3. Zonat me dendësi të ulët (zonat rurale): më shumë se 50 % e popullsisë jeton në rrjetin e qelizave rurale.

Përpjekja e parë për të klasifikuar rajonet në Shqipëri bazuar në këtë qasje është bërë në vitin 2014. Për të klasifikuar njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri u përdorën të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 . Kjo qasje e re për klasifikimin e njësive të qeverisjes vendore (LAU 2) bazuar në rrjetin e qelizave prej 1 km² duket se është e përshtatshme për vendin, duke ofruar mundësinë e krahasimit të Shqipërisë me vendet e Bashkimit Evropian deri në nivelin më të ulët. Asokohe, komunat dhe bashkitë (sipas ndarjes administrative-territoriale të vitit 2000) korrespondojnë me LAU2 në BE.

Metoda e përdorur për klasifikimin e 373 komunave dhe bashkive sipas shkallës së tyre të urbanizimit ka ndjekur të njëjtën procedure dhe të njëjtat hapa të përdorur për klasifikimin e njësive të qeverisjes vendore të vendeve të BE-së.

Metodika e mësipërme u përdor për të riklasifikuar njësitë administrative në Shqipëri pas miratimit të ndarjes së re administrative-territoriale të Shqipërisë në vitin 2014, që e ndan vendin në 12 qarqe dhe 61 bashki.

Zyra e Statistikave e Bashkimit Evropian (Eurostat) ka bërë përllogaritjet për vitin 2019 bazuar në të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 për të dhënë një tablo të realitetit në Shqipëri në lidhje me shkallën e urbanizimit . Referuar përllogaritjeve të Eurostat-it, vetëm 6 bashki mund të klasifikohen në kategorinë e parë “Zona me dendësi të lartë”. Bashkitë e reja janë: Tirana, Elbasani, Durrësi, Shkodra, Vlora dhe Kamza.

http://www.instat.gov.al/media/2919/a_new_urban-rural_classification_of_albanian_population.pdf
<https://ec.europa.eu/eurostat/web/nuts/local-administrative-units>

Katërmëdhjetë bashki të tjera klasifikohen në kategorinë e dytë, “Zona me dendësi të ndërmjetme” dhe 41 bashkitë e tjera klasifikohen si “Zonat me dendësi të ulët”.

DEGURBA bazuar në të dhënat e Censurit 2011

Për të klasifikuar njësité e qeverisjes vendore bazuar në klasifikimin e përdorur në Bashkimin Evropian është përdorur popullsia sipas rrjetit të qelizave prej 1 km².

Shkalla e urbanizimit i ndan bashkitë në tri kategori:


Zona me dendësi të lartë - Grumbullimet me dendësi të lartë ose grumbullimet urbane u identifikuan duke përzgjedhur dhe grupuar qelizat e rrjetit me dendësi të popullsisë më të madhe se 1500 banorë për km² dhe duke përzgjedhur grupet me popullsi më të madhe se 50 mijë banorë. Si rezultat u identifikuan 6 bashki me të paktën 50% të popullsisë, e cila jeton në grumbullime me dendësi të lartë ose grumbullime urbane. Gjashtë bashkitë që formojnë zonat me dendësi të lartë në Shqipëri janë: Tirana, Elbasani, Durrësi, Shkodra, Vlora dhe Kamza. Këto zona me dendësi të lartë përfshijnë një popullsi prej 1.218.875 banorësh sipas të dhënave të Censurit 2011. Në terma përqindje, 43,5% e popullsisë në Shqipëri banon në zona me dendësi të lartë.

Zonat me dendësi të ndërmjetme - Duke ndjekur të njëjtën procedurë janë identifikuar ato bashki ku më pak se 50% e popullsisë jeton në zonat me dendësi të lartë ose grumbullimet urbane. Nga analiza rezultoi se në Shqipëri janë 14 bashki të klasifikuara si “Zona me dendësi të ndërmjetme” me një numër të përgjithshëm të popullsisë prej 634.472 banorësh bazuar kjo në të dhënat e Censurit 2011. Në këto njësi të qeverisjes vendore banon 22,6% e popullsisë së Shqipërisë.

Zonat me dendësi të ulët - Pjesa e mbetur e bashkive (41) klasifikohen në kategorinë e tretë, zona me dendësi të ulët, duke qenë se më shumë se 50% e popullsisë në këto njësi jeton në rrjetin e qelizave rurale. Kështu, popullsia rurale llogaritet 964.791 banorë, ose përbën 33,9% të popullsisë së Shqipërisë sipas të dhënave të Censurit 2011.

Harta 1 tregon klasifikimin e bashkive të Shqipërisë sipas shkallës së urbanizimit.

Harta 1 - Shkalla e Urbanizimit bazuar në Censusin e Popullsisë dhe Banesave 2011



Sistemi koordinativ: ETRS 1989 LAEA

Rajonet zhvillimore

Përtej ndarjes administrativo-territoriale dhe rajoneve statistikore, në Shqipëri përdoren dhe klasifikime të tjera. Që nga viti 2015 në Shqipëri janë miratuar me ligj dhe rajonet zhvillimore.

Me vendim të Këshillit të Ministrave është miratuar krijimi i Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal.

Bazuar në vendimin Nr. 961, datë 2.12.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, Shqipëria ndahet në katër rajone zhvillimore, AZHR 1 me qendër në Shkodër, AZHR 2 me qendër në Tiranë, AZHR 3 në Korçë dhe AZHR 4 me qendër në Vlorë.

Table 4. Development Regions in Albania


AZHR 1	Shkodër
	Lezhë
	Kukës
AZHR 2	Tiranë
	Durrës
	Dibër
AZHR 3	Elbasan
	Berat
	Korçë
AZHR 4	Vlorë
	Fier
	Gjirokastrë

Burimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit




Qarku i Beratit

Prodhuesi më i madh i ullinjve



Numri i popullsisë	126.294
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	0,3
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-7,8
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	63,4
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	8,3
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	70.737
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	40.854
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	9.035
Numri i gjedhëve (blegtori)	24.460
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	451
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	153
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	44
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	11,0

Përlllogaritjet e INSTAT



Qarku i Beratit

4,4 % e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë në vitin 2018 jetonte në Qarkun Berat (rajoni statistikor NUTS 3). Kjo popullsi shtrihet në 5 nga 61 bashkitë e vendit. Në këtë qark pati një rënie të numrit të popullsisë me 984 persona, për shkak të migrimit të brendshëm neto duke ndjekur kështu rajonin NUTS 3 (Qarku Dibër), i cili është rajoni statistikor me rënien më të madhe në nivel vendi. Mosha mediane e popullsisë ishte 38,3 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9 vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 4,5 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Beratit është 11 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Skraparit ka raportin më të ulët prej 6,4 nxënës për mësues, ndërsa

raportin më të lartë e ka bashkia e Beratit me 12,1 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në qarkun e Beratit është 5,0 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 8,3 %. Paga mesatare mujore është 40.854 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 është 70.737 Lekë për familje (NjEF). Berati kishte 3,8 % të PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar 0,06 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 451 mijë Lekë [për Qarkun Berat] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 9.035. Në qarkun e Beratit u miratuan 44 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Berat	5	60	-352	41.450	4.250	19	12,1
Ura Vajguore	4	84	-70	36.655	9.150	10	11,7
Poliçan	3	-14	-148	39.756	2.680	2	10,3
Skrapar	9	-43	-252	42.557	3.650	2	6,4
Kuçovë	4	-53	-162	41.037	4.730	11	11,1

Përlllogaritjet e INSTAT


Qarku i Dibrës



Konsumi më i lartë i pijeve alkoolike dhe duhanit



Numri i popullsisë	119.963
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	5,4
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-13,6
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	57,8
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	5,9
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	58,461
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	46.178
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	2.916
Numri i gjedhëve (blegtori)	44.000
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	405
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	103
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	34
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	10,4



Përlllogaritjet e INSTAT

Qarku i Dibrës

4,3% e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë në vitin 2018 jetonte në Qarkun Dibrë (rajoni statistikor NUTS 3). Kjo popullsi shtrihej në 4 nga 61 bashkitë e vendit. Dibra pati një rënie të numrit të popullsisë me 1,632 persona për shkak të migrimit të brendshëm neto, duke qenë kështu qarku me rënien më të lartë në vend. Mosha mediane e popullsisë ishte 34,9 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 4,8 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Dibrës është 10,4 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Klosit ka raportin më të ulët prej 8,4 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bashkia e Bulqizës me 11,1 nxënës

për mësues. Numri i të punësuarve në Qarkun Dibrë është 4,2 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 5,9 %, po aq sa norma e qarkut të Korçës, duke përfaqësuar kështu normën më të ulët në vend. Paga mesatare mujore është 46.178 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 është 58.461 Lekë për familje (NjEF). Dibra ka 3,2 % të PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar 0,06 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 405 mijë Lekë [për Qarkun Dibrë] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 2.916. Në qarkun e Dibrës u miratuan 34 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) Shkollat
Dibër	15	394	-804	47.967	16.800	22	11,0
Bulqizë	8	175	-326	45.404	8.600	7	11,1
Mat	8	29	-309	45.562	9.500	3	9,3
Klos	4	52	-193	40.453	9.100	2	8,4

Përlllogaritjet e INSTAT

Qarku i Durrësit




I dyti për nga numri i automjeteve të pasagjerëve për 1,000 banorë



Numri i popullsisë	289.877
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	3,5
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	2,8
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	54,2
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	13,8
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	75.744
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	41.636
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	12.921
Numri i gjedhëve (blegtori)	28.955
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	536
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	201
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	156
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	16,2

Përlogaritjet e INSTAT



Qarku i Durrësit


Qarku i Durrësit (rajoni statistikor NUTS 3) është qarku i tretë më i madh në vend, ku jeton 10,1 % e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë për vitin 2018. Kjo popullsi shtrihet në 3 nga 61 bashkitë e vendit. Durrësi, sikurse dhe Tirana, është qarku i vetëm që ka përjetuar një rritje të popullsisë nga migrimi i brendshëm neto, me gjithsej 816 persona. Mosha mediane e popullsisë ishte 36,0 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 10,7 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Durrësit është 16,2 nxënës për mësues, duke përfaqësuar kështu raportin më të lartë pas qarkut të Tiranës. Ky raport varion sipas bashkive, ku ajo e Shijakut ka raportin më të ulët prej 13,8 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bashkia

e Durrësit me 17,2 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në Qarkun Durrës ishte 7,5 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë ishte 13,8 %, duke qenë në nivelin e normës mesatare të vendit. Paga mesatare mujore ishte 41.636 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 75.744 Lekë për familje (NjEF). Durrësi arriti 9,9 % të PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar 0,40 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 536 mijë Lekë [për Qarkun Durrës] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 12.921. Në qarkun e Durrësit u miratuan 156 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.

Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) Shkollat
Durrës	6	660	1,019	41.636	14.632	104	17,2
Shijak	4	60	17	38.926	4.263	48	13,8
Krujë	6	292	-220	43.009	10.060	4	14,7

Përlogaritjet e INSTAT

Qarku i Elbasanit



Numri i popullsisë	276.765
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	2,7
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-4,6
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	65,8
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	6,6
Shpenzimet mesatare mujore për NJEF (Lek)	63.847
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	43.115
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	13.419
Numri i gjedhëve (blegtori)	56.040
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	377
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	116
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	88
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	10,6



Përlogaritjet e INSTAT

Qarku i Elbasanit


9,7 % e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë në vitin 2018 jetonte në Qarkun Elbasan (rajoni statistikor NUTS 3). Kjo popullsi shtrihet në 7 nga 61 bashkitë e vendit. Qarku i Elbasanit, sikurse pjesa më e madhe e qarqeve të Shqipërisë, pati një rënie të numrit të popullsisë me 1,272 persona (vlëra e dytë më e ulët në vend) për shkak të migrimit të brendshëm neto. Mosha mediane e popullsisë ishte 37,1 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 9,8 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në vend. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Elbasanit është 10,6 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Gramshit ka raportin më të ulët prej 7,7 nxënës për mësues, ndërsa

raportin më të lartë e ka bashkia e Prrenjast me 11,9 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në qarkun e Elbasanit është 11,4 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 6,6 %. Paga mesatare mujore ishte 43.115 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 63.847 Lekë për familje (NJEF). Elbasani arriti 6,8 % të PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar me 0,05 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 377 mijë Lekë [për Qarkun Elbasan] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 13.419. Në qarkun e Elbasanit u miratuan 88 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Elbasan	13	333	-281	43.339	16.682	26	11,6
Belsh	5	20	-65	33.973	5.257	1	10,7
Cërrik	5	46	-104	35.373	5.571	16	11,1
Gramsh	10	68	-287	44.779	7.314	0	7,7
Librazhd	7	121	-280	45.580	8.842	28	8,8
Prrnjas	4	97	-156	38.900	5.714	6	11,9
Peqin	6	54	-99	47.108	6.700	11	10,2

Përlogaritjet e INSTAT

Qarku i Fierit



Numri i popullsisë	296.446
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	0,5
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-3,0
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	64,9
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	9,1
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	71.117
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	40.854
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	21.621
Numri i gjedhëve (blegtori)	24.460
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	556
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	153
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	129
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	11,0



Përlogaritjet e INSTAT

Qarku i Fierit

Qarku i Fierit (rajoni statistikor NUTS 3), në vitin 2018, kishte 10,3 % të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë, duke qenë kështu qarku i dytë më i madh në vend pas Tiranës. Popullsia e qarkut të Fierit shtrihet në 6 nga 61 bashkitë e vendit. Pavarësisht kësaj, Qarku Fier pati një rënie të numrit të popullsisë me 983 persona për shkak të migrimit të brendshëm neto. Moshë mediane e popullsisë ishte 37,3 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 10,2% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Fierit është 11,0 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Mallakastrës ka raportin më të ulët prej 10 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bashkia e Patosit me 12,6 nxënës

për mësues. Fieri, së bashku me Elbasanin, ka një përqindje të lartë të personave të punësuar. Numri i të punësuarve në qarkun e Fierit është 11,8 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 9,1 %. Paga mesatare mujore ishte 46.808 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 71.117 Lekë për familje (NjEF). Fieri është një nga qarqet ekonomike kryesore në Shqipëri. Ky qark arriti 10,8 % të PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar me 0,18 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 556 mijë Lekë [për Qarkun Fier] ishte më e lartë se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 21.631. Në qarkun e Fierit u miratuan 129 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Fier	10	11	-289	50.752	18.688	47	12,3
Patos	3	-13	209	52.477	1.681	7	12,6
Roskovec	4	44	-50	33.047	6.105	4	11,3
Lushnje	11	32	-309	38.040	23.540	40	11,3
Divjakë	5	71	-42	33.115	15.665	27	11,6
Mallakastrë	9	7	-412	39.665	3.030	4	10,0

Përlogaritjet e INSTAT


Qarku i Gjirokastrës



Numri më i ulët i gjedhëve



Numri i popullsisë	62.188
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	-3,5
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-13,4
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	59,2
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	8,7
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	66.238
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	45.241
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	4.771
Numri i gjedhëve (blegtori)	19.667
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	548
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	171
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	40
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	8,6



Përlllogaritjet e INSTAT

Qarku i Gjirokastrës

Qarku i Gjirokastrës (rajoni statistikor NUTS 3) është qarku më i vogël në Shqipëri për sa i takon numrit të popullsisë. Në vitin 2018, ky qark kishte 2,2 % të popullsisë së përgjithshme të vendit. Kjo popullsi shtrihet në 7 nga 61 bashkitë e vendit. Qarku përjetoi një rënie të numrit të popullsisë me 836 persona për shkak të migrimit të brendshëm neto. Moshë mediane e popullsisë ishte 39,4 vjeç, duke qenë kështu vlera më e lartë krahasuar me qarqet e tjera. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 2,1% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Gjirokastrës është 8,6 nxënës për mësues, e cila është vlera më e ulët në të gjithë qarqet. Ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Dropullit ka raportin më të ulët prej 5,2 nxënës për mësues, ndërsa bashkia e Gjirokastrës ka raportin

më të lartë me 11,2 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në qarkun e Gjirokastrës është 2,3 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, duke përfaqësuar, së bashku me Kukësin, normën më të ulët në vend, ndërsa norma e papunësisë është 8,7 %. Paga mesatare mujore ishte 45.241 Lekë. ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 66.238 Lekë për familje (NjEF). Gjirokastra përfaqësonte 2,3 % të PBB-së së Shqipërisë për vitin 2017, me një kontribut në terma realë prej 0,03 % për atë vit, ndërsa PBB për frymë prej 548 mijë Lekë [për Qarkun Gjirokastrë] ishte më e lartë se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 4.771. Në qarkun e Gjirokastrës u miratuan 40 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Gjirokastrë	7	-13	-163	45.307	5.523	6	11,2
Libohovë	3	-9	-9	42.002	1.907	2	7,9
Dropull	3	-85	4	52.458	1.551	16	5,2
Tepelenë	4	-9	-175	46.090	4.700	6	7,2
Memaliaj	6	-19	-248	39.990	3.200	2	6,4
Përmet	5	-60	-133	38.398	1.605	8	8,6

Përlllogaritjet e INSTAT


Qarku i Korçës



Prodhuesi më i madh i pemëve frutore



Numri i popullsisë	209.034
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	-2,2
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-4,0
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	63,2
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	5,9
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	74.319
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	41.144
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	14.035
Numri i gjedhëve (blegtori)	41.698
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	403
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	112
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	100
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	11,1



Përlogaritjet e INSTAT

Qarku i Korçës


Qarku i Korçës (rajoni statistikor NUTS 3), në vitin 2018, kishte 7,3 % të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Kjo popullsi shtrihet në 6 nga 61 bashkitë e vendit. Qarku pati një rënie të numrit të popullsisë me 844 persona për shkak të migrimit të brendshëm neto. Moshë mediane e popullsisë ishte 36,5 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 6,8% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Korçës është 11,1 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Pustecit ka raportin më të ulët prej 5 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bashkia e Korçës me 11,9 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në Qarkun Korçë është 8,3 % e numrit

të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 5,9 %, po aq sa norma e qarkut të Dibrës, duke përfaqësuar kështu normën më të ulët në vend. Paga mesatare mujore ishte 41.144 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 74.319 Lekë për familje (NjEF). Korça kontribuoi me 5,5 % në strukturën e PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar minus 0,13 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 403 mijë Lekë [për Qarkun Korçë] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 14.035. Në qarkun e Korçës u miratuan 100 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Korçë	8	-326	-242	42.326	8.791	65	11,9
Maliq	7	-56	-149	33.662	9.999	8	10,7
Pustec	1	-27	3	38.192	1.745	0	5,0
Devoll	5	-67	-79	38.239	4.052	7	10,8
Kolonjë	8	-45	-109	45.273	8.317	0	7,4
Pogradec	8	66	-268	40.856	8.794	20	11,5

Përlogaritjet e INSTAT

Qarku i Kukësit



Numri i popullsisë	76.994
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	5,8
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-8,8
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	57,2
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	7,5
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	66.326
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	46.499
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	1.974
Numri i gjedhëve (blegtori)	40.514
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	327
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	130
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	6
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	10,3



Përlllogaritjet e INSTAT

Qarku i Kukësit

Qarku i Kukësit (rajoni statistikor NUTS 3) është qarku i dytë më i vogël në Shqipëri për sa i takon numrit të popullsisë. Ky qark kishte 2,7 % të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë në vitin 2018. Kjo popullsi shtrihet në 3 nga 61 bashkitë e vendit. Qarku përjetoi një rënie të numrit të popullsisë me 677 persona për shkak të migrimit të brendshëm neto. Mosha mediane e popullsisë ishte 35,5 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 3,3 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në vend, vlera e dytë më e vogël pas Gjirokastrës. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Kukësit është 10,3 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Tropojës ka raportin më të ulët prej 8 nxënës për mësues, ndërsa


raportin më të lartë e ka bashkia e Hasit me 11,9 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në qarkun e Kukësit është 2,6 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 7,5 %. Paga mesatare mujore ishte 46.499 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 66.326 Lekë për familje (NjEF). Kukësi kontribuoi me 1,7 % në strukturën e PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar minus 0,01 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 327 mijë Lekë [për Qarkun Kukës] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 1.974. Në qarkun e Kukësit u miratuan 6 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.

Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Kukës	15	315	-396	47.463	16.994	0	10,9
Has	4	100	-117	43.409	10.320	0	11,9
Tropojë	8	35	-164	45.764	13.200	6	8,0

Përlllogaritjet e INSTAT


Qarku i Lezhës

Qarku i dytë për nga shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç



Numri i popullsisë	125.998
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	3,1
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-2,3
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	56,5
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	19,2
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	72.852
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	39.563
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	5.402
Numri i gjedhëve (blegtori)	33.105
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	401
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	190
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	57
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	12,0

Përlllogaritjet e INSTAT



Qarku i Lezhës

4,4 % e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë në vitin 2018 jetonte në Qarkun Lezhë (rajoni statistikor NUTS 3). Kjo popullsi shtrihej në 3 nga 61 bashkitë 61 Gjithsej. Qarku përjetoi një rënie të numrit të popullsisë me 288 persona për shkak të migrimit të brendshëm neto. Moshë mediane e popullsisë ishte 37,1 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 4,8 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Lezhës është 12 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Mirditës ka raportin më të ulët prej 8,8 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bashkia e Kurbinin me një raport prej 13,1 nxënës

për mësues. Numri i të punësuarve në qarkun e Lezhës është 3,8 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 19,2 %. Paga mesatare mujore ishte 39.563 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 72.852 Lekë për familje (NjEF). Lezha kontribuoi me 3,3 % në PBB-në e Shqipërisë për atë vit, duke kontribuar në terma realë me minus 0,03 % për atë vit, ndërsa PBB për frymë prej 401 mijë Lekë [për Qarkun Lezhë] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 5.402. Në qarkun e Lezhës u miratuan 57 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Lezhë	10	230	226	40.290	17.660	32	12,5
Kurbin	4	158	-266	36.759	11.205	14	13,1
Mirditë	7	-1	-248	41.053	4.240	11	8,8

Përlllogaritjet e INSTAT


Qarku i Shkodrës



Përqindja më e lartë e nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme private krahasuar me ato publike



Numri i popullsisë	203.945
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	0,8
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-2,3
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	63,8
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	11,9
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	73.441
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	39.427
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	11.309
Numri i gjedhëve (blegtori)	42.042
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	389
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	187
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	89
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	9,4



Përlllogaritjet e INSTAT

Qarku i Shkodrës

Në vitin 2018, 7,1 % e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë jetonte në Qarkun Lezhë (rajoni statistikor NUTS 3). Kjo popullsi shtrihej në 5 nga 61 bashkitë e vendit. Qarku përjetoi një rënie të popullsisë nga migrimi i brendshëm neto me 460 persona. Mosha mediane e popullsisë ishte 36,5 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 7,0 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Korçës është 9,4 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Fushë Arrëzës ka raportin më të ulët prej 6,1 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bashkia e Shkodrës me 10,4 nxënës për mësues. Numri i të

punësuarve në qarkun e Shkodrës është 7,7 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 11,9 %. Paga mesatare mujore është 39.427 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 është 73.441 Lekë për familje (NjEF). Shkodra kontribuoi me 5,5 % në strukturën e PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar minus 0,02 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 389 mijë Lekë [për Qarkun Shkodër] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 11.309. Në qarkun e Shkodrës u miratuan 89 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Shkodër	11	66	95	38.784	17.750	54	10,4
Vau i Dejës	6	58	-40	36.572	9.775	17	9,4
Malësi e Madhe	6	8	-71	43.855	7.130	16	8,0
Pukë	5	16	-289	46.598	4.087	2	7,0
Fushë Arrëz	5	17	-155	38.427	3.300	0	6,1

Përlllogaritjet e INSTAT


Qarku i Tiranës



Shkalla më e lartë e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë



Numri i popullsisë	889.578
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	5,0
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	8,1
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	54,7
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	16,0
Shpenzimet mesatare mujore për NjEF (Lek)	88.691
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	57.533
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	53.767
Numri i gjedhëve (blegtori)	41.710
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	747
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	215
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	388
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	17,1



Përlogaritjet e INSTAT

Qarku i Tiranës

Qarku i Tiranës (rajoni statistikor NUTS 3) është më i madhi në vend, bazuar në shifrat e vitit 2018. Popullsia e këtij qarku ishte 31,0 % e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë për vitin 2018. Kjo popullsi shtrihet në 5 bashki. Qarku ka përjetuar rritjen më të madhe të popullsisë në vend nga migrimi i brendshëm neto. Kjo rritje ishte në numrin 7,193 persona. Mosha mediane e popullsisë ishte 34,7 vjeç, duke qenë kështu vlera më e ulët krahasuar me qarqet e tjera. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 30,3 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në vend. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Tiranës është 17,1 nxënës për mësues, duke përfaqësuar kështu raportin më të lartë. Ky raport është i ndryshëm ndërmjet bashkive, ku ajo e Rrogozhinës ka raportin më të ulët me 8,9 nxënës për

mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bashkia Kamëz me 20 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në qarkun e Tiranës është 27,4 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 16,0 %. Paga mesatare mujore ishte 57.533 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 88.691 Lekë për familje (NjEF). Tirana kontribuoi me 42,0 % të PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar 3,42 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 747 mijë Lekë [për Qarkun e Tiranës] ishte më e lartë se mesatarja në nivel vendi. Tirana është qarku me numrin më të lartë të ndërmarrjeve në vend me 53.767. Në qarkun e Tiranës u miratuan 388 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.


Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Tiranë	14	3361	6,690	59.248	20.638	179	17,8
Kamëz	2	899	492	36.184	3.387	88	20,0
Vorë	3	194	96	44.323	2.925	71	14,0
Kavajë	5	-8	38	39.622	8.140	43	10,9
Rrogozhinë	5	-37	-123	39.285	6.620	7	8,9

Përlogaritjet e INSTAT


Qarku i Vlorës



Prodhuari më i madh i agrumeve



Numri i popullsisë	126.294
Shkalla e shtesës natyrore të popullsisë për 1,000 banorë	0,3
Shkalla e migrimit të brendshëm neto për 1,000 banorë	-7,8
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, popullsia mbi 15 vjeç	63,4
Shkalla e papunësisë, popullsia mbi 15 vjeç	21,9
Shpenzimet mesatare mujore për NJEF (Lek)	68.227
Paga mesatare mujore për personat e punësuar (Lek)	41.848
Numri i ndërmarrjeve/njësive vendore aktive	11.655
Numri i gjedhëve (blegtori)	24.460
PBB rajonale për frymë (mijë Lekë)	454
Automjetet e pasagjerëve për 1,000 banorë	153
Lejet e miratuara të ndërtimit për ndërtesat e reja	63
Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)	11,0



Përlllogaritjet e INSTAT

Qarku i Vlorës

Qarku i Vlorës (rajoni statistikor NUTS 3), në vitin 2018, kishte 6,6 % të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Kjo popullsi shtrihet në 7 bashki. Qarku pati një rënie të numrit të popullsisë me 123 persona për shkak të migrimit të brendshëm neto. Kjo shifër është me ulëta në vend për sa i takon Qarqeve që kanë pasur ulje të popullsisë për shkak të migrimi të brendshëm. Mosha mediane e popullsisë ishte 38,0 vjeç. Numri i nxënësve që ndiqnin arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqëson 5,8 % të numrit të përgjithshëm të nxënësve në Shqipëri. Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) për qarkun e Vlorës është 12 nxënës për mësues, por ky raport varion në bashki të ndryshme, ku ajo e Finiqit ka raportin më të ulët prej 6,2 nxënës për mësues, ndërsa raportin më të lartë e ka bash-

kia e Sarandës me 17,5 nxënës për mësues. Numri i të punësuarve në qarkun e Vlorës është 6,4 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Shqipëri, ndërsa norma e papunësisë është 21,9 %, më e larta krahasuar me qarqet e tjera. Paga mesatare mujore ishte 41.848 Lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas Anketës së Buxhetit të Familjes së vitit 2018 ishin 68.227 Lekë për familje (NJEF). Vloa kontribuoi me 5,5 % në strukturën e PBB-së në Shqipëri për vitin 2017, duke kontribuar minus 0,19 % në terma realë për atë vit, kurse PBB për frymë prej 454 mijë Lekë [për Qarkun Vlorë] ishte më e ulët se mesatarja në nivel vendi. Numri i ndërmarrjeve në këtë qark ishte 11.655. Në qarkun e Vlorës u miratuan 63 leje ndërtimi për ndërtesa të reja gjatë vitit 2018.

Bashkitë	Nr. Njësive administrative	Shtesa natyrore e popullsisë	Migrimi i brendshëm neto	Paga mesatare mujore për personat e punësuar	Nr. i gjedhëve (blegtori)	Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesat e reja	Raporti nxënës për mësues në arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar)
Vlorë	5	-98	-116	42.630	6.985	3	12,6
Selenicë	6	-50	-19	42.709	5.354	1	8,5
Himarë	3	-65	30	33.954	3.000	5	9,8
Sarandë	2	44	106	40.984	2.226	48	17,5
Finiq	5	-92	38	37.414	2.627	3	6,2
Delvinë	2	-7	-144	41.848	2.090	1	8,3
Konispol	3	-17	-18	38.216	4.136	2	10,8

Përlllogaritjet e INSTAT



1. POPULLSIA

Ndryshimi i popullsisë

Popullsia e Shqipërisë ka ardhur duke u zvogëluar që nga viti 2001, megjithëse jo të gjitha qarqet kanë ndjekur këtë prirje. Gjatë vitit të kaluar, popullsia e Shqipërisë u ul nga 2.873.458 në 2.866.376 banorë. Në vitin 2018, qarku me popullsinë më të lartë në Shqipëri është ai i Tiranës, me 889.578 banorë, i ndjekur nga qarku i Fierit me 296.446 banorë. Në të njëjtën kohë, dy qarqet me popullsinë më të ulët në vitin 2018 ishin ato të Kukësit dhe Gjirokastrës, respektivisht me 76.994 dhe 62.188 banorë.


Tab.1 Popullsia sipas qarqeve dhe norma e rritjes së popullsisë, 2017-2018

Qarku	2017	2018	Norma e rritjes së popullsisë
Berat	129.687	126.294	-2,62%
Dibër	123.279	119.963	-2,69%
Durrës	287.226	289.877	0,92%
Elbasan	281.185	276.765	-1,57%
Fier	300.326	296.446	-1,29%
Gjirokastrë	64.446	62.188	-3,50%
Korçë	212.250	209.034	-1,52%
Kukës	78.477	76.994	-1,89%
Lezhë	127.910	125.998	-1,49%
Shkodër	206.459	203.945	-1,22%
Tiranë	873.179	889.578	1,88%
Vlorë	189.039	189.297	0,14%
Shqipëria	2.873.458	2.866.376	-0,25%

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT


Gjatë vitit 2018 vetëm popullsitë e qarqeve të Tiranës, Durrësit dhe Vlorës janë rritur, ndërsa të gjitha qarqet e tjera kishin një normë negative të rritjes së popullsisë. Qarku i Tiranës ka pasur nivelin më të lartë të rritjes së popullsisë gjatë vitit 2018, pasi u rrit me 1,88 % krahasuar me vitin 2017. Nga ana tjetër, qarku me normën më të ulët të rritjes së popullsisë ishte ai i Gjirokastrës, me - 3,50 %, gjatë vitit 2018.

Fig. 1 Norma e rritjes së popullsisë, 2017-2018 (%)



Burimi: Estimimi nga INSTAT

Gjatë vitit 2018 vetëm popullsia e 15 bashkive është rritur, duke marrë parasysh rritjen natyrore të popullsisë dhe migracionin e brendshëm neto, ndërsa të gjitha bashkitë e tjera të mbetura patën një rritje negative të popullsisë pa migracionin ndërkombëtar. Bashkia e Tiranës ka pasur rritjen më të lartë të popullsisë pa migracionin ndërkombëtar, gjatë vitit 2018, pasi u rrit me 10.051 banorë, e ndjekur nga bashkia Durrës, e cila u rrit me 1.679 banorë. Nga ana tjetër, bashkia Korçë ka rritjen më të ulët të popullsisë pa migracionin ndërkombëtar gjatë vitit 2018, pasi ajo u ul me 568 banorë, e ndjekur nga bashkia Dibër, e cila u ul me 410 banorë.

Harta 1. Rritja e popullsisë pa migrim ndërkombëtar sipas bashkive, 2018

Burimi: Përlogaritjet vjetore të INSTAT


Dendësia e Popullsisë

Qarku i Tiranës ka dendësinë më të lartë të popullsisë në vend, më shumë se 538 banorë për kilometër katror, në vitin 2018.

Dendësia e popullsisë në 2018 ishte 100 banorë për km². Dendësia e popullsisë ka mbetur pothuajse në të njëjtat nivele gjatë pesë viteve të kaluara. Qarku i Tiranës ka dendësinë më të lartë të popullsisë, me 538

banorë për km², në vitin 2018. Qarku me dendësinë e dytë më të lartë të popullsisë është ai i Durrësit, me 378 banorë për km², i ndjekur nga Fieri, me 157 banorë për km². Nga ana tjetër, qarqet me dendësinë më të ulët të popullsisë janë ato të Dibrës, Kukësit dhe Gjirokastrës, përkatësisht me 46, 32 dhe 22 banorë për km², në 2018.

Harta 2. Dendësia e popullsisë sipas qarqeve, 2018



Burimi: Përlogaritjet vjetore të INSTAT

Struktura e popullsisë dhe raportet e varësisë

Në vitin 2018, në Shqipëri kishte 500.192 të rinj të moshës më pak se 15 vjeç dhe 396.188 të moshuar të moshës 65 vjeç ose më shumë. Në Shqipëri, popullsia në moshë pune, njerëz të moshës 15 deri 64 vjeç, ishin 1.969.996 gjatë të njëjtit vit.


Siç mund të shihet nga shpërndarja e popullsisë, në tre grup-moshat kryesore, për çdo qark ka një numër më të madh të të rinjve në krahasim me të moshuarit. Prandaj, raporti i varësisë së të rinjve është më i lartë se raporti i varësisë së të moshuarve në çdo qark. Qarqet me raport më të lartë të varësisë së të rinjve janë ato të Kukësit dhe Dibrës, me përkatësisht 32,1 dhe 31,0 persona më të rinj se 15 vjet për çdo 100 persona nga 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa qarqet me raportin më

të ulët të varësisë së të rinjve janë ato të Vlorës dhe Gjirokastrës, përkatësisht me 22,7 dhe 23,2 persona më të rinj se 15 vjet për çdo 100 persona nga 15 deri 64 vjeç. Nga ana tjetër, qarqet me raportin më të lartë të varësisë së të moshuarve janë ato të Lezhës dhe Gjirokastrës, të dy me rreth 21,7 persona më të vjetër se 65 vjeç për 100 persona nga 15 deri 64 vjeç. Qarqet me raportin më të ulët të varësisë së të moshuarve janë ato të Korçës dhe Tiranës, përkatësisht me 19,2 dhe 19,4 persona më të vjetër se 65 vjeç për 100 persona nga 15 në 64 vjeç.

Tab. 2 Popullsia sipas qarqeve dhe grupmoshës, 2018

Qarku	0 - 14	15 - 64	65+
Berat	21.879	86.390	18.026
Dibër	24.659	79.516	15.788
Durrës	50.463	198.797	40.618
Elbasan	50.340	186.979	39.446
Fier	51.779	203.288	41.379
Gjirokastrë	9.958	42.931	9.299
Korçë	36.561	144.717	27.756
Kukës	16.105	50.151	10.739
Lezhë	22.583	84.994	18.421
Shkodër	35.236	141.124	27.585
Tiranë	150.577	618.731	120.271
Vlorë	30.054	132.381	26.863
Shqipëria	500.192	1.969.996	396.188

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT


Fig. 2 Raportet e varësisë sipas qarqeve, 2018

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT

Mosha medianë e popullsisë

Mosha medianë e popullsisë përfaqëson moshën në të cilën gjysma e popullsisë është më e re dhe gjysma tjetër është më e vjetër. Sipas këtij treguesi, qarku i Tiranës ka popullsinë më të re në Shqipëri me një moshë medianë 34,7 vjet, ndërsa qarku i Gjirokastrës

ka popullsinë më të vjetër në vend me një moshë medianë 39,4 vjet. Rastësisht, këto janë edhe qarqet, respektivisht me popullsitë më të madhe dhe më të vogël në Shqipëri.

Fig.3 Mosha medianë e popullsisë sipas qarqeve, 2018

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT

Lindjet

Numri i lindjeve në Shqipëri është zvogëluar gjatë vitit të kaluar. Në vitin 2018 ka pasur 1.935 lindje më pak se në vitin 2017. Qarku me numrin më të madh të lindjeve është ai i Tiranës, me 9.583 lindje në 2018, ndërsa qarku me numrin më të vogël të lindjeve është ai i Gjirokastrës, me 527 lindje gjatë vitit 2018. Në 2018, bashkia me numrin më të madh të lindjeve ishte ajo e Tiranës me 7.384 lindje, ndërsa bashkia me numrin më të ulët të lindjeve ishte ajo e Dropullit, me vetëm 4 lindje. Raporti gjinor në lindje, në Shqipëri, në

vitin 2018 ishte 108 lindje meshkuj për çdo 100 lindje femra. Gjatë vitit 2018, qarqet me raportin gjinor më të lartë në lindje ishin ato të Beratit dhe Elbasanit, përkatësisht me 119 dhe 118 lindje meshkuj për çdo 100 lindje femra. Vlera më e ulët e raportit gjinor në lindje është regjistruar në Gjirokastrë, me vetëm 97 lindje meshkuj për çdo 100 lindje femra. Ky është qarku i vetëm ku numri i lindjeve femra gjatë vitit 2018 ishte më i lartë se ai i lindjeve të meshkujve.

Tab. 3 Lindjet sipas gjinisë dhe raporti gjinor në lindje, sipas qarqeve, 2018

Qarku	Gjinia		Raporti gjinor	Gjithsej
	M	F		
Berat	643	541	119	1.184
Dibër	801	763	105	1.564
Durrës	1.568	1.518	103	3.086
Elbasan	1.584	1.343	118	2.927
Fier	1.355	1.281	106	2.636
Gjirokastrë	259	268	97	527
Korçë	843	791	107	1.634
Kukës	492	460	107	952
Lezhë	699	663	105	1.362
Shkodër	1.010	966	105	1.976
Tiranë	5.005	4.578	109	9.583
Vlorë	706	682	104	1.388
Të panjohur*	60	55	109	115
Shqipëria	15.025	13.909	108	28.934

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT


* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e eventeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar event, mungon

Indeksi sintetik i fekonditetit dhe Mosha mesatare në lindje

Indeksi sintetik i fekonditetit në Shqipëri ka rënë në mënyrë të vazhdueshme, nga 1,73 në 2014 në 1,37 në 2018. Ndërsa në të njëjtën kohë, mosha mesatare e grave në lindje është rritur me gati një vit brenda një periudhe pesë vjeçare, nga 27,7 në 2014 në 28,6 në 2018. Qarqet me ISF më të lartë në Shqipëri janë ato

të Dibrës dhe Kukësit, me 2,14 dhe 2,10 fëmijë për grua. Këto janë dy qarqet e vetme ku indeksi sintetik i fekonditetit është mbi nivelin e zëvendësimit prej 2,1. Qarqet me ISF më të ulët janë ato të Vlorës dhe Korçës, me 1,00 dhe 1,10 fëmijë për grua.

Harta 3. Indeksit sintetik i fekonditetit sipas qarqeve, 2018




Tab.4 Indeksi sintetik i fekonditetit dhe mosha mesatare në lindje, 2018

Qarku	ISF	MML
Berat	1,42	27,48
Dibër	2,14	27,96
Durrës	1,44	27,94
Elbasan	1,6	28,38
Fier	1,31	27,6
Gjirokastrë	1,3	28,84
Korçë	1,1	28,22
Kukës	2,1	29,09
Lezhë	1,63	28,93
Shkodër	1,32	28,65
Tiranë	1,29	29,6
Vlorë	1,00	28,42
Shqipëria	1,37	28,68

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT

Grafiku në vijim tregon koeficientin bruto të lindjeve për secilin qark. Në 2018, në Shqipëri, koeficienti bruto i lindjeve ishte rreth 10,1 lindje për një mijë banorë. Qarqet e Dibrës dhe Kukësit kanë nivelet më të larta të koeficientit bruto të lindjeve në Shqipëri, përkatësisht me 13,0 dhe 12,4 lindje për një mijë banorë. Qarqet e Vlorës dhe Korçës kanë nivelet më të ulëta të koeficientit bruto të lindjeve, përkatësisht me 7,3 dhe 7,8 lindje për një mijë banorë.

Fig. 4 Koeficienti bruto i lindjeve sipas qarqeve, 2018

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT

Martestat

Në vitin 2018 ishin regjistruar 23.104 martesa në zyrat e Gjendjes Civile, 2,0 % më shumë se një vit më parë. Qarku me numrin më të madh të martesave është ai i Tiranës, me 5.986 martesa në vitin 2018, ndërsa qarku me numrin më të ulët të martesave është ai i Gjirokastrës, me 460 martesa gjatë vitit 2018.


Tab.5 Numri i martesave sipas qarqeve, 2018

Qarku	Martestat
Berat	1.234
Dibër	1.124
Durrës	2.428
Elbasan	2.339
Fier	2.600
Gjirokastrë	460
Korçë	1.358
Kukës	596
Lezhë	1.400
Shkodër	1.608
Tiranë	5.986
Vlorë	1.479
Të panjohur*	492
Shqipëria	23.104

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e eventeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar event, mungon.

Harta 4. Përqindja e martesave sipas bashkive, 2018



Burimi: Përlogaritjet vjetore të INSTAT

Në 2018, bashkia me numrin më të madh të martesave ishte ajo e Tiranës me 4.400 martesa, ndërsa bashkia me numrin më të vogël të martesave ishte ajo e Pustecit, me vetëm 9 martesa.

Në vitin 2018, moshë mesatare në martesë e grave në Shqipëri ishte 26,0 vjeç, ndërsa moshë mesatare

në martesë për burrat ishte 30,7 vjeç. Në 2018, qarku me moshën më të lartë mesatare në martesë për gratë ishte ai i Lezhës, me 27,1 vjet, ndërsa qarku me moshë mesatare më të ulët në martesë për gratë është ai i Elbasanit me 24,6 vjet. Në 2018, qarqet me moshën më të lartë mesatare në martesë për burrat ishin ato

të Vlorës dhe Gjirokastrës, me 32,1 vjet, ndërsa qarku me moshën më të ulët mesatare në martesë për burrat është ai i Dibrës, me 29,4 vjet.

Shifrat më poshtë tregojnë koeficientin bruto të martesave sipas qarkut. Në Shqipëri ka pasur 8,1


martesa për një mijë banorë në vitin 2018. Vlera më e lartë e koeficientit bruto të martesave sipas qarkut është arritur në Lezhë, me 11,1 martesa për një mijë banorë, ndërsa vlera më e ulët arrihet në qarkun e Korçës, me 6,5 martesa për një mijë banorë.

Tab. 6 Mosha mesatare në martesë sipas qarkut dhe gjinisë, 2018

Qarku	Mosha mesatare e nuseve	Mosha mesatare e dhëndurëve
Berat	26,2	30,1
Dibër	25,1	29,4
Durrës	25,6	30,4
Elbasan	24,6	29,5
Fier	25,3	30,1
Gjirokastrë	27,0	32,1
Korçë	25,4	30,5
Kukës	26,3	30,0
Lezhë	27,1	30,3
Shkodër	24,9	30,3
Tiranë	26,7	31,1
Vlorë	27,0	32,1
Shqipëria	26,0	30,7

Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT

Fig. 5 Koeficienti bruto i martesave sipas qarkut, 2018



Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT

Vdekjet

Numri i vdekjeve në Shqipëri është zvogëluar gjatë vitit të kaluar. Në 2018 kishte 428 vdekje më pak se gjatë një viti më parë. Qarku me numrin më të madh të vdekjeve është ai i Tiranës, me 5.174 vdekje në 2018, ndërsa qarku me numrin më të ulët të vdekjeve është ai i Kukësit me 502 vdekje gjatë vitit 2018. Në 2018, bashkia me numrin më të madh të vdekjeve ishte ajo e Tiranës me 4.023 vdekje, ndërsa bashkia me numrin më të ulët të vdekjeve ishte ajo e Pustecit, me vetëm 38 vdekje.

Tab. 7 Vdekjet sipas gjinisë dhe qarqeve, 2018


Qarku	Gjinia		Gjithsej
	M	F	
Berat	607	543	1.150
Dibër	479	435	914
Durrës	1.139	935	2.074
Elbasan	1.161	1.027	2.188
Fier	1.304	1.180	2.484
Gjirokastrë	408	336	744
Korçë	1.123	966	2.089
Kukës	220	282	502
Lezhë	523	452	975
Shkodër	974	837	1.811
Tiranë	2.812	2.362	5.174
Vlorë	898	775	1.673
Të panjohur*	19	7	26
Shqipëria	11.667	10.137	21.804

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e eventeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar event, mungon.

Në vitin 2018, koeficienti bruto i vdekjeve në Shqipëri ishte 7,6 vdekje për një mijë banorë. Në nivel qarku, në vitin 2018, koeficienti bruto i vdekjeve arriti vlerën më të lartë në qarkun e Gjirokastrës, me 12,0 vdekje për një mijë banorë, ndërsa vlera më e ulët u arrit në qarkun e Tiranës, me 5,8 vdekje për një mijë banorë.

Fig. 6 Koeficienti bruto i vdekjeve, 2018



Burimi: Përlllogaritjet vjetore nga INSTAT

Shtesa natyrore

Vlera e shtesës natyrore në Shqipëri është ulur gjatë vitit të kaluar. Shtesa natyrore në Shqipëri ra nga 8.637 në 2017 në 7.130 në 2018. Qarku me shtesën më të lartë natyrore është ai i Tiranës, me një vlerë prej 4.409 në 2018, ndërsa qarku me shtesën më të ulët natyrore është ai i Korçës, me një vlerë prej -455 në 2018. Në 2018, bashkia me shtesën më të lartë natyrore ishte ajo e Tiranës, me një vlerë prej 3.361, ndërsa bashkia me shtesën më të ulët natyrore ishte ajo e Korçës, me një vlerë prej -326.


Tab. 8 Shtesa natyrore sipas qarqeve, 2018

Qarku	Shtesa natyrore		
	Gjinia		Gjithsej
	M	F	
Berat	36	-2	34
Dibër	322	328	650
Durrës	429	583	1,012
Elbasan	423	316	739
Fier	51	101	152
Gjirokastrë	-149	-68	-217
Korçë	-280	-175	-455
Kukës	272	178	450
Lezhë	176	211	387
Shkodër	36	129	165
Tiranë	2,193	2,216	4,409
Vlorë	-192	-93	-285
Të panjohur*	41	48	89
Shqipëria	3,358	3,772	7,130

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e eventeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar event, mungon.

Harta 5. Shtesa natyrore e popullsisë sipas bashkive, 2018



Tab. 8 Lëvizjet e brendshme neto sipas qarqeve, 2016 - 2018

Qarku	2016	2017	2018
Berat	-2.719	-3.076	-984
Dibër	-3.563	-4.157	-1.632
Durrës	4.043	4.633	816
Elbasan	-2.737	-2.790	-1.272
Fier	-1.676	-2.001	-893
Gjirokastrë	-1.589	-2.210	-836
Korçë	-2.354	-2.809	-844
Kukës	-1.913	-2.021	-677
Lezhë	-561	-934	-288
Shkodër	-1.170	-1.288	-460
Tiranë	14.397	16.844	7.193
Vlorë	-158	-191	-123


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Lëvizjet e brendshme të popullsisë

Migrimi brenda vendit ka një ndikim të rëndësishëm në popullsinë e njësive administrative të Shqipërisë. Në vitin 2018, në nivel qarku, vetëm Tirana dhe Durrësi kishin një migrim të brendshëm pozitiv, përkatësisht me 7.193 dhe 816. Të gjitha prefekturat e tjera kanë pasur migracion të brendshëm neto negativ gjatë vitit 2018, dhe në veçanti qarku i Dibrës, me 1.632 dhe ai i Elbasanit me 1.272.

Koeficienti bruto i migracionit të brendshëm neto tregon ndikimin që ka migracioni i brendshëm në popullsinë e qarqeve specifike. Tirana dhe Durrësi janë qarqet e vetme me një koeficient bruto të migrimit të brendshëm pozitiv, përkatësisht me një shtesë prej 8,1 dhe 2,8 persona për një mijë banorë. Qarqet e Dibrës dhe Gjirokastrës kanë nivelet më të ulëta të koeficientit bruto të migracionit të brendshëm neto, përkatësisht me -13,6 dhe -13,4 persona për një mijë banorë.

Harta 6. Koeficienti bruto i migrimit të brendshëm neto sipas qarqeve, 2018



Tab.9 Popullsia sipas qarqeve dhe gjinisë 2016-2018

Qarku	2016			2017			2018		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Berat	133.692	68.429	65.263	129.686	65.834	63.852	126.295	63.495	62.800
Dibër	127.318	66.525	60.793	123.278	64.412	58.866	119.963	62.515	57.449
Durrës	282.515	144.503	138.012	287.226	146.184	141.042	289.877	146.870	143.008
Elbasan	285.715	145.546	140.169	281.185	142.177	139.008	276.765	138.802	137.963
Fier	303.808	156.579	147.229	300.326	153.629	146.697	296.446	150.555	145.891
Gjirokastrë	66.980	33.904	33.076	64.446	32.150	32.296	62.188	30.584	31.604
Korçë	215.872	109.409	106.463	212.249	106.708	105.541	209.034	104.235	104.799
Kukës	80.428	41.301	39.127	78.477	40.301	38.176	76.994	39.491	37.503
Lezhë	129.639	66.159	63.480	127.910	64.621	63.289	125.998	62.941	63.057
Shkodër	209.047	104.198	104.849	206.458	102.113	104.345	203.945	100.061	103.884
Tiranë	852.672	423.634	429.038	873.178	432.415	440.763	889.578	439.464	450.114
Vlorë	188.415	95.813	92.602	189.038	95.527	93.511	189.297	95.092	94.205
Shqipëria	2.876.101	1.456.000	1.420.101	2.873.457	1.446.071	1.427.386	2.866.376	1.434.102	1.432.274

Burimi: Përlogaritjet vjetore nga INSTAT

Tab. 10 Dendësia e popullsisë, 2018

Qarku	Popullsia	Dendësia
Berat	126.295	70
Dibër	119.963	46
Durrës	289.877	378
Elbasan	276.765	87
Fier	296.446	157
Gjirokastrë	62.188	22
Korçë	209.034	56
Kukës	76.994	32
Lezhë	125.998	78
Shkodër	203.945	57
Tiranë	889.578	538
Vlorë	189.297	70
Shqipëria	2.866.376	100

Burimi: Përlogaritjet vjetore nga INSTAT

Tab. 11 Popullsia mesatare sipas qarqeve, grupmoshave dhe gjinisë, 2018

Qarku	Gjithsej			Meshkuj			Femra		
	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+
Berat	21.879	86.390	18.026	11.117	43.574	8.805	10.762	42.817	9.221
Dibër	24.659	79.516	15.788	12.801	41.795	7.919	11.858	37.721	7.870
Durrës	50.463	198.797	40.618	25.911	101.183	19.776	24.552	97.614	20.842
Elbasan	50.340	186.979	39.446	25.591	93.985	19.227	24.750	92.994	20.219
Fier	51.779	203.289	41.379	26.481	103.781	20.293	25.298	99.508	21.086
Gjirokastrë	9.958	42.932	9.299	5.095	21.114	4.375	4.864	21.818	4.924
Korçë	36.561	144.717	27.756	18.872	71.954	13.408	17.689	72.763	14.348
Kukës	16.105	50.152	10.741	8.402	25.844	5.248	7.703	24.308	5.493
Lezhë	22.581	84.991	18.421	11.420	42.717	8.801	11.161	42.274	9.620
Shkodër	35.235	141.124	27.586	17.963	68.983	13.115	17.273	72.141	14.471
Tiranë	150.577	618.731	120.273	77.995	304.130	57.341	72.582	314.601	62.932
Vlorë	30.054	132.381	26.863	15.529	66.524	13.040	14.525	65.858	13.823
Shqipëria	500.188	1.969.996	396.192	257.174	985.582	191.346	243.014	984.414	204.846

Burimi: Përlogaritjet vjetore nga INSTAT

Burimet e të dhënave

INSTAT mbledh një gamë të gjerë të dhënash demografike, duke përfshirë statistika të popullsisë në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe të dhëna për eventet demografike, të cilat kanë një ndikim në madhësinë dhe në strukturën e popullsisë. Për drejtorinë e statistikave sociale burime potenciale të dhënash, për përmbushjen e objektivave në llogaritjen e indikatorëve specifik, janë të dhënat administrative dhe Censuset e Popullsisë dhe Banesave.

Burimet administrative

Lindjet, vdekjet, martesat dhe lëvizjet e brendshme të popullatës

Të dhënat për lindjet, vdekjet, martesat dhe lëvizjet e brendshme sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në mënyrë elektronike. Kjo mënyrë e sigurimit të të dhënave të eventeve demografike siguron një plotshmëri më të lartë gjithashtu edhe përmbushjen e afateve të publikimeve përkatëse.

Censi i popullsisë dhe banesave

Censi i popullsisë dhe banesave i vitit 2011 është një burim shumë i rëndësishëm për statistikat e popullsisë. Është baza për llogaritjet vjetore të numrit të popullsisë.

Përkufizime

Norma bruto e lindjeve: Është numri i lindjeve për 1000 banorë të një territori të caktuar në një vit të dhënë.

Norma bruto e vdekjeve: Është numri i vdekjeve për 1000 banorë të një territori të caktuar në një vit të dhënë.

Statistikat vitale: Janë të dhëna demografike mbi lindjet, vdekjet, vdekjet nën 1 vjeç dhe martesat.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete. Është numri i lindjeve që përjashtojnë lindjet e mbetura.

Vdekja: Do të thotë zhdukje e përhershme e të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi të ndodhë një lindje e gjallë (ndërprerja e funksioneve jetësore, pa aftësinë e ringjalljes).

Shtesa natyrore: Shpreh rritje/ulje të popullatës si rezultat i proceseve biologjike (lindje dhe vdekje) gjatë një periudhe kohe. Pra, diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve një vit të caktuar shpreh rritjen natyrore për atë vit.

Dendësia e popullsisë: Numri i banorëve për njësi sipërfaqe të tokës (për km²)

Koeficienti i rritjes së popullsisë: Është frekuenca me të cilën një popullatë rritet (ose zvogëlohet) në një vit të caktuar si rezultat i rritjes së saj natyrore dhe migrimit neto, i shprehur si përqindje e popullatës bazë.

Koeficienti i rritjes natyrore: Është frekuenca me të cilin një popullsi po rritet (ose zvogëlohet) në një vit të dhënë në sajë të shtesës së lindjeve mbi vdekjet, shprehur si përqindje ndaj popullsisë bazë.

Raporti i varësisë së përgjithshme: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç) dhe personave të vjetër mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç) shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të rinjve: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të moshuarve: Raporti i numrit të personave të vjetër mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Migracioni neto i brendshëm: Është diferenca e flukseve hyrëse me ato dalëse të popullsisë së një territori të caktuar (qark) në një vit të dhënë.

Norma bruto e lëvizjeve të brendshme të popullsisë: Është raporti i migracionit neto të brendshëm për një territor të caktuar (qark) me popullsinë përkatëse, në një vit të caktuar, shprehur për mijë banorë.

Migracioni neto: Është diferenca midis imigracionit dhe emigracionit të popullsisë së një territori të caktuar, në një periudhë të dhënë kohe.

Norma bruto e martesave: Është numri i martesave për 1000 banorë të një territori të caktuar, në një vit të dhënë.




2. LEJET E NDËRTIMIT

Lejet e ndërtimit të miratuara parashikojnë ecurinë e sektorit të ndërtimit për periudhën pasardhëse bazuar në të dhënat kryesore të përfutura nga ky tregues. Lejet e ndërtimit janë të rëndësishme sepse marrja e një leje ndërtimi kundrejt ligjeve në fuqi përpara

fillimit të punës për ndërtimin e një objekti banimi ose çfarëdolloj objekti tjetër, siguron mbrojtje në të ardhmen për banesën apo godinën në të cilën do të ushtrohet aktivitet.

Harta 1. Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja sipas bashkive, 2018



Gjatë harkut kohor 2016 - 2018 janë miratuar gjithsej 2.468 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, mesatarisht 823 leje të miratuara për vit. Numri më i lartë i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja, vihet re në vitin 2018, me 1.194 leje të miratuara gjithsej ose 48,4 % e të gjithë lejeve të miratuara gjatë trevjeçarit të fundit. Viti 2016, është viti në të cilin janë miratuar më pak leje ndërtimi për ndërtesa të reja, me 455 leje të miratuara gjithsej ose 18,4 % e të gjithë lejeve të miratuara gjatë të njëjtës periudhë kohore.

Referuar të dhënave të grumbulluara për periudhën kohore 2016 - 2018, rreth 54 % e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja janë përqëndruar në tre qarqe kryesore: Tiranë, Durrës dhe Fier me përkatësisht 29,4 %, 12,6 % dhe 12,2 %. Qarku i Kukësit është qarku me numrin më të ulët të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja, me 0,4 % të lejeve gjithsej.

Tab.1 Numri dhe sipërfaqja e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja sipas qarqeve, 2016-2018


Qarqet	2016		2017		2018	
	Numër	Sipërfaqe m ²	Numër	Sipërfaqe m ²	Numër	Sipërfaqe m ²
Berat	44	14.361	25	22.667	44	28.680
Dibër	10	1.084	24	5.029	34	8.028
Durrës	49	51.831	105	74.893	156	172.658
Elbasan	68	17.734	63	28.404	88	34.165
Fier	38	16.981	133	52.091	129	61.339
Gjirokastrë	12	8.585	13	14.427	40	16.985
Korçë	10	3.543	71	37.856	100	40.774
Kukës	0	0	5	1.066	6	3.483
Lezhë	35	9.009	22	7.390	57	22.529
Shkodër	60	35.236	65	56.316	89	60.040
Tiranë	106	209.295	231	521.996	388	940.348
Vlorë	23	12.482	62	46.399	63	53.754
Shqipëri	455	380.141	819	868.534	1.194	1.442.783

Burimi: Bashkitë, përllogaritjet vjetore të INSTAT-it


Kërkesa për leje ndërtimi për ndërtesa për banim dominon në krahasim me kërkesat për ndërtesa të tjera si: hotele dhe të ngjashme, zyra, industriale, tregtare apo të tjera.

Gjatë harkut kohor 2016 - 2018, lejet e ndërtimit të miratuara për ndërtesa për banim zënë 64,4 % të numrit gjithsej të lejeve, ndërsa lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa të tjera zënë 36,6 % të këtij treguesi.

Përsa i përket sipërfaqes së lejeve të miratuara për ndërtesa të reja, referuar të njëjtës periudhë kohore, qarqet me sipërfaqen më të lartë të lejeve të ndërtimit të miratuara janë qarku i Tiranës me 62,1 %, Durrësit me 11,1 % dhe Shkodrës me 5,6 %. Qarku i Kukësit është qarku me sipërfaqen më të ulët të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja, me 0,2 % të sipërfaqes gjithsej miratuar në nivel vendi.

Fig.1 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa për banim sipas qarqeve, 2016-2018

Burimi: Bashkitë, përllogaritjet vjetore të INSTAT-it

Fig.2 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa për banim sipas qarqeve, 2016-2018

Burimi: Bashkitë, përllogaritjet vjetore të INSTAT-it

Referuar të dhënave të grumbulluara për periudhën kohore 2016 - 2018, rreth 53 % e lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa për banim janë përqëndruar në tre qarqe kryesore: Tiranë, Durrës dhe Fier me përkatësisht 30,2 %, 12,2 % dhe 10,8 %. Qarku i Kukësit është qarku me numrin më të ulët të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa për banim, me 0,3 % të lejeve gjithsej.

Përsa i përket sipërfaqes së lejeve të miratuara për ndërtesa për banim, referuar të njëjtës periudhë kohore, qarqet me sipërfaqen më të lartë të lejeve të ndërtimit të miratuara janë qarku i Tiranës me 75,4 %, Durrësit me 6,5 % dhe Shkodrës me 5,2 %. Qarku i Kukësit është qarku me sipërfaqen më të ulët të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa për banim, me 0,1 % të sipërfaqes gjithsej miratuar në nivel vendi.

Burimi i të dhënave

Bashkitë, përlllogaritjet vjetore të INSTAT-it

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish : 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen: hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.




3. STATISTIKAT E TREGUT TË PUNËS

Punësimi

Raporti i të punësuarve (të moshës 15 vjeç e lart) në lidhje me popullsinë e së njëjtës moshë (rreth 2363 mijë persona) është 52,1 %. Shkalla më e lartë e punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, është regjistruar në qarkun e Elbasanit (61,5 %), ndjekur nga qarku i Korçës (59,5 %), dhe Fierit (59,0 %).


Fig. 1 Shkalla e punësimit sipas qarqeve, 2018, në %



Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT

Nga këndvështrimi gjinor, diferenca më e madhe e shkallës së punësimit është shënuar në qarkun e Vlorës ku hendeku është 19,0 pikë përqindje ndërsa mesatarja në Shqipëri është 13,7 pikë përqindje. Të gjitha qarqet kanë shkallë më të lartë punësimi për meshkujt sesa femrat, përveç Dibrës ku hendeku gjinor është negativ (- 0,5 pikë përqindje).

Fig. 2 Shkalla e punësimit sipas qarqeve dhe gjinisë, 2018, në %




Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT

Analiza e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike tregon se shërbimet dhe bujqësia kanë pjesën më të madhe të të punësuarve, përkatësisht 42,9 dhe 37,4 %, ndërsa të

punësuarit në industri përbëjnë vetëm 19,7 %. Tirana është qarku me përqindjen më të lartë të punësimit në shërbime (66,5 %) dhe përqindjen më të ulët të punonjësve në bujqësi (6,9 %). Qarku me përqindjen më të lartë të punësimit në industri është Durrësi (34,2 %) ndërsa qarku i Kukësit ka përqindjen më të ulët të punonjësve në këtë sektor (6,9 %). Përqindja më e lartë e punësimit në bujqësi (67,2 %) regjistrohet në qarkun e Elbasanit, i cili ka në të njëjtën kohë edhe nivelin më të ulët të punonjësve në shërbime (23,4 %).


Fig. 3 Shkalla e punësimit sipas qarqeve dhe aktiviteteve ekonomike, 2018, në %



Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT

Rritja më e lartë e shkallës së punësimit, gjatë viteve 2016-2018, është regjistruar në qarkun e Kukësit, me 10,4 pikë përqindje, dhe në Korçë me 9,5 pikë përqindje. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha qarqet shënuan rritje të shkallës së punësimit përveç Lezhës, ku shkalla e punësimit u ul me 1,8 pikë përqindje.

Fig. 4 Shkalla e punësimit sipas qarqeve, 2016-2018, në %




Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT

Rritja e shkallës së punësimit regjistruar në Kukës është nxitur kryesisht nga meshkujt (shkalla është 16,4 pikë përqindje më e lartë në 2018 në krahasim me 2016) ndërsa për Korçën, rritja është pothuajse e njëjtë si për meshkujt ashtu edhe për femrat (9,4 pikë përqindje gjatë të njëjtës periudhë). Femrat tregojnë një rritje të konsiderueshme të shkallës së punësimit edhe në Berat, 7,8 pikë përqindje, ndërsa shkalla për meshkujt në këtë rajon rritet me vetëm 0,9 pikë përqindje.

Papunësia

Në vitin 2018, ka rreth 547 mijë njerëz të papunë në Shqipëri, baraz me 12,3 % të forcës totale të punës. Këto shifra paraqesin një ulje të konsiderueshme të papunësisë në krahasim me tre vjet më parë kur niveli i papunësisë ishte 15,2 %. Shkalla më e ulët e papunësisë është përqëndruar në qarkun e Dibrës dhe të Korçës (5,9 %) ndërsa ajo më e larta është regjistruar në Vlorë duke arritur 21,9 % ku më shumë se 1 në 5 persona në forcë pune ishin të papunë.

Fig. 5 Shkalla e papunësisë sipas qarqeve, 2018, në %




Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT

Analiza gjinore tregon se qarku me nivelin më të lartë të papunësisë për femrat është Vlora me 26,2 % e cila ndikon në masën më të madhe edhe shkallën e papunësisë gjithsej në këtë rajon dhe në vend. Shkalla më e lartë e papunësisë për meshkujt është regjistruar në Lezhë, 20,5 % duke ndikuar më së shumti në shkallën e papunësisë gjithsej për këtë qark, në krahasim me femrat.


Shkalla e papunësisë regjistron vlerën e saj më të ulët në qarkun e Dibrës për femrat (4,7 %), dhe në Korçë dhe Kukës për meshkujt (përkatësisht 5,4 dhe 5,0 %).

Fig. 6 Shkalla e papunësisë sipas qarqeve dhe gjinisë, 2018, në %



Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT

Fig. 7 Shkalla e papunësisë sipas qarqeve, 2016-2018, në %



Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT


Forcat e Punës

Në vitin 2018, shkalla mesatare e pjesëmarrjes në forcat e punës për vendin është 59,4 %. Analizuar sipas qarqeve, forcat e punës janë më të përqendruara në Elbasan dhe Fier (me 65,8 dhe 64,9 % respektivisht) ndërsa shkallët më të ulëta janë regjistruar në dy zonat e metropolit: Tiranë dhe Durrës (me përkatësisht 54,7 dhe 54,2 %).

Katër qarqet me nivelet më të larta të papunësisë mbi mesataren për vendin: Durrësi, Tirana, Lezha dhe Vlora

janë gjithashtu katër rajonet që kanë nivelet më të ulëta të punësimit nën mesataren kombëtare. Nga të katër, Durrësi, Tirana dhe Lezha kanë gjithashtu nivelin më të ulët të pjesëmarrjes në punësim, nën 57.0 %. Përkundrazi, Vlora renditet midis rajoneve me shkallën më të lartë të pjesëmarrjes në forcat e punës, 63,6 %, gjë që tregon se në këtë qark ka më shumë persona që nuk punojnë por e konsiderojnë veten aktiv në tregun e punës (ata kanë kërkuar punë në mënyrë aktive në katër javët e fundit dhe janë të disponueshëm për ta filluar atë brenda dy javëve të ardhshme). Si rrjedhim, qarku i Vlorës shënon një nivel të lartë të pjesëmarrjes në forcat e punës megjithëse niveli i punësimit është nga më të ulët në vend.

Fig. 8 Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas qarqeve, 2018, në %




Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2018 INSTAT

Pagat

Paga mesatare mujore në Shqipëri në vitin 2018 është 50.589 lekë, qarku Tiranë ka pagën mesatare mujore më të lartë (57.533 lekë), ndërsa qarqet Lezhë dhe Shkodër kanë pagën më të ulët (afërsisht 39.000 lekë).


Fig. 9 Paga mesatare mujore bruto sipas qarqeve, 2018, në %



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, llogaritje të INSTAT

Krahasuar me mesataren mujore në nivel kombëtar, qarku Tiranë ka pagën mesatare mujore më të lartë (13,72 %), ndërsa qarku Shkodër ka pagën më të ulët (22,06 %), figura 9.

Fig. 10 Ndryshimi në Përqindje i pagës mesatare mujore bruto sipas qarqeve, 2017-2018, në %




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, llogaritje të INSTAT

Harta tregon që bashkitë, të cilat kanë të zhvilluar punësimin në sektorin e industrisë nxjerrëse kanë vlerën e pagës mesatare mujore shumë afër vlerës së asaj në nivel kombëtar.


Krahasuar me vitin 2017, paga mesatare mujore bruto gjatë vitit 2018 shfaq një tendencë rritjeje me 3,3 %. Qarku Durrës ka rritjen më të madhe të pagave (5,0 %), ndërsa qarku i Kukës ka rritjen më të vogël (1,6 %), figura 10.

Studimet mbi pagën mesatare mujore bruto tregojnë se përqindjen më të madhe të ndryshimit e kishte sektori i Arte, argëtim dhe çlodhje me 16,85 %, ndërsa kjo përqindje në sektorin e Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme u ul me 2,13 %, figura 11.

Harta 1. Paga mesatare mujore për të punësuar, 2019



Burimi: Përlogaritjet e INSTAT bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kontributet e sigurimeve shoqërore

Fig. 11 Ndryshimi në përqindje e pagës mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve ekonomike, 2017-2018, në %

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, llogaritje të INSTAT

Burimi i të dhënave

Statistikat mbi punësimin dhe papunësinë bazohen në Anketën e Forcave të Punës realizuar nga INSTAT në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2012. Rezultatet e vërtetimit publikohen në baza tremujore dhe vjetore, dhe nga viti 2016, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë rajonal.

Statistikat e tregut të punës mbi pagat janë të bazuara në informacionin e të dhënave administrative nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mbi kontribuesit në Sigurime Shoqërore. Të dhënat për pagat publikohen nga INSTAT me periodicitet tremujor dhe vjetor.

Përkufizime

Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës. Të punësuar janë konsideruar edhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye:

(1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet që (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin / fermën / praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, janë konsideruar të punësuar.

Të papunë konsiderohen personat që gjatë javës së referencës ishin:

1. pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi; 2. aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës); 3. duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë

që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen:

Kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë; kontakt me një agjensi private punësimi për të gjetur punë; aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi; kërkuar miqve/shokëve, të afërme, sindikatave etj; vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta; studiuar lajmërimet në gazeta; marrë pjesë në një test apo intervistë; kërkuar për tokë, godinë ose pajisje; aplikuar për leje, liçenca ose burime financiare.

Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.

Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

Paga mesatare mujore është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer.

Ajo përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- Paga bazë për punën e kryer
- Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese
- Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë
- Shtesa mbi pagë për vështirësi në punë
- Shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.)

Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.



4. STATISTIKAT E KONSUMIT TË FAMILJEVE


Statistikat e Konsumit sigurojnë përshkrime të nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) në Shqipëri si dhe të treguesve të tjerë me bazë shpenzimet e konsumit. Të dhënat e konsumit llogariten bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjes, i cili është një vrojtim statistikor që kryhet pranë NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jep një panoramë të qartë të situatës socio-ekonomike të tyre.

Struktura e konsumit të NjEF shqiptare është paraqitur sipas ndarjes në 12 grupet bazë të konsumit (klasifikimi COICOP- ABF 2012), shpenzime për ushqim, shpenzime jo-ushqimore (veshje, artikuj për shtëpi etj.), shpenzime për shërbime bazë (elektricitet, ujë, gaz, telefon etj.), shpenzime për arsim, komunikim, shëndet dhe pajisje afatgjatë.

Shpërndarja e shpenzimeve mesatare për konsum të NjEF sipas qarqeve, 2016-2018.

Shpenzimet mesatare për konsum sipas qarqeve kanë ndryshuar gjatë periudhës 2016-2018 duke shprehur në përgjithësi tendenca të ndryshme për nga madhësia e shpenzimeve. Rritja më e lartë e shpenzimeve për konsum nga viti 2016 është regjistruar në qarkun e Gjirokastrës dhe Vlorës, përkatësisht 16,1 dhe 15,9 përqind. Ndërsa ulja më e theksuar e shpenzimeve të konsumit është regjistruar në qarkun e Dibrës, me 7,5 përqind edhe pse trendi i konsumit për këtë qark shënon rritje në vite.

Fig.1 Shpenzimet mesatare mujore për konsum për NjEF sipas qarqeve , 2016 – 2018.




Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Shpërndarja e strukturës së shpenzimeve për konsum për grupet “Ushqime, pije jo-alkoolike, pije alkoolike dhe duhan” të NjEF sipas qarqeve, 2016-2018.

Shpenzimet mesatare mujore për konsum të grupeve “Ushqime, pije jo-alkoolike, pije alkoolike dhe duhan” kanë ndryshuar gjatë periudhës 2016-2018 duke shprehur në përgjithësi sjellje të ndryshme konsumatore. Rritja më e lartë e shpenzimeve për

këto grupe nga viti 2016 është regjistruar në qarkun e Shkodrës me 2,6 pikë përqindje ndërkohë ulje më të theksuar për grupet “Ushqime, pije jo-alkoolike, pije alkoolike dhe duhan” është regjistruar në qarkun Kukës me 12,9 pikë përqindje.

Fig. 2 Shpenzimet mesatare mujore për konsum të grupeve “Ushqime, pije jo-alkoolike, pije alkoolike dhe duhan” sipas qarqeve, 2016-2018.



Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018


Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve dhe arsimit të kryefamiljarit, 2016-2018.

Përsa i përket shpenzimeve në nivel qarku të disagreguara sipas nivelit të arsimit të kryefamiljarit vihet re që shpenzimet më të larta janë regjistruar në kategorinë e kryefamiljarëve me arsim të lartë apo pas universitar ndjekur nga kategoria e të arsimuarve në shkolla të mesme të përgjithshme ose profesionale. Vlerat më të larta të shpenzimeve për vitin 2018 në kategorinë e arsimit të lartë/pas universitar janë

regjistruar në qarqet Fier dhe Tiranë, ndërsa vlerat më të larta për kategorinë e të arsimuarve në shkolla të mesme të përgjithshme ose profesionale janë regjistruar në qarqet Tiranë dhe Korçë.


Qarqet Berat, Elbasan, Gjirokastrë dhe Vlorë kanë regjistruar rritje të shpenzimeve për konsum në vitin 2018 për të tre kategoritë e arsimit të përfunduar të kryefamiljarit, ndërkohë për të njëjtat kategori në qarqet Dibër dhe Durrës shpenzimet kanë shënuar ulje, krahasuar me vitin 2016.

Fig. 3 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve dhe arsimit të kryefamiljarit, 2016-2018



Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Harta 1. Treguesit kryesorë sipas qarqeve



Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Burimi i të dhënave

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Përkufizime:

Shpenzimet për konsum të NjEF përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF dhe individëve me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.

Periudha e referencës është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.

Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Kryefamiljari është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF). Nëse anëtarët e NjEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF.

Aneks

Tab. 1 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve

Qarku	Viti		
	2016	2017	2018
Berat	64,222	69,948	70,737
Dibër	63,212	47,467	58,461
Durrës	77,933	76,129	75,744
Elbasan	57,290	57,831	63,847
Fier	71,242	71,052	71,117
Gjirokastrë	57,068	62,237	66,238
Korçë	67,829	71,063	74,319
Kukës	68,197	66,218	66,326
Lezhë	75,470	73,057	72,852
Shkodër	75,503	73,306	73,441
Tiranë	85,344	87,968	88,691
Vlorë	58,872	58,374	68,227
Shqipëri	73,143	73,400	75,935

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Tab. 2 Struktura e shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve

Qarku	Viti	Ushqim dhe pije jo-alkoolike	Pije alkoolike, duhan	Veshje dhe Këpucë	Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar	Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës	Shëndet	Transport	Komunikim	Argëtim dhe kulturë	Arsim	Restorante dhe hotele	Të tjera mallra dhe shërbime
Berat	2016	47.8	4.5	4.1	8.7	5.3	4.3	6.2	2.9	2.5	3.6	3.4	6.6
	2017	46.1	4.8	3.9	8.0	5.1	4.6	7.6	2.8	3.0	1.6	6.3	6.1
	2018	42.2	4.8	3.9	9.9	6.1	4.2	7.5	3.0	2.8	2.8	6.3	6.4
Dibër	2016	50.2	5.0	5.4	9.1	5.3	1.4	4.5	3.1	2.8	5.0	4.3	3.9
	2017	48.5	5.4	5.2	13.1	6.0	2.1	4.1	4.4	1.0	1.6	4.2	4.5
	2018	47.8	6.0	5.1	9.4	7.9	3.7	5.8	3.3	1.6	1.2	2.6	5.8
Durrës	2016	49.1	2.8	5.0	9.3	5.6	3.1	6.6	3.0	2.5	3.2	2.4	7.4
	2017	48.8	2.8	4.3	10.0	5.4	3.8	7.1	3.0	2.9	2.4	2.0	7.5
	2018	51.2	2.4	4.0	10.6	5.6	3.5	6.1	3.2	1.9	1.7	2.2	7.4
Elbasan	2016	53.4	4.1	4.4	9.0	5.7	3.6	4.3	3.6	2.1	1.3	1.9	6.4
	2017	52.2	4.9	3.8	9.2	5.7	3.0	5.1	3.4	2.1	1.6	2.6	6.4
	2018	51.9	5.2	3.5	9.1	6.7	3.1	3.9	3.4	2.2	1.3	2.7	7.0
Fier	2016	43.1	2.8	4.2	8.6	5.0	3.9	7.5	2.6	3.6	5.1	6.7	6.9
	2017	42.0	3.1	3.8	9.3	4.6	5.1	8.7	2.7	2.4	6.8	6.0	5.5
	2018	41.9	3.2	4.5	9.1	5.7	6.0	7.8	3.1	2.3	3.5	6.5	6.2
Gjirokastrë	2016	45.6	2.4	3.0	10.3	5.4	3.5	8.0	3.4	1.5	7.7	3.4	5.9
	2017	46.2	2.3	4.1	9.9	5.6	4.5	10.4	3.7	1.7	2.3	2.9	6.5
	2018	47.6	2.2	2.5	10.0	6.2	3.9	10.4	3.6	1.6	2.6	2.5	7.0
Korçë	2016	48.2	4.4	6.2	9.7	5.5	2.0	4.1	3.1	1.9	5.2	3.7	6.0
	2017	43.2	3.6	5.7	11.5	5.4	3.1	6.9	3.2	3.3	3.1	5.4	5.5
	2018	39.6	3.8	6.6	10.0	7.2	3.5	7.3	3.9	3.5	2.3	5.1	7.1
Kukës	2016	44.2	4.5	3.7	13.0	4.9	2.8	8.1	3.9	2.9	6.5	1.3	4.3
	2017	48.9	4.1	2.1	11.3	5.3	2.4	6.4	3.0	1.9	9.1	1.1	4.2
	2018	31.4	4.4	7.3	9.1	8.4	5.2	12.8	3.6	2.8	6.1	2.7	6.3
Lezhë	2016	46.9	5.6	4.3	8.3	6.2	5.0	3.6	2.5	2.4	3.1	2.5	9.5
	2017	44.1	5.7	3.8	10.7	4.6	3.3	4.7	3.1	2.2	5.2	5.8	6.9
	2018	46.1	4.8	4.2	10.5	5.6	3.6	6.6	3.4	2.8	1.5	4.0	6.7
Shkodër	2016	45.7	3.2	3.6	9.7	4.6	3.6	8.6	2.9	2.3	3.4	6.1	6.2
	2017	44.4	2.9	3.1	11.6	4.3	3.5	8.3	3.5	2.1	1.1	9.5	5.9
	2018	48.8	2.7	2.9	9.2	6.1	4.9	6.2	3.6	2.0	1.5	5.0	7.1
Tiranë	2016	40.5	3.1	5.6	11.5	4.4	3.5	6.6	3.6	3.9	5.4	5.6	6.3
	2017	39.9	3.1	4.7	11.8	4.1	4.1	7.6	3.7	4.1	5.2	5.5	6.1
	2018	39.7	3.3	4.4	11.9	4.9	4.3	7.0	4.0	3.4	4.3	5.9	7.1
Vlorë	2016	50.6	2.7	3.0	12.2	5.2	3.7	6.3	3.6	1.8	2.4	2.7	5.7
	2017	49.5	2.8	3.1	11.6	5.7	4.9	6.4	3.5	2.0	1.4	2.9	6.4
	2018	52.4	2.0	3.2	10.1	6.6	3.6	5.9	3.6	1.4	3.1	2.3	5.9
Shqipëri	2016	45.2	3.4	4.8	10.2	5.0	3.4	6.3	3.3	3.0	4.4	4.4	6.5
	2017	44.1	3.5	4.3	10.9	4.8	3.9	7.2	3.4	3.0	3.9	5.0	6.1
	2018	44.0	3.5	4.3	10.5	5.8	4.2	6.8	3.6	2.7	3.0	4.7	6.9

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Tab. 3 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas arsimit të kryefamiljarit dhe qarqeve

Qarku	Viti	Deri në arsim 8/9 vjeçar	Arsimi i mesëm i përgjithshëm / profesional	Arsimi i lartë / Pas universitar	Gjithsej
Berat	2016	57,386	67,719	77,819	64,222
	2017	70,248	66,014	93,426	69,948
	2018	69,985	67,949	89,025	70,737
Dibër	2016	58,795	54,520	152,607	63,212
	2017	45,884	47,500	58,579	47,467
	2018	56,601	54,412	92,108	58,461
Durrës	2016	65,238	85,010	104,733	77,933
	2017	59,454	81,455	127,608	76,129
	2018	64,957	77,372	104,586	75,744
Elbasan	2016	52,010	61,172	65,778	57,290
	2017	50,755	62,069	82,345	57,831
	2018	59,962	65,783	80,549	63,847
Fier	2016	58,344	84,663	101,663	71,242
	2017	64,102	78,429	87,533	71,052
	2018	63,909	71,584	117,265	71,117
Gjirokastrë	2016	53,053	59,983	63,313	57,068
	2017	53,960	63,699	82,513	62,237
	2018	59,744	66,985	86,789	66,238
Korçë	2016	58,488	73,541	97,193	67,829
	2017	60,240	81,584	103,615	71,063
	2018	66,328	82,144	93,958	74,319
Kukës	2016	61,018	75,420	96,817	68,197
	2017	63,293	63,010	93,691	66,218
	2018	65,871	62,562	77,474	66,326
Lezhë	2016	62,705	92,478	88,801	75,470
	2017	67,462	77,844	85,359	73,057
	2018	58,841	80,361	100,784	72,852
Shkodër	2016	61,014	85,621	117,182	75,503
	2017	68,640	76,025	101,968	73,306
	2018	67,407	74,604	98,941	73,441
Tiranë	2016	62,653	83,848	114,658	85,344
	2017	65,908	83,731	119,092	87,968
	2018	71,171	83,912	110,555	88,691
Vlorë	2016	44,732	65,761	81,688	58,872
	2017	47,988	59,381	96,404	58,374
	2018	56,462	72,719	104,135	68,227
Shqipëri	2016	58,661	78,281	102,682	73,143
	2017	60,451	75,587	109,141	73,400
	2018	64,418	76,746	105,048	75,935

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Tab. 4 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas tipit të familjes dhe qarqeve

Qarku	Viti	Tipi familjes						Gjithsej
		Person i vetëm	Person i vetëm me fëmijë në varësi	Dy të rritur pa fëmijë	Dy të rritur me fëmijë	Tre ose më shumë të rritur pa fëmijë	Tre ose më shumë të rritur me fëmijë	
Berat	2016	34,538	36,073	45,240	66,144	69,325	80,580	64,222
	2017	37,678	55,616	52,747	73,630	73,590	86,915	69,948
	2018	42,186	79,436	55,585	67,347	73,515	91,401	70,737
Dibër	2016	28,228	37,626	34,194	44,573	56,897	82,218	63,212
	2017	22,352	33,506	38,345	44,093	51,423	53,477	47,467
	2018	41,802	-	48,406	54,387	60,994	66,328	58,461
Durrës	2016	42,453	57,500	57,731	76,758	91,349	93,585	77,933
	2017	39,319	67,959	65,490	70,312	84,569	85,184	76,129
	2018	46,587	35,441	67,436	79,856	83,170	79,777	75,744
Elbasan	2016	32,020	54,383	52,206	56,204	59,679	63,849	57,290
	2017	42,026	74,830	50,992	59,484	59,504	63,418	57,831
	2018	42,069	55,087	57,135	68,746	66,441	69,762	63,847
Fier	2016	26,949	49,583	55,092	81,086	72,487	88,926	71,242
	2017	37,696	46,541	51,212	65,382	82,540	82,815	71,052
	2018	28,686	70,096	55,281	82,371	73,301	83,117	71,117
Gjirokastrë	2016	32,148	31,002	42,749	64,904	62,323	72,571	57,068
	2017	33,046	80,920	45,185	78,238	71,435	68,740	62,237
	2018	33,273	-	55,596	75,978	77,866	74,519	66,238
Korçë	2016	33,599	49,052	50,300	77,230	74,087	83,216	67,829
	2017	26,002	35,784	55,767	78,762	79,148	86,228	71,063
	2018	44,287	55,550	61,566	78,182	82,545	89,686	74,319
Kukës	2016	33,925	-	47,853	60,976	69,660	71,867	68,197
	2017	23,063	-	50,409	64,274	67,206	77,147	66,218
	2018	29,483	-	38,568	56,584	83,606	79,079	66,326
Lezhë	2016	23,005	54,074	50,131	69,081	77,772	105,244	75,470
	2017	34,200	46,485	53,162	69,471	79,005	86,967	73,057
	2018	37,048	83,288	54,955	80,201	77,600	84,424	72,852
Shkodër	2016	36,421	74,409	52,531	78,412	85,935	88,209	75,503
	2017	42,782	70,320	55,775	78,478	79,304	81,050	73,306
	2018	44,707	34,746	61,510	66,766	81,646	82,781	73,441
Tiranë	2016	46,927	66,164	63,648	82,600	106,517	96,077	85,344
	2017	50,578	61,801	76,706	87,237	98,783	95,525	87,968
	2018	58,503	81,150	73,968	92,396	96,256	99,139	88,691
Vlorë	2016	24,398	51,266	44,263	59,784	66,722	80,642	58,872
	2017	26,930	42,322	50,743	65,376	59,782	76,240	58,374
	2018	40,586	78,696	56,186	73,111	79,170	80,739	68,227
Shqipëri	2016	36,935	55,485	55,025	74,000	84,376	86,552	73,143
	2017	39,093	55,795	60,329	74,218	81,829	82,669	73,400
	2018	46,146	66,100	62,689	79,680	82,802	85,959	75,935

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Tab. 5 Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas madhësisë së familjes dhe qarqeve

Qarku	Viti	Madhësia e familjes					
		Familje me një person	Familje me 2 persona	Familje me 3 persona	Familje me 4 persona	Familje me 5+ persona	Gjithsej
Berat	2016	34,538	45,240	63,108	73,313	81,169	64,222
	2017	37,678	52,760	63,096	78,577	91,029	69,948
	2018	42,186	55,585	70,482	77,545	87,462	70,737
Dibër	2016	28,228	32,901	50,204	62,570	75,401	63,212
	2017	22,352	38,345	47,353	49,578	52,754	47,467
	2018	41,802	48,406	61,263	57,064	65,115	58,461
Durrës	2016	42,453	58,216	80,659	78,112	100,279	77,933
	2017	39,319	65,453	76,571	79,137	85,892	76,129
	2018	46,587	66,896	82,329	85,021	77,086	75,744
Elbasan	2016	32,020	53,494	53,414	62,746	62,616	57,290
	2017	42,026	50,992	60,732	60,742	61,661	57,831
	2018	42,069	56,904	62,065	71,394	68,771	63,847
Fier	2016	26,949	54,854	66,345	84,345	88,665	71,242
	2017	37,696	51,196	67,411	80,214	84,663	71,052
	2018	28,686	55,253	70,363	79,575	84,822	71,117
Gjirokastrë	2016	32,148	42,749	56,066	68,505	71,400	57,068
	2017	33,046	45,222	68,265	75,932	70,507	62,237
	2018	33,273	55,596	76,277	68,967	82,840	66,238
Korçë	2016	33,599	49,961	73,680	75,139	83,876	67,829
	2017	26,002	55,767	73,321	83,408	84,870	71,063
	2018	44,287	61,367	75,082	85,931	87,298	74,319
Kukës	2016	33,925	47,853	86,414	56,682	71,155	68,197
	2017	23,063	50,409	58,629	65,840	75,448	66,218
	2018	29,483	38,568	64,576	74,929	76,304	66,326
Lezhë	2016	23,005	50,131	65,825	81,216	100,969	75,470
	2017	34,200	51,309	64,069	80,642	87,332	73,057
	2018	37,048	54,955	63,165	81,927	87,634	72,852
Shkodër	2016	36,421	52,949	76,504	88,713	86,687	75,503
	2017	42,782	56,040	69,521	85,516	80,369	73,306
	2018	44,707	61,064	72,540	81,037	82,247	73,441
Tiranë	2016	46,927	63,892	97,210	94,870	97,025	85,344
	2017	50,578	76,898	92,130	95,295	94,918	87,968
	2018	58,503	74,078	87,620	97,012	101,041	88,691
Vlorë	2016	24,398	44,108	53,750	73,530	78,200	58,872
	2017	26,930	50,312	60,245	67,106	73,966	58,374
	2018	40,586	56,542	83,412	73,399	80,102	68,227
Shqipëri	2016	36,935	55,146	76,395	81,895	86,355	73,143
	2017	39,093	60,326	74,865	80,875	82,744	73,400
	2018	46,146	62,651	77,521	83,733	86,206	75,935

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018



5. NIVELI I JETESËS

Niveli i Jetesës në Shqipëri matet nëpërmjet indikatorëve që lidhen me kushtet e banimit, aksesit në shërbimet bazë, zotërimi i pajisjeve afatgjatë të prodhuar nga Anketa e Buxhetit të Familjes. Këta indikatorë përbëjnë një nga burimet kryesore me qëllim prodhimin e mjeteve të domosdoshme në ndihmë të hartuesve të politikave për monitorimin dhe zhvillimin e programeve sociale.

Shpërndarja e familjeve sipas zotërimit të pajisjeve afatgjatë 2016-2018.

Familjet në Shqipëri zotërojnë më së shumti pajisjet afatgjatë kryesore si: televizorë, frigoriferë dhe lavatriçe (më shumë se 90 përqind e NjEF-ve). Por ndër vite familjet në Shqipëri kanë rritur shpenzimet për blerjen e pajisjeve afatgjata si: mikrovalë, panele diellore, kondicionerë apo pajisje me shumë funksione (Tabela.1). Rritja më e lartë e përqindjes së zotërimit të pajisjeve si mikrovala dhe pajisje me shumë funksione, është regjistruar në qarkun e Lezhës, përkatësisht 14,1 dhe 36,1 pikë përqindje. Ndërkohë në qarkun Berat është shënuar rritja më e lartë e përqindjes së zotërimit të paneleve diellore me 8,7 pikë përqindje, ndërsa në qarkun Gjirokastrë është shënuar rritje në zotërimin e kondicionerëve me 11,6 pikë përqindje.

Tab. 1 Zotërimi i pajisjeve afatgjatë të familjes sipas qarqeve

Qarku	Pajisje afatgjatë											
	Mikrovalë			Panele Diellorë			Kondicionerë			Pajisje me shumë funksione (Ipad, Iphone).		
	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018
BERAT	23.3	28.5	30.8	14.3	19.5	22.9	12.3	11.3	13.1	14.2	30.3	37.7
DIBER	17.5	17.4	21.0	-	0.3	2.4	1.5	0.8	3.3	19.5	23.1	38.7
DURRËS	27.0	24.5	26.7	4.0	3.2	6.6	26.8	26.3	27.9	38.8	46.8	55.6
ELBASAN	17.8	13.8	15.7	13.9	12.9	14.5	13.7	10.9	11.6	40.1	40.6	41.8
FIER	19.5	15.8	17.9	14.6	17.3	19.3	11.7	8.5	10.1	21.0	24.4	35.7
GJIROKASTËR	36.9	42.6	47.4	2.1	4.1	7.0	17.2	24.9	28.8	36.9	57.6	61.7
KORÇË	28.4	25.9	27.4	3.3	3.5	4.9	2.1	2.1	4.0	19.3	29.8	43.8
KUKËS	6.6	7.1	12.5	0.0	2.3	1.3	6.5	3.1	4.5	27.8	33.7	46.0
LEZHË	22.5	31.5	36.5	0.8	1.8	1.8	8.6	13.4	15.2	38.8	69.4	74.9
SHKODËR	27.1	24.8	30.3	0.8	0.4	3.0	18.0	15.9	17.5	30.3	43.4	57.8
TIRANË	39.4	43.2	45.2	1.7	2.1	3.9	37.6	44.6	47.3	43.4	63.1	66.0
VLORË	24.3	27.3	31.9	2.0	2.4	4.5	18.4	22.2	26.1	27.0	40.6	42.6
SHQIPËRI	28.2	28.9	31.8	5.1	5.6	7.6	21.0	22.8	25.2	33.2	46.0	53.1

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Shpërndarja e familjeve sipas burimit kryesor të ngrohjes, 2016 -2018.

Burimet kryesore të ngrohjes në familjet shqipëtare për vitin 2018 janë drutë e zjarrit dhe qymyri(50,3%), ndjekur nga energjia elektrike (39,3%) dhe gazi (10,2%). Në vitin 2018, përqindjet më të larta të familjeve që përdorin gazin si burim kryesor të ngrohjes janë regjistruar në qarkun Durrës (37,5%) kurse në qarkun

Vlorë është regjistruar përqindja më e lartë e përdorimit të energjisë elektrike si burim kryesor të ngrohjes (68,2%). Rreth më shumë se 90 përqind e familjeve në Dibër, Korçë dhe Kukës në vitin 2018 kanë përdorur drutë e zjarrit apo qymyr si burim kryesor të ngrohjes.

Tab. 2 Shpërndarja e familjeve sipas burimit kryesor të ngrohjes.

Qarku		Burimi kryesor i ngrohjes (%)			
		Gaz	Energji elektrike	Dru zjarri/Qymyr, etj.	Vajgur/lëndë të tjera djegëse,etj.
Berat	2016	19.1	20.4	58.8	1.7
	2017	10.9	20.5	67.3	1.3
	2018	13.0	24.5	62.6	-
Dibër	2016	-	19.6	80.4	-
	2017	-	9.6	90.4	-
	2018	2.6	8.5	88.9	-
Durrës	2016	32.8	38.6	26.5	2.1
	2017	35.2	38.4	25.4	1.0
	2018	37.5	37.3	25.2	0.1
Elbasan	2016	5.5	23.5	70.8	0.2
	2017	3.9	25.6	70.4	0.1
	2018	3.3	28.8	67.8	0.1
Fier	2016	10.9	22.2	61.9	5.0
	2017	13.0	23.5	61.5	2.0
	2018	7.6	28.1	63.8	0.5
Gjirokastrë	2016	6.8	28.5	63.5	1.2
	2017	2.2	33.9	63.0	0.9
	2018	0.5	30.3	69.2	-
Korçë	2016	1.2	6.3	92.2	0.3
	2017	4.8	9.3	85.5	0.5
	2018	2.1	7.9	90.0	-
Kukës	2016	0.0	0.1	99.5	0.4
	2017	5.3	8.4	85.3	1.0
	2018	-	3.7	96.3	-
Lezhë	2016	20.3	15.7	62.4	1.5
	2017	12.2	20.2	67.6	-
	2018	7.5	38.0	54.5	-
Shkodër	2016	14.7	16.4	67.0	1.9
	2017	14.9	12.6	70.5	2.0
	2018	16.7	13.5	69.2	0.6
Tiranë	2016	10.7	59.9	28.5	0.8
	2017	7.3	63.2	28.5	0.9
	2018	9.4	62.9	27.6	0.1
Vlorë	2016	9.2	51.5	34.5	4.8
	2017	5.7	64.9	27.2	2.2
	2018	2.8	68.2	28.6	0.5
Shqipëri	2016	12.0	35.2	51.1	1.7
	2017	10.3	37.5	51.1	1.0
	2018	10.2	39.3	50.3	0.2

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Shpërndarja e familjeve sipas sipërfaqes së përdorur për banim, 2016-2018.

Në vitin 2018, 52,2 përqind e familjeve në Shqipëri jetojnë në banesa, sipërfaqet e të cilave janë nga 51 në 90 m². Banesat sipërfaqet e të cilave variojnë nga 91-130 m², renditen në vendin e dytë për sa i përket përqendrimit të familjeve që jetojnë në to, 33,9 përqind.

Në vitin 2018, përqindja më e lartë e familjeve të cilat jetojnë në banesa sipërfaqja e të cilave varion nga 51-90 m² është regjistruar në qarkun Kukës (61,7%),

ndërsa në qarkun Elbasan është regjistruar përqindja më e lartë e familjeve (39,6%) që jetojnë në banesa me sipërfaqe 91 - 130m².

Gjatë viteve është regjistruar një rritje e përqindjes së familjeve të cilat jetojnë në banesa sipërfaqja e të cilave është mbi 90 m². Nga viti 2016 në 2018, për qarkun e Lezhë, vihet re një ulje prej 4.9 pikë përqindje e familjeve të cilat jetojnë në banesa me sipërfaqe me më pak se 50m². Në qarqet Fier, Tiranë dhe Durrës janë regjistruar rritjet më të larta të familjeve që jetojnë në banesa me më shumë se 130m².

Tab. 3 Shpërndarja e familjeve sipas sipërfaqes së përdorur për banim.

Qarku	Sipërfaqja e banesës											
	më pak se 50m ²			51-90m ²			91-130m ²			mbi 130m ²		
	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018
BERAT	6.5	8.2	7.5	65.3	52.1	56.0	26.0	37.2	33.9	2.2	2.5	2.7
DIBER	1.2	2.2	9.7	42.6	56.2	57.5	50.7	38.2	31.1	5.6	3.4	1.7
DURRËS	4.8	5.5	4.7	52.1	50.1	50.6	35.3	33.5	34.3	7.8	10.9	10.4
ELBASAN	7.5	7.4	8.5	47.3	39.7	44.6	35.7	43.6	39.6	9.5	9.3	7.3
FIER	7.2	11.5	9.3	55.0	49.2	48.8	34.8	34.5	35.6	3.0	4.8	6.4
GJIROKASTËR	8.1	7.9	6.1	61.8	54.8	53.8	24.9	32.9	37.7	5.1	4.3	2.5
KORÇË	13.0	11.8	13.9	55.0	61.0	55.2	24.6	23.0	26.5	7.4	4.3	4.3
KUKËS	5.7	7.8	6.0	62.1	66.1	61.7	28.8	23.3	31.4	3.4	2.8	0.9
LEZHË	14.3	8.1	9.4	48.7	48.4	53.3	30.0	38.3	32.2	6.9	5.3	5.1
SHKODËR	9.2	12.1	9.7	50.5	53.9	59.0	32.2	28.6	28.1	8.1	5.5	3.2
TIRANË	5.6	5.4	4.5	51.1	48.2	50.1	37.0	36.7	36.0	6.4	9.7	9.3
VLORË	7.0	6.1	6.6	58.3	54.5	59.5	30.0	34.6	29.2	4.7	4.9	4.7
SHQIPËRI	7.1	7.5	7.2	52.9	50.6	52.2	33.8	34.8	33.9	6.2	7.1	6.7

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Burimi i të dhënave

Anketa e Buxhetit të Familjes, 2016, 2017, 2018

Përkufizime

Sipërfaqja: Sipërfaqja e banimit nga NjEF (nuk përfshihen verandat, ballkonet, garazhet apo sipërfaqet e përbashkëta në përdorim).

Burimi kryesor i ngrohjes: është burimi kryesor që përdoret për të ngrohur pjesën më të madhe të banesës.

Pajisje afatgjatë: është një kategori e mallrave të konsumit të cilat nuk blihen shpesh, duke supozuar një normë normale ose mesatare të përdorimit/amortizimit fizik.



6. ARSIMI

Të dhënat për arsimin zyrtar mbledhen sipas niveleve arsimore dhe shërbejnë si burimi kryesor për prodhimin e statistikave dhe indikatorëve të arsimit. Në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të tyre përdoret ISCED 2011, klasifikimi ndërkombëtar standard i arsimit, rekomanduar nga Eurostat dhe UNESCO.

Burimi kryesor i të dhënave është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjithashtu Ministria e Financave dhe Ekonomisë për arsimin profesional.

Në bazë të informacionit të marrë, INSTAT përpunon të dhënat dhe llogarit treguesit sipas niveleve arsimore: për arsimin parashkollor, arsimin e detyruar 9 vjeçar, arsimin e mesëm gjimnaz profesional dhe social kulturor, për arsimin e lartë sipas programeve, etj. Treguesit llogariten sipas viteve shkollorë / akademikë, në nivel vendi dhe qarku për arsimin parauniversitar dhe në nivel vendi për arsimin e lartë.


Ky publikim përmbledh të dhëna dhe tregues kryesorë, në të cilin tabelat dhe grafikët japin një paraqitje të arsimit parauniversitar në vend, por kryesisht në të gjitha qarqet, duke krijuar mundësi krahasimi ndërmjet tyre.

Numri i nxënësve të arsimit parauniversitar ka një ulje të vazhdueshme në vlerë absolute. Në vitin shkollor 2018-2019 morën pjesë në arsimin parauniversitar 502.120 nxënës dhe fëmijë, duke shënuar një ulje prej 3,6 %, krahasuar me vitin shkollor 2017-2018. Rënia e numrit të nxënësve në vlerë absolute, ndjek rënien e popullsisë së grup moshës që i përket arsimit parauniversitar.

Në vitin shkollor 2018-2019, morën pjesë gjithsej në arsimin parashkollor 78.942 fëmijë, duke shënuar një ulje prej 2,6 %, ndërsa morën pjesë në arsimin 9-vjeçar 306.530 nxënës, duke shënuar një ulje prej 4,1 %, krahasuar me vitin paraardhës.

Në arsimin e mesëm publik ndjekin studimet 87,6 % e nxënësve të arsimit të mesëm gjithsej. Nxënësit e regjistruar në arsimin publik në të gjithë qarqet përbëjnë shumicën, krahasuar me regjistrimet në arsimin privat. Megjithatë vihen re diferenca të ndjeshme midis qarqeve të Shkodrës, Vlorës, Fierit dhe Tiranës, të cilët kanë përqindje më të lartë të arsimit të mesëm privat dhe qarqeve të Gjirokastrës, Elbasanit dhe Beratit ku arsimit privat përbën vetëm një përqindje të vogël ndaj arsimit të mesëm gjithsej. Në qarkun e Kukësit dhe Dibrës nuk ka arsim të mesëm privat.

Fig. 1 Të regjistruar në arsimin e mesëm publik dhe privat, sipas qarqeve 2018-2019



Burimi: Llogaritjet kryer nga INSTAT i të dhënave administrative të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Arsimi profesional ka qenë prioritet vitet e fundit, duke u parë si një mundësi për të plotësuar nevojën e vazhdueshme për punonjës të specializuar në profesione të ndryshme. Për këtë arsye pjesëmarrja në arsimin profesional ka pësuar rritje nga viti në vit, ku në vitin e fundit rritja rezulton të jetë 1.09 pikë përqindje krahasuar me 2017-18. Të regjistruarit e arsimit të mesëm profesional për vitin 2018-2019 përbëjnë 18,2 % të totalit të regjistruarve të arsimit të mesëm, ndërsa vetëm në arsimin publik ato përbëjnë 18,9 %. Rritjen më të lartë për arsimin profesional publik në këtë vit, krahasuar me vitin 2017-2018, e kanë qarqet Durrës, Dibër, Shkodër dhe Lezhë, ndërsa me ulje janë qarqet Fier, Kukës dhe lehtësisht Berati.


Në vitin 2018, u diplomuan 37.795 nxënës në arsimin 9 - vjeçar, ose 95,4 % e nxënësve të klasës së nëntë të vitit shkollor 2017-2018, duke shënuar një rënie prej 1 pikë përqindje, krahasuar me vitin paraardhës.

Në vitin 2018, në arsimin e mesëm u diplomuan 35.278 nxënës, me një rënie prej 3,2 %, krahasuar me 2017.


Të diplomuarit e arsimit profesional në vitin 2018 përbëjnë 11,9 % të të diplomuarve gjithsej të arsimit të mesëm. Rritja më e madhe e të diplomuarve të arsimit profesional në vitin shkollor 2018 i takon qarqeve Gjirokastrë, Durrës dhe Lezhë me përkatësisht 3,0, 2,6 dhe 2,6 pikë përqindje më shumë se viti 2017. Ndërsa në qarqet e Vlorës dhe Korçës, vërehen uljet më të mëdha ndër të diplomuarit e arsimin profesional prej përkatësisht 7,1 dhe 5,4 pikë përqindje.

Në vitin 2018, nxënësit e diplomuar në arsimin e mesëm publik, që i përkasin gjimnazeve, përbëjnë 83,9 %, në arsimin profesional janë diplomuar 12,6% ndërsa 3,5 % e tyre i përkasin arsimit social kulturor. Përqindja më e lartë e nxënësve të diplomuar në arsimin e mesëm publik profesional është në qarkun e Durrësit dhe Tiranës prej 17,3 dhe 15,3 %, më e ulëta rezulton qarku Dibër e Gjirokastrë, ndërsa Kukësi nuk ka arsim profesional.

Fig. 2 Përqindja e të regjistruarve në arsimin profesional publik sipas qarqeve 2017-18 dhe 2018-19.



Burimi: Llogaritjet kryer nga INSTAT i të dhënave administrative të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.


Fig. 3 Shpërndarja e të diplomuarve në arsimin e mesëm publik sipas programeve dhe qarqeve, 2018.

Burimi: Llogaritjet kryer nga INSTAT i të dhënave administrative të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.


Raporti i nxënësve për një mësues shihet si tregues cilësie në procesin e mësimdhënies. Ky tregues është i ndryshëm, për qarqe të ndryshme. Në arsimin fillor privat në nivel vendi ky tregues është 2,9 nxënës për mësues më i ulët se në atë publik, por në qarkun e Elbasanit arrin në 20,7 nxënës për një mësues, në qarkun e Fierit 19,7 nxënës për një mësues, ndërsa ka

vlerat më të ulta në qarkun e Dibrës dhe Tiranës me përkatësisht 10,0 dhe 12,0 nxënës për një mësues.

Në arsimin fillor publik raporti është më i ulët në qarkun e Gjirokastrës me 9,4 nxënës për mësues dhe më i lartë në qarkun e Durrësit dhe Tiranës, përkatësisht 17,5 dhe 15,6 nxënës për një mësues.

Fig. 4 Raporti nxënës për mësues në arsimin fillor publik dhe privat sipas qarqeve, 2018 – 2019

Burimi: Llogaritjet kryer nga INSTAT i të dhënave administrative të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Fig. 5 Raporti nxënës për klasë në arsimin fillor publik dhe privatsipas qarqeve, 2018 – 2019.

Burimi: Llogaritjet kryer nga INSTAT i të dhënave administrative të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Tab. 1 Viti Shkollor 2018-2019, sipas bashkive

Bashkia	Fëmijë në Kopshte Publik	Nxënës në arsimin 9 vjeçar Publik	Nxënës për klasë 9 vjeçar Publik	Nxënës për mësues 9 vjeçar Publik	Nxënës në arsimin e mesëm Publik	Nga këto në %		
						Në Gjimnaze	Në Gjimnaze të orientuara (Social kulturore)	Në Shkolla Profesionale
Berat	1651	5578	19.0	12.1	2602	72.2	3.8	23.9
Ure Vajgurore	922	3006	17.4	11.7	908	100.0	0.0	0.0
Bulqizë	941	3665	17.3	11.1	1062	91.8	0.0	8.2
Delvinë	232	728	17.5	8.3	224	100.0	0.0	0.0
Finiq	107	322	0.0	6.2	72	100.0	0.0	0.0
Devoll	823	2327	18.8	10.8	742	100.0	0.0	0.0
Dibër	2077	7291	17.7	11.0	2303	84.4	0.0	15.6
Durrës	3639	20030	25.0	17.2	8111	56.3	6.4	37.3
Shijak	657	2520	20.0	13.8	442	100.0	0.0	0.0
Elbasan	4049	13807	20.2	11.6	6087	66.8	6.1	27.0
Cërrik	775	2359	16.8	11.1	847	86.0	0.0	14.0
Belsh	477	1966	15.7	10.7	467	100.0	0.0	0.0
Fier	2780	11486	19.7	12.3	4035	68.2	2.9	28.8
Patos	580	2149	20.2	12.6	494	100.0	0.0	0.0
Roskovec	484	2242	17.2	11.3	576	100.0	0.0	0.0
Gjirokastrë	865	2390	19.9	11.2	1268	72.9	11.0	16.1
Dropull	27	103	9.3	5.2	71	100.0	0.0	0.0
Libohovë	96	286	16.9	7.9	79	100.0	0.0	0.0
Gramsh	831	2473	15.7	7.7	798	100.0	0.0	0.0
Has	571	2075	18.3	11.9	697	100.0	0.0	0.0
Kamez	2612	14311	28.5	20.0	5232	65.3	0.0	34.7
Kavajë	1116	3949	19.2	10.9	1205	78.8	1.4	19.8
Rrogozhinë	588	2082	16.1	8.9	503	100.0	0.0	0.0
Kolonjë	256	794	19.3	7.4	269	100.0	0.0	0.0
Korçë	2046	6501	18.9	11.9	2981	54.7	9.6	35.7
Maliq	1292	3849	16.9	10.7	921	100.0	0.0	0.0
Pustec	66	125	6.9	5.0	26	100.0	0.0	0.0
Krujë	1584	7191	22.0	14.7	2184	100.0	0.0	0.0
Kuçovë	793	2668	18.9	11.1	963	100.0	0.0	0.0
Kukës	1659	6114	18.9	10.9	2259	95.0	0.0	5.0
Kurbin	1444	5128	20.4	13.1	1711	100.0	0.0	0.0
Lezhë	1663	6664	19.8	12.5	2537	76.3	0.0	23.7
Librazhd	1056	3360	16.4	8.8	969	100.0	0.0	0.0
Prrenjas	761	2954	19.4	11.9	942	100.0	0.0	0.0
Lushnje	2232	7340	18.1	11.3	2676	79.1	0.0	20.9
Divjakë	1021	3421	19.4	11.6	1082	100.0	0.0	0.0
Malësi e Madhe	572	2508	15.5	8.0	850	100.0	0.0	0.0
Mallakastër	705	2732	16.9	10.0	705	100.0	0.0	0.0
Burrel	744	2663	19.3	9.3	1031	100.0	0.0	0.0
Klos	405	1619	16.0	8.4	544	100.0	0.0	0.0
Mirditë	437	1751	16.8	8.8	659	87.1	0.0	12.9
Peqin	599	2529	17.0	10.2	597	100.0	0.0	0.0
Përmet	213	791	17.1	8.6	307	100.0	0.0	0.0
Këlcyre	129	518	15.9	8.2	185	100.0	0.0	0.0
Pogradec	2088	6220	18.5	11.5	2243	88.4	0.0	11.6
Pukë	246	843	16.2	7.0	348	100.0	0.0	0.0
Fushë-arrës	149	657	21.9	6.1	184	100.0	0.0	0.0
Sarandë	774	3068	26.4	17.5	983	75.9	0.0	24.1
Konispol	185	530	17.0	10.8	64	100.0	0.0	0.0
Skrapar	264	989	13.4	6.4	464	100.0	0.0	0.0
Polican	224	909	17.9	10.3	239	100.0	0.0	0.0
Shkodër	2076	11346	17.6	10.4	5053	59.5	12.5	28.0
Vau Dejës	639	2482	15.8	9.4	728	76.0	0.0	24.0
Tepelenë	324	811	16.9	7.2	212	100.0	0.0	0.0
Memaliaj	278	869	11.4	6.4	313	100.0	0.0	0.0
Tiranë	12816	60599	27.2	17.8	22218	72.7	7.3	20.0
Vorë	812	1696	22.4	14.0	885	100.0	0.0	0.0
Tropojë	541	2102	13.8	8.0	852	100.0	0.0	0.0
Vlorë	2939	9475	21.4	12.6	3594	66.8	3.0	30.1
Himarë	209	599	13.8	9.8	167	100.0	0.0	0.0
Selenicë	422	1346	13.7	8.5	386	100.0	0.0	0.0
Shqipëria	71563	282906	20.9	12.6	102156	77.3	3.8	18.9

Burimi: Llogaritjet kryer nga INSTAT i të dhënave administrative të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Burimi i të dhënave

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Metodologjia

Klasifikimi ISCED-2011, që përdoret në statistikat e arsimit, është i përbërë nga këto nivele sipas programeve arsimore:

Niveli 0 - Arsimi Parashkollor – çerdhe / kopshte

Niveli 1 - Arsimi Fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesme, por jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër

Niveli 6 – Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime

Arsimi zyrtar është përcaktuar si arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe atyre private, të njohura (licensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevoja të veçanta dhe disa pjesë të arsimit për të rritur, shpesh janë të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

Arsimi parauniversitar përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar dhe fillon në moshën 6 vjeç duke zgjatur 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin, arsimin profesional, i cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë, si edhe atë social-kulturor.

Arsimi socio kulturor, ose arsimi i mesëm i orientuar përfshin programe të tilla si gjuhë të huaja, ato artistike apo sportive.

Mësues janë përcaktuar personat, aktiviteti profesional i të cilëve përfshin transmetimin e njohurive, sjelljeve dhe aftësive që janë përcaktuar në programin arsimor tek nxënësit dhe studentët e regjistruar në institucionet zyrtare arsimore.

Institucion arsimor publik klasifikohet i tillë, nëse aktiviteti i tij kontrollohet plotësisht nga autoriteti arsimor publik.

I diplomuar, në një program arsimor, është një nxënës ose student i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit në të cilin ka studiuar.

Raporti nxënës për mësues i llogaritur për qark në arsimin 9 vjeçar tregon numrin mesatar të nxënësve të regjistruar në shkollat e një qarku që i përkasin një mësuesi të qarkut, llogaritur veç për arsimin publik ose privat. Për arsimin e mesëm ky tregues llogaritet për sistemin pa shkëputje nga puna.

Raporti nxënës për klasë tregon numrin mesatar të nxënësve të regjistruar për numrin e klasave për të gjithë vendin. Të dhënat përfshijnë vetëm programe të rregullta në nivele të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe përjashtojnë mësimet në nëngrupe jashtë mjedisit të rregullt të klasës.



7. TREGUESIT SHËNDETËSOR

Në këtë kapitull paraqiten statistikën e shëndetit publik duke ofruar informacion mbi shkaqet e vdekjeve, shpërndarjen e shërbimeve shëndetësore, sëmundshmërinë si dhe personat me aftësi të kufizuar që janë pjesë e skemave të shërbimit social shtetëror. Gjithashtu në këtë kapitull do të paraqiten disa nga të dhënat e fundit të studimit demografik dhe shëndetësor në Shqipëri (ADHS 2017-2018) për konsumin e duhanit, alkoolit dhe ushtrimin e aktiviteteve fizike.

Shëndeti është përparësi dhe informacioni mbi shëndetin është shumë i rëndësishëm për qytetarët që duan të kenë një jetë të shëndetshme, të parandalojnë sëmundjet dhe kërkojnë të marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore. Sigurimi dhe shpërndarja e shërbimit të kujdesit shëndetësor publik në Shqipëri është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Shkaqet e vdekjeve

Shkaqet e vdekjeve përcaktohen nga disa faktorë si mosha, gjinia, kushtet e jetesës, puna dhe mjedisi rrethues. Gjithashtu çdo individ mund të ndikojë në mundësitë e tij për të pasur një jetë të gjatë dhe të shëndetshme duke përshtatur zgjedhjet e tij të jetesës, si për shembull, kontrollet mjeksore, aktiviteti fizik, ushqyerja e shëndetshme dhe eliminimi i sjelljeve

me risk për shëndetin si; konsumimi i alkoolit, pirja e duhanit, parandalimi i aksidenteve rrugore etj.

Në vitin 2018, në Shqipëri numri i vdekjeve nga të gjitha shkaqet ishte 21.804. Ky numër në nivel vendi shënon një rënie të vdekjeve me 1.9 % në krahasim me një vit më parë. Në nivel qarku, Kukësi dhe Gjirokastra kanë rënien më të lartë të numrit të vdekjeve në përqindje përkatësisht me 17,7 % dhe 9,4 %. Ndërkohë Dibra dhe Vlora kanë një rritje në përqindje të vdekjeve respektivisht me 6,1 % dhe 2,4 %.

Në vitin 2018, shkaktarët kryesorë të vdekjeve për të gjitha qarqet vazhdojnë të jenë “Sëmundjet e qarkullimit të gjakut” dhe sëmundjet nga “Tumoret”.


Tabela më poshtë tregon përqindjen e shkaqeve të vdekjeve nga dy grupsëmundjet që zënë peshën më të madhe të vdekshmërisë në vend, përkatësisht “Sëmundjet e aparatit të qarkullit të gjakut” dhe “Tumoret”. Në nivel vendi 53.2 % vdekjeve gjithsej janë si pasojë e grupit të sëmundjeve të qarkullit të gjakut dhe 16.9 % janë si pasojë e tumoreve. Sipas qarqeve Kukësi ka përqindjen më të lartë të vdekshmërisë për sëmundjen e aparatit të qarkullimit të gjakut me 63.1 % të vdekjeve të shkaktuara nga ky grup. Për grupsëmundjen e “tumoreve” qarku i Shkodrës dhe i Vlorës kanë përqindjen më të lartë të vdekshmërisë nga ky grup me 18.7 % të vdekjeve të shkaktuara nga ky grupsëmundje.

Tab. 1 Shkaqet e vdekjeve sipas qarqeve, grupmoshës dhe grupsëmundjeve kryesore, viti 2018 (në %)


Qarku	nën 65 vjeç		65+		Gjithsej Tumore	Gjithsej Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut
	Tumore	Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	Tumore	Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut		
Berat	6.8	6.1	10.6	50.2	17.4	56.3
Dibër	6.5	7.8	11.5	50.5	17.9	58.3
Durrës	5.4	7.6	9.5	44.2	14.9	51.8
Elbasan	6.6	7.9	12.0	35.1	18.6	43.0
Fier	5.3	5.3	10.6	47.3	15.9	52.6
Gjirokastrë	5.8	6.5	11.3	34.9	17.1	41.4
Korçë	6.7	6.6	10.9	44.8	17.5	51.3
Kukës	8.8	10.0	6.2	53.2	14.9	63.1
Lezhë	6.2	6.1	10.5	40.9	16.6	47.0
Shkodër	6.5	6.3	12.3	48.0	18.7	54.3
Tiranë	5.7	8.4	10.5	50.8	16.1	59.3
Vlorë	6.3	6.1	12.4	46.7	18.7	52.8
Shqipëria	6.1	10.9	7.1	46.1	17.0	53.2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, llogaritur nga INSTAT

**Harta 1. Shkaqet e vdekjeve sipas qarqeve
Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut, 2018**



**Harta 2. Shkaqet e vdekjeve sipas qarqeve
Tumoret, 2018**




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, llogaritur nga INSTAT

Gjatë vitit 2018, sëmundshmëria e raportuar për Hipertensionin Arterial dhe Diabetin në kujdesin shëndetësor parësor vazhdon të ngelet më e larta mes gjithë sëmundjeve të tjera kronike të raportuara. Duhet nënvizuar se disa probleme shëndetësore kronike si hipertensioni dhe diabeti, megjithëse klasifikohen si sëmundje, mund të konsiderohen edhe si faktorë risku


për sëmundjet e qarkullimit të gjakut. Në grafikët e mëposhtëm, paraqiten rastet e regjistruara për këto sëmundje sipas qarqeve të llogaritura për 10 mijë banorë. Për llogaritjen e prevalencës informacioni është marrë nga regjistrat e mjekëve të familjes në të cilët mjekët i regjistrojnë rastet të ndara sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-9.

Fig. 1 Prevalenca e Hipertensionit Arterial (HTA) për 10 mijë banorë, sipas qarqeve



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, FSDKSH, llogaritur nga INSTAT

Fig. 2 Prevalenca e Hipertensionit Arterial (HTA) për 10 mijë banorë, sipas qarqeve



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, FSDKSH, llogaritur nga INSTAT

Shërbimi shëndetësor parësor

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është pika e parë e kontaktit të popullsisë për zgjidhjen e problemeve shëndetësore. Institucionet bazë që ofrojnë këto shërbime janë poliklinikat, qendrat shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsultoreve të fëmijëve dhe të gruas. Numri më i madh i këtyre institucioneve është përqendruar në qarqet ku dhe numri i popullsisë është më i lartë, në Tiranë, Elbasan, Fier dhe Shkodër. Gjatë vitit 2018, numri mesatar i kontakteve të popullsisë në shërbimin parësor në nivel vendi, është 3 kontakte për person. Ky tregues është më i lartë në qarkun e Lezhës me 4 kontakte për person dhe më i ulët në qarkun e Kukësit me 2 kontakte për person.

Tab. 2 Numri qendrave shëndetësore, personelit mjekësor në shërbimin parësor, numri mesatar i kontakteve, viti 2018

Qarku	Qendra shëndetësore gjithsejt	Numri i mjekëve të familjes në shërbimin parësor	Numri i infermierëve në shërbimin parësor	Numri mesatar i viziatve në shërbimin parësor
Berat	22	74	475	3.0
Dibër	34	54	528	3.1
Durrës	24	216	632	2.6
Elbasan	53	165	703	2.8
Fier	45	156	641	2.8
Gjirokastrë	31	55	382	3.3
Korçë	40	119	602	2.9
Kukës	27	48	335	1.9
Lezhë	22	85	380	4.0
Shkodër	35	109	619	2.8
Tiranë	51	629	1.009	2.9
Vlorë	29	116	478	2.6
Shqipëria	413	1.826	6.784	2.9

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, FSDKSH, llogaritur nga INSTAT

Shërbimi spitalor

Tirana vazhdon të jetë qarku që ka numrin më të lartë të spitaleve dhe të shtretërve spitalor, kjo lidhet jo vetëm me numrin e lartë të popullsisë në këtë rajon, por dhe me përqëndrimin e shërbimeve spitalore universitare më të specializuara në funksion të popullsisë për të gjithë vendin. Numri i shtretërve spitalor, së bashku me numrin e mjekëve dhe infermierëve që punojnë në spitale është i lidhur dhe me madhësinë e popullsisë në qarqe.

Tabela 3 Numri i spitaleve, shtretërve spitalore, personeli mjek /infermiere në spitalet Rajonale

Qarku	Numri i spitaleve publike dhe private	Shtretër spitalore, publik dhe privat	Shtreter spitalor per banore	Numri i mjekëve në spitale/publike	Numri i infermierëve në spitale/publike
Berat	3	383	30.3	85	253
Dibër	3	512	42.7	55	313
Durrës	2	464	16.0	177	384
Elbasan	5	1024	37.0	133	547
Fier	4	597	20.1	161	361
Gjirokastër	3	344	55.3	66	218
Korçë	4	752	36.0	125	462
Kukës	3	361	46.9	54	235
Lezhë	3	323	25.6	70	254
Shkodër	2	581	28.5	112	395
Tiranë	19	2.932	33.0	676	1.824
Vlorë	4	595	31.4	137	383
Shqipëria	55	8.868	30.9	1.851	5.629

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, FSDKSH, llogaritur nga INSTAT

Faktorët e riskut në shëndet

Eliminimi i sjelljeve të konsideruara me risk për shëndetin si: konsumimi i alkoolit, pirja e duhanit dhe jeta sedentare luajnë një rol të madh në shëndetin e çdo personi. Ato kanë ndikim të rëndësishëm në rritjen e jetëgjatësisë të shëndetshme nëpërmjet parandalimit të shumë sëmundjeve kronike si hipertensioni, yndyrat në gjak dhe obeziteti etj.

Sipas studimit të fundit Demografik dhe Shëndetësor (2017/18), 5,0 % e grave dhe 36 % e burrave të moshës 15-49 vjeç ishin duhanpirës. Të dhënat sipas qarqeve tregojnë se përqindja më e lartë e burrave 15-49 vjeç që pijnë duhan është në qarkun Vlorë me 44,9 % dhe më e ulta është në qarkun Korçë me 22,9 %. Ndërkohë përqindja më e lartë e grave që pijnë duhan është

është në qarkun e Tiranës me 7,2 % dhe më e ulta në qarkun e Kukësit me 0,2 %.

Sipas të njëjtit studim, më shumë se 1 në 4 gra (28%) dhe 6 në 10 burra (60%) të moshës 15-49 vjeç kanë konsumuar alkool në 12 muajt e fundit. Figura e mëposhtme paraqet tregues të konsumit të alkoolit sipas qarqeve dhe gjinisë. Përqindja e grave të moshës 15-49 vjeç që konsumojnë alkool është më e lartë në qarkun e Beratit 44,1 %, Tiranës 40,7 % dhe Vlorës 36,8 %. Ndërkohë përqindja më e ulët është në qarkun Kukës 4,0 %, Dibër 5,0 % dhe Shkodër 7,4 %.


Përqindja më e lartë e burrave që konsumojnë alkool është më e lartë në Qarkun Fier 88,4 %, Berat 87,1 % dhe Lezhë me 67,3 % dhe përqindja më e ulët është në qarkun Dibër 28,2 % dhe Kukës me 39.1 %.

Tab. 4 Konsumi në përqindje i alkoolit sipas qarqeve dhe gjinisë


Qarku	Gra		Burra	
	Nuk konsumojnë alkool gjatë 12 muajve	Konsumojnë alkool gjatë 12 muajve	Nuk konsumojnë alkool gjatë 12 muajve	Konsumojnë alkool gjatë 12 muajve
Berat	55.9	44.1	12.9	87.1
Dibër	95	5	71.8	28.2
Durrës	84.2	15.8	51.9	48.1
Elbasan	75.1	24.9	50.4	49.6
Fier	66.4	33.6	11.6	88.4
Gjirokastrë	69.4	30.6	50.4	49.6
Korçë	77.3	22.7	38.7	61.3
Kukës	96	4	60.9	39.1
Lezhe	80.9	19.1	32.7	67.3
Shkodër	92.6	7.4	55.2	44.8
Tirana	59.3	40.7	38	62
Vlorë	63.2	36.8	36.2	63.8
Shqipëria	71.7	28.3	40.4	59.6

Burimi: Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2017-18

Harta 3. Konsumi i duhanit tek meshkujt, 2018




Harta 4. Konsumi i duhanit tek femrat, 2018



Aktiviteti fizik është një tjetër faktor me rëndësi të veçantë në shëndetin e njeriut. Sipas studimit të fundit Demografik dhe Shëndetësor (2017/18) rreth 1 në 10 burra dhe gra të moshës 15-49 vjeç përfshihen në aktivitet të rregullt fizik (5-7 ditë në javë).

Grafiku i mëposhtëm tregon të dhënat sipas qarqeve për përqindjen e personave që kryejnë aktivitet fizik të paktën një ditë në javë. Të dhëna për burrat tregojnë se qarqet me përqindje më të lartë që kryejnë aktivitet fizik janë Tirana dhe Vlora, përkatësisht 38.2 % dhe 30.7 %. Ndërkohë për gratë qarqet me përqindjen më të lartë e kanë Tirana dhe Elbasani, 28.1% dhe 24.7 %.

Fig 3. Përqindja e personave që kryejnë aktivitetin fizik sipas qarqeve dhe gjinisë



Burimi: Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2017-18, 15-49 vjeç


Aftësitë e kufizuara

Pjesë e rëndësishme e kujdesit shëndetësor është kujdesi ndaj personave me aftësi të kufizuar. Evidentimi i personave të kësaj kategorie si dhe i strukturës së paaftësisë sipas qarqeve është një tregues i rëndësishëm për hartimin e politikave, në funksion të ndihmës dhe përfshirjes së këtyre personave në shkollim, punësim dhe aktivitete të ndryshme shoqërore. Të dhënat administrative për personat me aftësi të kufizuar bazohen në raportin

mjeko-ligjor të lëshuar nga mjeku. Numri më i lartë i përqindjes së personave të kësaj kategorie në raport me popullsinë është regjistruar në Qarkun e Elbasanit dhe të Gjirokastrës.


Përsa i përket llojit të paaftësisë struktura në të gjithë qarqet e vendit ngelet e njëjtë mbi 60 % e personave të regjistruar në çdo qark janë të shënuar me kufizime Mendore dhe Fizike.

Fig 4. Përqindja e personave me aftësi të kufizuara, sipas qarqeve , viti 2018



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, llogaritur nga INSTAT

Fig 5. Personat me aftësi të kufizuar sipas qarqeve dhe llojit të paaftësisë, viti 2018



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, llogaritur nga INSTAT

Burimi i të dhënave

INSTAT është një nga institucionet kryesore në vend që publikon të dhëna mbi treguesit shëndetësor dhe shëndetin. Burim të dhënash në përgjithësi janë të dhënat administrative si dhe vrojtime të veçanta në vite që janë kryer dhe kryhen nga institucioni. Të dhënat statistikore administrative sigurohen nga institucionet shëndetësore ku burim kryesor për këto të dhëna janë regjistrat kombëtar të pacientëve ose raportet e përvitshme nga regjistra themeltar të institucioneve, që raportohen në formate të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Zgjedhja dhe caktimi i kriterëve metodologjike bëhet duke u mbështetur në koncepte, përkufizime, metoda të krahasueshme ndërkombëtare. Në këtë botim burime të dhënash për tregues të ndryshëm janë ato administrative të marra në bazë të evidencave statistikore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor dhe Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2017-18. Në këtë kapitull janë të pasqyruar informacione si për aktivitetin e institucioneve parandaluese e kuruese, ashtu edhe të dhëna të siguruara nga studimet në popullatë.

Përkufizime

Shkaku i vdekjes është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (Përkshkruhet në certifikatën e vdekjes). Burimi i të dhënave është Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Klasifikimi Ndërkombëtar "ICD-9" është klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve, sipas një kodi individual standard. Kodimi për shkaqet e vdekjeve bëhet nga mjeku dhe përbën burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

Vdekja nënkupton zhdukjen e qëndrueshme të të gjitha shenjave të jetës në një moment të çfarëdoshëm pas një lindje të gjallë (ndërprerjen e funksioneve jetësore pa mundësi re animimi). Ky përkufizim nuk përmban vdekjen fetale.

Vdekshmëria shpreh vdekjet si një komponent i ndryshimit të popullsisë.

Niveli i vdekshmërisë sipas shkaqeve: Tregon numrin e vdekjeve që atribuohen një shkaku specifik për 100.000 banorë në një vit të dhënë.

Koeficienti bruto i vdekshmërisë: Tregon numrin e vdekjeve për 100 mijë banorë për një vit të dhënë.

Sëmundshmëria: është numri i rasteve të sëmundjeve në një popullsi të përcaktuar. Ajo matet me prevalencën ose incidencën e sëmundjeve. Përhapja e një sëmundje mund të ketë ndikime serioze mbi aspektet e tjera të popullsisë.

Niveli i prevalencës: është numri i personave që kanë një sëmundje të veçantë në një pikë të dhënë në kohë për 1.000 banorë në rrezik. Ky tregues përfshin të gjithë rastet e periudhës së specifikuar. Koeficienti i prevalencës është një "fotografi" e çastit e një situatë shëndetësore ekzistuese: ai përshkruan gjendjen shëndetësore të një popullsie.

Spitali: është një rezidence institucionale i pajisur për të ofruar kujdes mjekësor dhe hoteleri 24-orësh, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve dhe të dëmtuarve që mund të kenë nevojë si për ndihmë mjekësorë dhe kirurgjikale: i pajisur me staf të përgatitur profesionalisht dhe me të paktën një mjek. Spitali mundet jo në mënyrë të detyrueshme të siguroj gjithashtu shërbim dhe pacientëve të jashtëm.

Shtrimet në spital: janë numri gjithsej i pacientëve të shtruar në të gjitha spitalet gjatë një viti të dhënë kalendarak me diagnozë kryesore që bën pjesë në grupin e sëmundjeve të klasifikuara në ICD 9.

Numri i Qendrave të Kujdesit Shëndetësor Parësor: përfshin të gjitha institucionet shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët e jashtëm p.sh. qendra e konsultave nëpër spitale, poliklinikat, ambulancat, qendrat mjekësore, urgjenca e ndihmës së shpejtë etj. të cilat janë të pajisur me të paktën një person të kualifikuar nga ana mjekësore (mjekë ose infermier).

Personat me aftësi të kufizuara: përcaktohen si ata persona të cilët kanë një risk më të lartë se sa popullsia e përgjithshme për të përjetuar kufizime të posaçme në kryerjen e detyrave ose për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme bazike të jetës së përditshme. Ky grup përfshin personat të cilët kanë përjetuar kufizime të aktiviteteve bazë të funksionimit, siç janë ecja, dëgjimi, shikimi, komunikimi, kujtesa, kujdesi i përditshëm edhe në qoftë se të tilla kufizime janë përmirësuar me përdorimin e mjeteve të veçanta.



8. MBROJTJA SOCIALE


Mbrotjtja sociale përfshin të gjitha ndërhyrjet e bëra nga organet shtetërore dhe private, që kanë si qëllim lehtësimin e barrës së familjeve apo individëve për një sërë nevojash dhe funksionesh të caktuara. Kjo ndërhyrje mund të jetë në formën e pagesave në para kesh, në formën e rimbursimeve të shpenzimeve të bëra nga personat e mbrojtur ose në formën e mallrave dhe shërbimeve që u ofrohen drejtpërsëdrejti njerëzve të mbrojtur.

Statistikat e mbrojtjes sociale në këtë kapitull

pasqyrojnë të dhëna të disagreguara në nivel qarku ose bashkie lidhur me të dhënat administrative nga skemat e pensioneve, të ndihmës ekonomike dhe të pagesës së papunësisë.

Harta 1 paraqet raportin e numrit të familjeve të trajtuar me ndihmë ekonomike në çdo bashki ndaj numrit gjithsej të familjeve në ndihmë ekonomike në vend. Bashkitë Elbasan (10,6 %), Dibër (8,2 %), Kukës (7,5 %) dhe Pogradec (6,8 %), zënë peshën më të madhe në numrin e familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike.


Harta 1. Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, 2018



Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Figura 1 paraqet numrin e përfituesve të pensioneve të pleqërisë për 1.000 banorë sipas 12 qarqeve Vihet re se përgjatë viteve 2016-2018 numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë është rritur pothuajse në të gjitha qarqet e vendit. Numrin më të madh të përfituesve të pensioneve të pleqërisë e kanë qarqet Gjirokastrë, Berat, Vlorë dhe Korçë.


Fig.1 Pensione pleqërie për 1.000 banorë sipas qarqeve



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Figura 2 parapet numrin e pensioneve gjithsej të përfituara në Shqipëri sipas qarqeve për 1.000 banorë. Pensionet gjithsej përbëhen nga pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare. Pensionet e përfituara nga skemat private të pensioneve nuk janë të përfshira në këtë tregues. Duke qënë se peshën më të madhe të pensioneve e kanë ato të plerësisë, trendi në qarqe është i njëjtë me atë të pensione të pleqërisë të përfituara.

Fig 2 Pensionistë gjithsej për 1.000 banorë sipas qarqeve



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Burimi i të dhënave

Burim i të dhënave administrative të mbrojtjes sociale për skemat e pensioneve, të ndihmës ekonomike dhe të papunësisë përkatësisht janë:

Instituti i sigurimeve shoqërore

Shërbimi social shtetëror

Shërbimi kombëtar i punësimit

Përkufizime

Skema e mbrojtjes sociale është një set i veçantë i rregullave, i mbështetur nga një ose më shumë njësi institucionale që rregullojnë ofrimin e përfitimeve të mbrojtjes sociale dhe financimin e tyre.

Pensioni është një shumë fikse në të holla, që i paguhet në intervale të rregullta një personi ose personave në ngarkim të një personit që largohet nga jeta bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj.

Pension pleqërie në vitin 2018, sipas legjislacionit në fuqi kanë të drejtë të marrin:

Personat e siguruar që kanë mbushur moshën 65 vjeç për burrat dhe kanë një periudhë sigurimi prej 36 vitesh e 4 muaj dhe 60 vjeç e 8 muaj për gratë, pasi të kenë plotësuar 36 vjet e 4 muaj periudhë sigurimi. Vjetërsia për moshën e pensionit për gratë dhe për burrat si dhe periudha e sigurimit të tyre do të rriten çdo vit derisa të arrijnë moshën 67 vjeç dhe të kenë një periudhë sigurimi prej 40 vjetësh për të dy gjinitë në vitin 2056.

Nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.

Pension familjar, kanë të drejtë të marrin personat, që janë në ngarkim të personit që vdes, i cili përfitonte më përpara pension pleqërie ose pension invaliditeti.

Pension invaliditeti, merr personi që bëhet i paaftë,: a) për çdo veprimtari ekonomike; b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Ndihma ekonomike është mbështetja në para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në ligj.



9. STATISTIKAT E KRIMEVE DHE DREJTËSISË PENALE

Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale pasqyrojnë të dhëna për autorët e veprave penale, të dëmtuarit nga vepra penale kundër personit, të dhëna për personat e pandehur si edhe të dhëna për të burgosurit të disagreguara në nivel qarku. Burim informacioni për statistikën e pasqyruara në këtë kapitull janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Autorë të veprave penale

Statistikat mbi autorët e veprave penale përfshijnë të dhëna për persona të dyshuar në kryerjen e një veprave penale.

Në vitin 2018, janë evidentuar gjithsej 39.649 autorë për veprë penale, 2.832 (7,1 %) janë gra dhe 36.817

(92,9 %) janë burra. Përafërsisht e njëjta strukturë gjinore vihet re edhe në qarqe.

Sipas dy ndarjeve të mëdha moshore, 2.247 (5,7 %) autorë janë të mitur dhe 37.402 (94,3 %) janë të rritur. Qarku i Tiranës dhe Durrësit ka numrin më të lartë të të miturve autorë të veprave penale, përkatësisht 31,6 % dhe 20,6 % ndaj totalit të autorëve të mitur.

Tabela 1 paraqet numrin absolut të autorëve të evidentuar për vepër penale sipas qarqeve. Nga tabela vihet re se qarqet me numrin më të lartë të autorëve janë Tiranë, Durrës dhe Shkodër; ndërkohë qarqet me numrin më të ulët të autorëve janë Gjirokastrë, Kukës dhe Dibër.

Tab. 1 Numri i autorëve për vepër penale sipas qarqeve, gjinisë dhe moshës, 2018

Qarku	Gjinia		Mosha		Gjithsej
	Gra	Burra	Nën 18 vjeç	18 vjeç +	
Berat	70	1.243	70	1.243	1.313
Dibër	47	960	88	919	1.007
Durrës	226	3.732	462	3.496	3.958
Elbasan	136	2.455	124	2.467	2.591
Fier	172	2.161	86	2.247	2.333
Gjirokastrë	68	876	51	893	944
Korçë	131	2.198	143	2.186	2.329
Kukës	38	915	68	885	953
Lezhë	188	2.633	112	2.709	2.821
Shkodër	194	3.483	111	3.566	3.677
Tiranë	1.352	13.145	710	13.787	14.497
Vlorë	210	3.016	222	3.004	3.226
Shqipëria	2.832	36.817	2.247	37.402	39.649

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Shënim: Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autor mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

Të dëmtuar nga veprat penale

Të dëmtuarit i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti. Ky seksion paraqet të dhënat mbi personat e dëmtuar nga veprat penale kundër personit në raport me popullsinë sipas qarqeve.

Në vitin 2018, janë evidentuar gjithsej 19.101 persona të dëmtuar, 4.997 (26,2 %) janë gra dhe 14.104 (73,8 %) janë burra. Të dëmtuarit nga vepra penale kundër personit përbëjnë 36,7 % të totalit të persona të dëmtuar.

Persona të dëmtuar nga vepra penale kundër personit, në 2018 janë 7.007 të dëmtuar, 2.318 (33,1%) janë gra dhe 4.689 (66,9 %) janë burra. Në raport me

popullsinë, në 2018 janë evidentuar 24,4 persona të dëmtuar; 16,2 gra dhe 32,7 burra të dëmtuar për 10 mijë banorë.


Të dëmtuar nga vepra penale kundër personit janë personat të cilëve iu janë prekur ose rrezikuar të drejta që vënë në rrezik jetën, shëndetin, liritë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Nga totali i personave të dëmtuar, të dëmtuarit nga këto vepra përbëjnë 36,7 %. Qarku i Dibrës dhe Kukësit kanë përqindjen më të lartë të personave të dëmtuar për vepra penale kundër personit ndaj totalit të personave të dëmtuar. Qarku i Shkodrës dhe Durrësit kanë përqindjen më të ulët.

Tab. 2 Të dëmtuar nga vepra penale kundër personit në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë sipas qarqeve dhe gjinisë, 2018

	Gra		Burra		Nr.	Gjithsej
	Nr.	Normë 10 mijë banorë	Nr.	Normë 10 mijë banorë		Normë 10 mijë banorë
Berat	62	9,9	158	24,9	220	17,4
Dibër	76	13,2	197	31,5	273	22,8
Durrës	172	12,0	398	27,1	570	19,7
Elbasan	152	11,0	389	28,0	541	19,5
Fier	164	11,2	261	17,3	425	14,3
Gjirokastrë	78	24,7	157	51,3	235	37,8
Korçë	146	13,9	306	29,4	452	21,6
Kukës	34	9,1	155	39,2	189	24,5
Lezhë	108	17,1	313	49,7	421	33,4
Shkodër	114	11,0	179	17,9	293	14,4
Tiranë	1.017	22,6	1.661	37,8	2.678	30,1
Vlorë	195	20,7	515	54,2	710	37,5
Shqipëria	2.318	16,2	4.689	32,7	7.007	24,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Fig. 1 Përqindja e të dëmtuarve nga vepra penale kundër jetës dhe vepra të tjera penale sipas qarqeve, 2018



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të regjistruar gjatë vitit referues sipas gjinisë dhe qarqeve. I pandehur konsiderohet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një veprë penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar.

Në 2018, janë regjistruar gjithsej 16.249 persona të pandehur, 960 (5,9 %) janë gra dhe 15.289 (94,1 %)

janë burra. Në raport me popullsinë 14 vjeç+, janë regjistruar 67,6 të pandehur për 10 mijë banorë, 7,9 gra dhe 127,7 burra për 10 mijë banorë.


Norma e të pandehurve sipas qarqeve mundëson një informacion më të qartë se cila është pesha që zënë personat e pandehur (14 vjeç +) në totalin e popullsisë së çdo qarku (14 vjeç +), shprehur për 10 mijë banorë, në vitin 2018. Qarku i Tiranës, Durrësit dhe Gjirokastrës ka normën më të lartë të këtij treguesi. Qarku i Shkodrës, Berat dhe Fier shënojnë normën më të ulët, respektivisht me 39,8 dhe 42,9 për 10 mijë banorë.

Tab. 3 Të pandehur në vlerë absolute dhe në raport me popullsinë sipas qarqeve dhe gjinisë, 2018

	Gra		Burra		Gjithsej	
	Nr	Normë 10 mijë banorë	Nr	Normë 10 mijë banorë	Nr	Normë 10 mijë banorë
Berat	18	3,4	438	82,2	456	42,9
Dibër	10	2,2	575	113,6	585	60,3
Durrës	132	11,0	2.054	167,0	2.186	89,9
Elbasan	94	8,2	1.421	123,3	1.515	65,8
Fier	84	6,9	983	77,9	1067	42,9
Gjirokastrë	17	6,3	531	204,8	548	103,2
Korçë	22	2,5	1.024	117,7	1.046	59,6
Kukës	27	8,9	330	104,3	357	57,7
Lezhë	20	3,8	560	106,9	580	55,1
Shkodër	32	3,6	651	78,0	683	39,8
Tiranë	449	11,7	5.765	157,0	6.214	82,8
Vlorë	55	6,8	957	118,3	1.012	62,6
Shqipëria	960	7,9	15.289	127,7	16.249	67,6

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Fig. 2 Norma e të pandehurve sipas qarqeve, 2018



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Të burgosurit

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në 31 dhjetor të çdo viti.

Në vitin 2018, në total janë 5.316 të burgosur, 3.096 janë persona të dënuar me burg dhe 2.220 janë të paraburgosur, persona të cilët kanë marrë vendim arrest me burg. Në vitin 2018, qarku i Tiranës dhe Fierit ka numrin më të lartë të të burgosurve, përkatësisht 22,6 % dhe 13,2 % e të burgosurve gjithsej. Qarku i Kukësit dhe Gjirokastrës ka numrin më të ulët të të

burgosurve, respektivisht 2,6 % dhe 3,2 % në totalin e të burgosurve.

Treguesi i të paraburgosurve shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në paraburgim që ende nuk janë dënuar, si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të personave të burgosur.

Qarqet me përqindjen më të lartë të të paraburgosurve ndaj numrit gjithsej të të burgosurve janë Tirana, Gjirokastra dhe Berati, respektivisht me 49,2 %, 46,8 % dhe 46,5 % të paraburgosur. Ndërkohë ndër qarqet me përqindjen më të ulët renditen Fieri me 30,3 % të paraburgosur, Korçë me 34,6 % dhe Kukës me 35,3 % të paraburgosur.

Tabela 4: Të dënuar me burg dhe të paraburgosur sipas qarqeve, 2018

Qarku	2018			
	Të dënuar	Të paraburgosur	Të burgosur gjithsej	Norma e të paraburgosurve
Berat	137	119	256	46,5%
Dibër	112	74	186	39,8%
Durrës	389	212	601	35,3%
Elbasan	235	148	383	38,6%
Fier	491	213	704	30,3%
Gjirokastrë	91	80	171	46,8%
Korçë	265	140	405	34,6%
Kukës	90	49	139	35,3%
Lezhë	178	152	330	46,1%
Shkodër	263	203	466	43,6%
Tiranë	610	591	1.201	49,2%
Vlorë	206	178	384	46,4%
Të huaj	29	61	90	67,8%
Shqipëria	3.096	2.220	5.316	41,8%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Shënim: Qarku i referohet vendbanimit të të burgosurve

Burimi i të dhënave

Burim të dhënash për statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale janë të dhënat administrative. Të dhënat mbi autorët e veprave penale, personat e dëmtuar janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Të dhënat mbi numrin e të pandehurve janë siguruar nga Prokuroria e Përgjithshme. Të dhënat mbi numrin e të dënuarve me burg, të paraburgosur janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Përkufizime

Vepra penale: Sjelle, veprime apo mosveprime me të cilat cënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundravajtje penale.

Vepra penale kundër personit: Kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) të kundërligjshme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të cilat prekin ose vënë në rrezik jetën, shëndetin, liritë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Përfshihen nenet 76-133 të Kodit Penal.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejojnë ndodhjen ose jo të një veprë penale, pra shkaktojnë pasojën e veprës penale. Bëhet fjalë për persona të dyshuar në kryerjen e një veprë penale.

I dëmtuar: personi të cilit çfarëdo e drejtë personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar si pasojë e një veprë penale.

I pandehuri: konsiderohet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur.

Norma e të pandehurve paraqet numrin e personave të akuzuar të moshës 14+ shprehur për 10 mijë banorë të moshës 14+.

Numri i të burgosurve: Numri gjithsej i të burgosurve tregon numrin e personave të mbajtur në ambjentet e burgjeve, institucione të tjera, institucionet e burgosjes së të miturve, spitalet psikiatrike ose spitale të tjera. Përfshijnë si të dënuarit me burg dhe të paraburgosurit.

I dënuar me burg: Çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

I paraburgosur: Përfshihen personat, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

Të paraburgosur në privim lirie: shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në paraburgim që ende nuk janë dënuar, si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të të burgosurve.



10. REGJISTRI STATISTIKOR I NDËRMARRJEVE

Ky kapitull jep një informacion mbi regjistrin statistikor të ndërmarrje (RSN); të dhënat përshkruajnë ecurinë e ndërmarrjeve ndër vite, karakteristikat kryesore të tyre, dhe degët e ekonomisë ku ato operojnë. Regjistri statistikor i ndërmarrjeve është shtylla kryesore e prodhimit të statistikave ekonomike.

INSTAT-i ka krijuar regjistrin administrativ të ndërmarrjeve në vitin 1994 dhe që prej vitit 1998 mirëmban Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Në vitin 2010 e në vijim INSTAT mirëmban edhe Regjistrin e Njësive Lokale.

Regjistri statistikor i ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore jo bujqësore (ndërmarrjet e institucionet) që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Shqipërisë. Regjistri është ndërtuar në përputhje me Rregulloren e Këshillit EU (EEC) Nr 177/2008 datë 20 Shkurt 2008 mbi "Ndërtimin e regjistrave të ndërmarrjeve për qëllime statistikore".

Regjistri statistikor i ndërmarrjeve identifikon qartësisht njësitë, në mënyrë që:

Të lejojë marrjen e informacionit për to nëpërmjet burimeve administrative;

- Të lejojë përgatitjen e kampionëve, koordinimin e anketave dhe për grupimin e rezultateve të tyre;
- Të lejojë analizën demografike të popullsisë së ndërmarrjeve dhe njësive lidhur me to.

Regjistri statistikor të ndërmarrjeve prej vitit 2015 përmban edhe fermerë të pajisur me numër identifikimi të personit të tatueshëm, NIPT. Kjo ka ardhur si rezultat i regjistrimit të fermerëve pranë

Drejtorive Rajonale Tatimore, në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 19 datë 3.11.2014 "Për Zbatimin e Regjimit të veçantë të Skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për Qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar".

162.835 është numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vit 2018, numër pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar; 40.953 janë fermerë të pajisura me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT në fund të vitit 2018, nga 36.520 fermerë të regjistruar deri në fund të vitit 2017. Fermerët e regjistruar në bashkinë Lushnjë zënë 11,0 % të fermerëve të pajisur me NIPT;

20.279 ndërmarrje aktive janë regjistruar gjatë vitit 2018, duke shënuar një rënie me 18,6 % krahasuar me regjistrimet e vitit 2017;

Në qarqet Tiranë, Fier e Korçë janë përqendruar rreth 49,5 % e ndërmarrjeve aktive. Numri më i madh i ndërmarrjeve shënohet në qarkun e Tiranës me 53.767 ndërmarrje, ndërsa numri më i vogël në qarkun e Kukësit me 1.974 ndërmarrje. Edhe gjatë vitit 2017 qarku i Tiranës ka shënuar numrin më të lartë të ndërmarrjeve aktive, sikurse edhe qarku i Kukësit numrin më të ulët.

Në bashkinë Tiranë janë përqendruar pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, ndërsa në bashkinë Fushë-Arrëz shënohet numri më i ulët.

Në faqen e web të INSTAT gjendet databaza statistikore e regjistrat statistikor të ndërmarrjeve për vitet 2010-20181

1. <http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/?rxid=c6a7d343-3f1b-40b6-8ea6-22e011143004>

Tab.1 Ndërmarrjet aktive sipas ndarjes territoriale Qark/Bashki dhe formës ligjore

Fundi i vitit 2018

Qarku/Bashkia	Gjithsej	Fermerë	Persona Fizikë	Persona Juridik
		% ndaj totalit në nivel qarku		
Gjithsej Qarku/Bashkia	162,835	40,953	93,048	28,834
Berat	9,035	100	100	100
Berat	3,686	28.9	53.9	53.1
Ura Vajgurore	2,746	45.1	14.0	16.3
Kuçovë	1,502	12.4	22.5	14.2
Skrapar	623	7.4	5.4	11.5
Polican	478	6.2	4.2	4.9
Dibër	2,916	100	100	100
Dibër	1,290	57.9	43.6	32.5
Bulqizë	661	12.8	22.7	32.4
Mat	775	22.7	27.2	28.6
Klos	190	6.6	6.5	6.5
Durrës	12,921	100	100	100
Durrës	10,015	59.4	78.0	79.5
Shijak	1,067	18.7	7.3	9.2
Krujë	1,839	21.9	14.7	11.3
Elbasan	13,419	100	100	100
Elbasan	5,804	20.4	56.5	60.2
Cërrik	1,591	19.0	7.7	6.6
Belsh	2,701	36.0	11.0	8.1
Peqin	1,265	15.1	5.9	6.3
Gramsh	685	4.4	5.6	5.2
Librazhd	873	3.2	8.4	9.1
Prenjas	500	1.9	4.9	4.6
Fier	21,631	100	100	100
Fier	7,556	21.5	48.4	53.5
Patos	925	3.1	5.4	5.9
Roskovec	1,539	9.4	5.0	3.2
Lushnjë	7,436	40.4	28.3	26.1
Divjakë	3,310	23.1	7.3	5.5
Mallakastër	865	2.4	5.6	5.9
Gjirokastrë	4,771	100	100	100
Gjirokastrë	2,052	32.1	52.3	46.6
Libohovë	163	5.5	2.0	1.8
Tepelenë	749	20.1	11.6	15.4
Memaliaj	323	8.5	6.1	3.7
Përmet	774	17.8	15.3	14.1
Këlcyrë	393	11.5	6.7	2.9
Dropull	317	4.6	6.1	15.4
Korçë	14,035	100	100	100
Korçë	4,896	20.5	50.0	54.4
Maliq	3,336	37.1	9.6	7.3
Pustec	118	1.2	0.4	0.6
Kolonjë	695	5.3	4.3	6.0
Devoll	2,499	26.0	8.7	9.5
Pogradec	2,491	9.9	27.1	22.2
Kukës	1,974	100	100	100
Kukës	1,063	44.8	58.4	60.1
Has	340	19.2	15.8	16.8
Tropojë	571	36.0	25.8	23.1
Lezhë	5,402	100	100	100
Lezhë	3,448	77.3	61.6	57.7
Mirditë	626	10.3	11.4	14.0
Kurbini	1,328	12.4	27.0	28.3
Shkodër	11,309	100	100	100
Malësi e Madhe	2,457	47.0	7.2	9.0
Shkodër	7,269	35.6	82.3	72.4
Vau-Dejë	1,178	16.1	7.2	7.4
Pukë	298	0.9	2.5	7.9
Fushë-Arrëz	107	0.4	0.7	3.4
Tiranë	53,767	100	100	100
Tiranë	46,557	20.3	86.6	93.0
Kamëz	2,832	0.9	6.8	2.1
Vorë	973	2.1	1.6	2.3
Kavajë	2,316	38.5	3.8	2.2
Rrogozhinë	1,089	38.2	1.2	0.4
Vlorë	11,655	100	100	100
Vlorë	6,430	23.2	61.0	70.6
Selenicë	656	19.6	2.1	3.0
Himarë	782	8.7	6.7	4.1
Sarandë	2,224	5.1	24.1	15.6
Konispol	698	24.4	1.6	1.3
Finiq	427	8.5	2.4	2.8
Delvinë	438	10.4	2.0	2.6

Aktiviteti ekonomik

Ekonomia shqiptare është e fokusuar kryesisht në aktivitetin tregtar, ku tregtia me pakicë përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave vazhdon të jetë mbizotërues në grupin e ndërmarrjeve jo-bujqësore, me 21,6 % të ndërmarrjeve gjithsej, nga 23,0 % në vitin 2017.

65,0 % e ndërmarrjeve aktive janë prodhues të shërbimeve, nga 67,2 % që ishin në fund të vitit 2017 po në të njëjtin sektor. Mbizotërimi i grupit të prodhuesve të shërbimeve është dukuri në të gjitha bashkitë, sikurse edhe në të gjitha qarqet. Në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Shkodër janë përqendruar 51,4 % e grupit të prodhuesve të shërbimeve.

Fig.1 Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik, viti 2017





Fig.2 Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik, viti 2018



Tab.2 Ndërmarrjet aktive sipas NUTS 3 dhe aktivitetit ekonomik, viti 2017-2018

Qarqet	Viti 2017										
	Gjithsej	Prodhuësit e të mirave	Bujqësia, pyjet, peshkimi	Industria	Ndërtimi	Prodhuësit e shërbimeve	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Shërbime të tjera
Berat	8,763	4,937	4,296	554	87	3,826	2,069	282	779	42	654
Dibër	2,906	901	531	296	74	2,005	989	129	446	26	415
Durrës	12,963	2,484	564	1,421	499	10,479	5,022	684	1,899	173	2,701
Elbasan	13,201	5,583	4,438	950	195	7,618	3,496	582	1,881	121	1,538
Fier	20,818	11,433	10,057	1,053	323	9,385	5,116	545	1,927	117	1,680
Gjirokastrë	4,847	2,343	1,948	304	91	2,504	1,162	170	582	38	552
Korçë	13,814	7,790	6,857	743	190	6,024	3,024	476	1,280	92	1,152
Kukës	1,946	799	629	127	43	1,147	481	78	269	17	302
Lezhë	5,354	1,485	936	371	178	3,869	1,881	236	920	43	789
Shkodër	11,603	4,714	3,884	643	187	6,889	3,197	315	1,710	156	1,511
Tiranë	54,291	7,375	1,388	3,799	2,188	46,916	18,630	1,910	7,799	1,988	16,589
Vlorë	11,946	3,406	2,156	805	445	8,540	3,806	521	2,417	114	1,682
Shqipëria	162,452	53,250	37,684	11,066	4,500	109,202	48,873	5,928	21,909	2,927	29,565

Qarqet	Viti 2018										
	Gjithsej	Prodhuësit e të mirave	Bujqësia, pyjet, peshkimi	Industria	Ndërtimi	Prodhuësit e shërbimeve	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Shërbime të tjera
Berat	9,035	5,340	4,756	503	81	3,695	1,950	268	772	37	668
Dibër	2,916	1,015	637	303	75	1,901	938	121	397	23	422
Durrës	12,921	2,580	754	1,318	508	10,341	5,002	660	1,783	168	2,728
Elbasan	13,419	6,247	5,149	891	207	7,172	3,310	524	1,702	116	1,520
Fier	21,631	12,591	11,309	964	318	9,040	4,886	510	1,806	106	1,732
Gjirokastrë	4,771	2,431	2,059	289	83	2,340	1,061	167	522	38	552
Korçë	14,035	8,243	7,387	676	180	5,792	2,881	455	1,208	86	1,162
Kukës	1,974	891	724	122	45	1,083	444	76	242	20	301
Lezhë	5,402	1,596	1,059	339	198	3,806	1,823	225	865	45	848
Shkodër	11,309	4,930	4,145	590	195	6,379	2,985	289	1,535	127	1,443
Tiranë	53,767	7,411	1,663	3,495	2,253	46,356	17,944	1,956	7,115	2,098	17,243
Vlorë	11,655	3,641	2,457	725	459	8,014	3,419	514	2,238	110	1,733
Shqipëria	162,835	56,916	42,099	10,215	4,602	105,919	46,643	5,765	20,185	2,974	30,352

Tab.3 Ndërmarrjet aktive sipas NUTS 3 dhe formës ligjore, viti 2017-2018

Gjendje në fund të vitit

Qarqet	Viti 2017				Viti 2018			
	Gjithsej	Fermerë	Persona Fizikë	Persona Juridikë	Gjithsej	Fermerë	Persona Fizikë	Persona Juridikë
Berat	8,763	4,249	3,863	651	9,035	4,712	3,673	650
Dibër	2,906	499	1,878	529	2,916	577	1,755	584
Durrës	12,963	392	9,536	3,035	12,921	588	9,286	3,047
Elbasan	13,201	4,343	7,594	1,264	13,419	5,058	7,069	1,292
Fier	20,818	9,905	9,332	1,581	21,631	11,160	8,865	1,606
Gjirokastrë	4,847	1,903	2,327	617	4,771	2,018	2,131	622
Korçë	13,814	6,771	6,018	1,025	14,035	7,330	5,652	1,053
Kukës	1,946	615	953	378	1,974	708	868	398
Lezhë	5,354	842	3,708	804	5,402	971	3,589	842
Shkodër	11,603	3,802	6,403	1,398	11,309	4,062	5,799	1,448
Tiranë	54,291	1,245	38,403	14,643	53,767	1,509	36,782	15,476
Vlorë	11,946	1,954	8,249	1,743	11,655	2,260	7,579	1,816
Shqipëria	162,452	36,520	98,264	27,668	162,835	40,953	93,048	28,834


Forma ligjore

Bizneset në Shqipëri janë organizuar kryesisht si Persona Fizikë , ku gjatë vitit 2018 numërohen 76,3 % të totalit të ndërmarrjeve aktive (përjashtuar fermerë) krahasuar me 78,0% në fund të vitit 2017. Megjithatë personat juridikë japin kontributin kryesor në ekonominë e vendit. Bashkia e Tiranës shënon numrin më të madh të ndërmarrjeve aktive, sikurse dhe numrin më të madh të personave juridikë, me 50,0 %, në fund të vitit 2018.

Ndërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit

Gratë menaxhojnë / zotërojnë 25,7 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej krahasuar me 29,7 % gjatë vitit 2017. Bashkia e Tiranës ka edhe përqendrimin më të madh të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë gjatë vitit 2018, me 36,6 %. Bashkia Maliq shënon numrin më të ulët të grave drejtuese gjatë vitit 2018, me 13.3 %

Fig. 3 Ndërmarrje aktive sipas gjinisë së pronarit / administratorit



Tab. 4 Ndërmarrje aktive sipas gjinisë së pronarit / administratorit

Gjendje në fund të vitit

Qarqet	Viti 2017			Viti 2018		
	Gjithsej	Pronare / Administratore		Gjithsej	Pronare / Administratore	
		Burra	Gra		Burra	Gra
Berat	8,763	6,771	1,992	9,035	7,404	1,631
Dibër	2,906	2,115	791	2,916	2,253	663
Durrës	12,963	8,747	4,216	12,921	9,231	3,690
Elbasan	13,201	9,378	3,823	13,419	10,233	3,186
Fier	20,818	16,051	4,767	21,631	17,625	4,006
Gjirokastrë	4,847	3,553	1,294	4,771	3,682	1,089
Korçë	13,814	10,804	3,010	14,035	11,476	2,559
Kukës	1,946	1,480	466	1,974	1,599	375
Lezhë	5,354	3,657	1,697	5,402	3,840	1,562
Shkodër	11,603	8,518	3,085	11,309	8,728	2,581
Tiranë	54,291	34,985	19,306	53,767	36,468	17,299
Vlorë	11,946	8,200	3,746	11,655	8,471	3,184
Shqipëria	162,452	114,259	48,193	162,835	121,010	41,825

Madhësia e ndërmarrjeve

Rreth 90,1 % e ndërmarrjeve aktive janë ndërmarrje të vogla me 1- 4 të punësuar. Ndërmarrjet e mëdha me 50 e më shumë të punësuar zënë vetëm 1,2 % por kontributi i tyre në punësim llogaritet në 48,1 % në vitin 2018 nga 47,8 % në vitin 2017.

Tab. 5 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe dhe madhësisë, viti 2017-2018

Gjendje në fund të vitit

Qarqet	Viti 2017					Viti 2018				
	Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve				Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
		1-4	5-9	10-49	50+		1-4	5-9	10-49	50+
Berat	8,763	8,367	175	170	51	9,035	8,609	210	166	50
Dibër	2,906	2,596	106	165	39	2,916	2,572	126	174	44
Durrës	12,963	11,165	925	655	218	12,921	11,013	944	728	236
Elbasan	13,201	12,397	395	336	73	13,419	12,545	440	351	83
Fier	20,818	19,898	433	374	113	21,631	20,606	474	430	121
Gjirokastrë	4,847	4,478	156	167	46	4,771	4,383	163	174	51
Korçë	13,814	13,108	327	313	66	14,035	13,261	369	323	82
Kukës	1,946	1,752	77	93	24	1,974	1,766	76	104	28
Lezhë	5,354	4,821	272	215	46	5,402	4,842	288	226	46
Shkodër	11,603	10,799	358	361	85	11,309	10,472	365	374	98
Tiranë	54,291	46,066	4,188	3,055	982	53,767	44,868	4,520	3,338	1,041
Vlorë	11,946	10,857	611	393	85	11,655	10,612	543	413	87
Shqipëria	162,452	146,304	8,023	6,297	1,828	162,835	145,549	8,518	6,801	1,967

Pronësia

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 3,8 % të ndërmarrjeve aktive krahasuar me 3,9 % të ndërmarrjeve aktive në vitin 2017 dhe

punësojnë 9,6% të të punësuarve gjithsej. Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta janë përqendruar kryesisht në bashkitë Tiranë dhe Durrës, me 77,1 %.

Tab. 6 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe pronësisë, viti 2017-2018

Gjendje në fund të vitit

Qarqet	Viti 2017			Viti 2018		
	Gjithsej	Të huaja e Shqiptare të përbashkëta		Gjithsej	Shqiptare	Të huaja e të përbashkëta
Berat	8,763	8,721	42	9,035	8,998	37
Dibër	2,906	2,895	11	2,916	2,909	7
Durrës	12,963	12,198	765	12,921	12,188	733
Elbasan	13,201	13,060	141	13,419	13,277	142
Fier	20,818	20,659	159	21,631	21,475	156
Gjirokastrë	4,847	4,782	65	4,771	4,707	64
Korçë	13,814	13,672	142	14,035	13,908	127
Kukës	1,946	1,913	33	1,974	1,938	36
Lezhë	5,354	5,215	139	5,402	5,282	120
Shkodër	11,603	11,421	182	11,309	11,135	174
Tiranë	54,291	49,959	4,332	53,767	49,386	4,381
Vlorë	11,946	11,662	284	11,655	11,373	282
Shqipëria	162,452	156,157	6,295	162,835	156,576	6,259

Burimi i të dhënave

Regjistrat e njësive ekonomike bazohen në burime administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe duke filluar nga viti 2007 nga Qendra Kombëtare e Biznesit, një reformë e rëndësishme kjo për thjeshtësimin e regjistrimit dhe procedurën e regjistrimit të ndërmarrjeve.

Burime administrative:

- Qendra Kombëtare Biznesit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Skedari i TVSH-së;
- Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve.

Burime statistikore(vrojtimet pranë ndërmarrjeve):

- Anketa e Regjistratit të Ndërmarrjeve;
- Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve;
- Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve;
- Anketa e Çmimeve të Prodhimit;
- Anketa të tjera.

Përkufizime

Njësia ligjore

Njësia ligjore nuk është direkt njësi statistikore.

Njësia ligjore mund të jetë:

- Person juridik, ekzistenca e të cilit njihet nga ligji. pavarësisht nga individët apo institucionet që mund ta zotërojnë apo janë anëtarë në të;
- Person fizik i angazhuar në një aktivitet ekonomik në të drejtën e tij.

Ndërmarrja

Ndërmarrja është: "kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)".

Marrëdhënia mes një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: "ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësish ligjore".

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara në subjekte të ndryshme. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 320, datë 28.5.2014.



11. STRUKTURA E SHITJEVE NETO SIPAS RAJONEVE, 2017

Statistikat strukturore të ndërmarrjeve sipas rajoneve kanë si qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën sipas rajoneve dhe aktiviteteve ekonomike. Të dhënat rajonale janë vlerësuar bazuar në një model i cili ndërthur të dhënat e Regjistrit të Njësive Lokale së bashku me të dhënat për Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve, për shpërndarjen e tyre sipas rajoneve. Modeli i ndërtuar bazohet në produktivitetin e punonjësve të njësive lokale sipas aktivitetit ekonomik. Për këtë arsye, treguesit rajonalë janë vlerësuar vetëm për variablat e lidhur me numrin e të punësuarve. Në vitin 2017 shitjet neto në vend u rriten me 8,3 %. Kontributin më të madh në rritjen e shitjeve neto për vitin 2017 e ka dhënë Qarku Tiranë me + 5,9 p.p.,

pasuar nga Qarku Durrës me + 1,8 p.p. Qarku Korçë ka kontributin negativ më të lartë në treguesin e shitjeve neto me -0,4 p.p..

Në tabelën 1, paraqitet struktura e e shitjeve neto sipas rajoneve statistikore dhe aktiviteteve ekonomike për vitin 2017. Nga rezultatet, vërehet se Qarku i Tiranës ka përqindjen më të lartë të shitjeve neto, pothuajse në të gjitha aktivitetet ekonomike ndërsa Qarku Kukës ka përqindjen më të ulët të shitjeve neto në pjesën më të madhe të aktiviteteve ekonomike.


Në aktivitetin e industrisë nxjerrëse, Qarku Fier ka peshën më të madhe të shitjeve neto me 48,6 %, pasuar nga qarku Dibër me 17,9 %.

Fig.1 Kontributi në përqindje i shitjeve neto sipas qarqeve, 2017

Niveli Statistikor 1/3	Aktivitete Ekonomike								
	Gjithsej	Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	En, elek., gaz, uji & trajtimi i mbetjeve	Ndërtimi	Tregtia	Akomodimi & shërbimi ushqimor	Transp., inform. & komunikacioni	Shërbimet
Berat	1,9	1,5	3,2	2,4	2,4	1,7	2,4	0,8	0,9
Dibër	1,9	17,9	3,2	5,6	0,9	0,8	1,0	0,7	0,6
Durrës	12,6	3,8	17,8	4,7	4,9	15,8	12,5	12,3	8,6
Elbasan	5,2	2,7	17,6	11,1	4,0	3,3	5,0	1,7	1,8
Fier	7,4	48,6	5,6	7,0	7,2	6,9	5,7	2,5	3,9
Gjirokastrë	3,0	0,1	3,7	2,7	2,4	4,2	1,5	1,1	0,8
Korçë	2,8	0,7	3,2	3,7	2,1	3,3	4,9	1,6	1,3
Kukës	0,9	1,7	0,2	4,7	1,7	0,6	1,1	0,3	0,4
Lezhë	2,2	7,7	1,9	2,5	2,2	2,3	4,0	1,1	0,6
Shkodër	2,9	0,9	3,6	5,2	2,7	3,0	5,4	1,5	2,3
Tiranë	54,9	13,0	36,3	43,7	64,1	54,1	45,3	73,8	75,3
Vlorë	4,2	1,5	3,6	6,7	5,4	4,0	11,1	2,6	3,3
Shqipëria	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, INSTAT

Tab.1 Struktura e shitjeve neto sipas rajoneve dhe aktiviteteve ekonomike (%), 2017



Burimi: Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, INSTAT

Burimi i të dhënave

Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve, INSTAT

Përkufizime

Shitjet neto përfshijnë shumën e faturuar nga ndërmarrja gjatë periudhës referuese dhe i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë ligjore me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Metodologjia

Statistikat strukturore të ndërmarrjeve sipas rajoneve të cilat kanë si qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën sipas rajoneve dhe aktiviteteve ekonomike.

Të dhënat rajonale janë vlerësuar bazuar në një model në të cilin përdoret struktura e variablave ndërmjet aktiviteteve të ndryshme, për të përcaktuar nivelin në të cilin çdo variabël duhet të kontribuojë në njësinë lokale, në varësi të aktivitetit të kësaj njësie. Për të realizuar këtë model përdoret Regjistri i Njësive Lokale, së bashku me të dhënat për ndërmarrjet, që merren nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve. Informacioni i përdorur nga njësitë lokale janë aktiviteti dhe numri i punonjësve në këto njësi.

Supozimi kryesor është se variablat e statistikave strukturore janë të korreluara me punësimin, por mund të ketë diferenca mes aktiviteteve të ndryshme. Disa aktivitete kanë diferenca të ndryshme ndërmjet punësimit dhe variablave të tjerë, si për shembull nëse përdorin më shumë kapital, pra janë kapital-intensiv dhe përdorin më pak forcën punëtore. Çdo raport variabël / punësim, në këtë rast, do të ishte më i lartë.

Informacioni më i detajuar rreth Statistikave Strukturore dhe Regjistrit të Njësive Lokale mund t'i gjeni në link-et më poshtë:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sherbimet/statistikat-strukturore-te-ndermarrjeve-ekonomike/#tab4>

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sherbimet/regjistri-statistikor-i-ndermarrjeve/#tab4>



12. BUJQËSIA

Sektori i bujqësisë është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Produktet bujqësore janë pjesë e formimit të identitetit rajonal të vendit, me një gamë të gjërë të ndryshimeve mjedisore, natyrore dhe klimatike.

Baza ligjore për grumbullimin e statistikave të bimëve është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021. Prodhimi bimor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit. Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, prodhim i korrur dhe rendiment.

Burimet e informacionit për llogaritjen e treguesve statistikor të prodhimit bimor bazohen mbi të dhënat e mbledhura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nga vrojtimit të dhënat administrative dhe vlerësimet e ekspertëve.

Drithrat kryesore të kultivuara në vendin tonë janë gruri, misri, elbi, thekra dhe tagjirat. Një peshë të konsiderueshme në prodhimin e bimëve të arave zënë gjithashtu dhe perimet, patatet dhe fasulet.

Grupet kryesore të drithrave të kultivuara në vendin tonë janë gruri, misri, elbi thekra dhe tërshëra. Perimet, rrënjoret dhe bishtajoret zënë një pjesë të konsiderueshme të prodhimit bimor.

Tab. 1 Sipërfaqja e mbjellë me bimë arrash sipas qarqeve, 2016-2018

000 ha			
Qarqet	2016	2017	2018
Berat	27.5	26.8	26.4
Dibër	30.1	36.8	29.9
Durrës	29.1	29.9	31.1
Elbasan	51.2	51.2	49.9
Fier	91.2	90.7	90.7
Gjirokastrë	19.0	18.3	19.4
Korçë	48.1	48.6	47.0
Kukës	13.0	12.1	12.0
Lezhë	24.0	24.7	24.6
Shkodër	34.1	33.5	37.4
Tiranë	36.0	36.3	36.3
Vlorë	15.0	15.3	15.6
Shqipëria	418.3	424.2	420.3

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 2 Sipërfaqja e mbjellë me drithra sipas qarqeve, 2016-2018


000 ha														
Vitet	Drithrat	Shqipëria	Qarqet											
			Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokaštër	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
2016	Gjithsej drithra	148.0	9.5	9.6	7.5	22.1	33.3	5.4	24.1	5.2	7.4	8.3	8.7	6.9
	Grurë	70.5	4.3	3.0	2.7	11.9	18.1	2.5	15.7	1.0	3.2	2.0	4.0	2.1
	Misër	58.5	3.1	5.8	4.0	7.5	10.7	1.0	4.8	3.4	4.2	6.3	3.8	3.9
	Tagjira	14.7	2.1	0.6	0.8	2.6	4.1	1.9	0.5	0.3	0.0	0.0	0.9	0.9
	Theker	1.2	0.0	0.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.4	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
	Elb	3.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.0	2.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
2017	Gjithsej drithra	145.8	9.3	8.8	7.2	22.4	34.4	4.7	23.1	4.1	7.6	8.1	9.1	7.1
	Grurë	68.1	4.2	2.2	2.4	12.4	18.3	2.1	15.5	0.6	2.4	1.4	4.5	2.1
	Misër	58.1	3.0	6.0	3.8	7.5	10.5	0.8	4.2	2.7	5.1	6.7	3.7	4.0
	Tagjira	15.4	2.1	0.5	1.0	2.4	4.9	1.7	0.7	0.3	0.0	0.0	0.8	1.0
	Theker	1.2	0.0	0.1	0.0	0.1	0.0	0.0	0.5	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
	Elb	3.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.6	0.0	2.2	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0
2018	Gjithsej drithra	140.1	9.1	7.4	8.2	20.5	34.6	5.0	21.3	3.8	6.7	7.0	9.1	7.3
	Grurë	65.1	4.0	1.5	3.2	11.3	18.2	2.1	13.3	0.7	2.7	1.3	4.6	2.1
	Misër	54.1	2.9	5.3	4.0	6.7	10.0	1.0	4.4	2.4	3.9	5.7	3.7	4.0
	Tagjira	16.6	2.1	0.5	1.0	2.4	5.7	1.9	0.9	0.3	0.0	0.0	0.6	1.1
	Theker	1.0	0.0	0.1	0.0	0.1	0.0	0.0	0.3	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
	Elb	3.4	0.1	0.0	0.0	0.0	0.7	0.0	2.3	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 3 Sipërfaqja me bimë të tjera në tokë arë, 2016-2018

000 ha														
Vitet	Të tjera bimë arash	Shqipëria	Qarqet											
			Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrër	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
2016	Patate	9.7	0.4	0.8	0.5	1.3	1.0	0.4	2.0	0.6	0.5	1.1	0.8	0.3
	Fasule	13.7	0.6	0.4	1.2	1.9	3.4	0.2	2.0	0.2	0.8	0.8	1.7	0.5
	Perime	31.2	1.8	1.6	2.6	2.5	6.4	0.9	2.9	0.6	1.7	3.7	5.0	1.5
	Fara vajore	1.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.7	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
	Duhan	1.1	0.0	0.0	0.0	0.6	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.4	0.0	0.0
	Foragjere	208.6	14.6	17.9	17.2	22.6	46.3	12.0	16.8	6.2	13.5	15.9	19.6	6.0
2017	Patate	9.9	0.4	0.8	0.5	1.3	1.0	0.3	2.2	0.6	0.6	1.1	0.8	0.3
	Fasule	13.0	0.5	0.4	1.2	1.7	2.7	0.3	2.2	0.2	0.9	0.8	1.7	0.5
	Perime	31.9	1.9	1.6	2.8	2.4	6.4	0.9	3.0	0.6	1.8	3.9	5.1	1.6
	Luleshtrydhe	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Fara vajore	0.7	0.0	0.0	0.1	0.0	0.5	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
	Duhan	0.9	0.0	0.0	0.0	0.3	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.4	0.0	0.0
	Foragjere	215.7	14.3	25.0	18.1	22.8	45.7	12.0	17.1	6.5	13.7	14.9	19.6	5.8
	Bimë medicinale	5.4	0.3	0.0	0.0	0.4	0.0	0.1	0.2	0.1	0.0	4.1	0.0	0.0
Panxharsheqeri	0.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
2018	Patate	9.7	0.4	0.7	0.5	1.3	1.0	0.3	2.2	0.6	0.5	1.1	0.8	0.3
	Fasule	13.4	0.6	0.3	1.2	1.8	3.0	0.2	2.3	0.2	0.8	0.8	1.7	0.5
	Perime	31.7	1.9	1.7	2.8	2.4	6.3	0.9	3.0	0.6	1.9	3.4	5.0	1.6
	Luleshtrydhe	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Fara vajore	0.6	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
	Duhan	1.0	0.0	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.0	0.0
	Foragjere	217.4	14.1	19.8	18.3	23.0	45.1	12.7	17.2	6.7	14.5	20.5	19.6	5.9
	Bimë medicinale	5.6	0.3	0.0	0.0	0.3	0.1	0.2	0.3	0.0	0.0	4.2	0.1	0.0
Panxharsheqeri	1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Harta 1. Sipërfaqja e mbjellë në tokë arë, 2018

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 4 Prodhmi i drithrave sipas qarqeve, 2016-2018

000 ton

Vitet	Drithrat	Shqipëria	Qarqet											
			Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
2016	Gjithsej drithra	698.4	41.4	48.9	43.6	98.5	156.5	18.0	88.5	22.6	40.7	47.2	45.3	47.2
	Grurë	275.0	18.7	10.7	10.4	46.0	73.3	7.7	57.4	4.0	13.5	7.0	18.0	8.3
	Misër	379.7	18.7	36.7	31.4	46.4	71.5	6.9	21.4	16.8	27.2	40.2	25.4	37.1
	Tagjira	31.8	3.9	1.2	1.8	5.8	10.4	3.3	1.1	0.7	0.0	0.0	1.9	1.8
	Theker	2.7	0.0	0.2	0.0	0.3	0.0	0.0	1.1	1.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	Elb	9.0	0.1	0.1	0.0	0.0	1.3	0.0	7.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
2017	Gjithsej drithra	701.7	39.5	41.3	45.9	99.5	183.0	16.2	82.4	17.9	39.0	41.3	46.8	48.9
	Grurë	274.9	19.1	7.6	12.0	46.2	82.8	6.9	53.7	2.2	9.8	5.5	20.5	8.5
	Misër	381.1	16.0	32.2	31.9	47.8	85.3	6.4	20.0	14.0	29.1	35.8	24.4	38.4
	Tagjira	34.0	4.3	1.2	2.0	5.2	12.7	2.9	1.4	0.6	0.1	0.0	1.6	2.0
Në periudhën 2016-2018, hyrjet e shtetasve të huaj në Shqipëri kanë qenë afërsisht 15.8 milionë persona. Hyrjet e shtetasve të huaj në vitin 2018 janë rritur me 25,2 % krahasuar me vitin 2016.


Në periudhën 2016-2018, në gjithë vendin funksionuan mesatarisht 1297 struktura akomoduese. Numri i strukturave akomoduese në Shqipëri është rritur me 9,2 % në vitin 2018 krahasuar me vitin 2016. Referuar të njëjtës periudhë kohore, qarku me rritjen më të madhe është Berat me 81,8 %.

Fig. 1 Numri i Strukturave Akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afatshkurtra) sipas qarqeve, 2016 - 2018




Burimi: Regjistri statistikor i ndërmarrjeve, INSTAT

Fig. 2 Numri mesatar i dhomave të disponueshme dhe numri mester i dhomave të zëna sipas rajoneve, gjatë vitit 2018



Burimi: Anketa e Strukturave Akomoduese, INSTAT

Fig.3 Numri i vizitorëve Resident dhe Jo- Resident sipas rajoneve gjatë vitit 2018

Burimi: Anketa e Strukturave Akomoduese, INSTAT

Numri mesatar i shtretërve të disponueshëm për vizitorë gjatë vitit 2018 ka qenë më i lartë në rajonin Qendër (afërsisht 427.585 shtretër). Norma më e lartë e shfrytëzimit të shtretërve për vitin 2018 është në rajonin e Jugut (afërsisht 29.8%) ndjekur nga rajoni Veri dhe Qendër.

Turistët e huaj kanë zënë rreth 70,2 % të numrit mesatar të netë qëndrimeve gjatë vitit 2018. Kjo përqindje është më e lartë në rajonin Qendër (afërsisht 73.3%).

Rajonet statistikore në nivelin 1, 2 dhe 3 përcaktohen sipas ndarjes territoriale NUTS II, i cili është një klasifikim i unifikuar dhe përdoret si bazë për mbledhjen dhe përpunimin e Statistikave Rajonale Evropiane. Informacioni më poshtë përfshin se cilat prefektura janë në rajonin e Veriut, Qendrës dhe Jugut.

Rajoni i Veriut: Dibër; Durrës; Kukës; Lezhë; Shkodër

Rajoni Qendër: Elbasan; Tiranë

Rajoni i Jugut : Berat; Fier; Gjirokastrë; Korçë; Vlorë


STATISTIKAT E TURIZMIT

Statistikat e Turizmit në Familje sigurojnë informacion për “Pushime dhe Udhëtimet” të kryera nga të gjithë individët mbi 15 vjeç në Shqipëri. Të dhënat e turizmit në familje mbledhen dhe llogariten nga Anketa e Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime”, i cili është një vërtetim statistikor që kryhet pranë NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe mbledh informacion mbi udhëtimet të kryera brenda dhe jashtë Shqipërie me ose pa fjetje.

Në vitin 2018, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi (brenda Shqipërisë) të kryera nga individët rezidentë në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç janë përlogaritur 3.677.796. Udhëtimet e kryera për qëllime personale brenda vendit përbëjnë 98,2 % të udhëtimeve kurse udhëtimet për qëllime biznesi 1,8 % të tyre.

Destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri, për vitin 2018, janë qarqet: Tiranë (33,5%), Korçë (15,1 %), Vlorë (13,7 %) dhe Durrës (11,2%).

Fig.4 Shpërndarja e udhëtimeve brenda vendit sipas destinacioneve (në %)



Burimi: Anketa e Turizmit në Familje “Pushimet dhe Udhëtimet” 2018, INSTAT

Në tabelën 1 tregohet se për vitin 2018, përqindjet më të larta të udhëtimeve të kryera për qëllimin “Pushime dhe kohë e lirë” janë regjistruar në Vlorë (35,2%), ndërsa për kategorinë “Vizita te të afërm dhe miq” dhe për qëllime “Biznesi” numri më i lartë i udhëtimeve ka si destinacion qarkun e Tiranës.


Nëse do të analizojmë udhëtimet e kryera brenda qarqeve sipas qëllimit të tyre vërejmë se përgjithësisht prevalojnë udhëtimet të kryera për “Pushime dhe kohë të lirë” si dhe për “Vizita te të afërm dhe miq”.

Tab.1 Shpërndarja e udhëtimeve në Shqipëri sipas qëllimit dhe destinacionit (në %)

Qarku	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita te të afërm dhe miq	Biznes	Tjetër	Shqipëri
Berat	1,3	3,2	3,5	2,2	2,6
Dibër	1,2	1,6	2,5	0,5	1,4
Durrës	17,4	8,4	11,0	6,6	11,2
Elbasan	0,5	7,6	3,0	6,2	5,2
Fier	0,5	5,7	6,1	4,5	4,0
Gjirokastrë	3,7	2,8	4,8	-	3,0
Korçë	18,5	14,0	17,7	6,1	15,1
Kukës	2,5	3,4	-	1,2	2,9
Lezhë	2,5	4,5	2,1	4,1	3,8
Shkodër	4,9	3,1	4,0	1,3	3,6
Tiranë	11,7	42,0	39,8	64,1	33,5
Vlorë	35,2	3,6	5,5	3,3	13,7

Burimi: Anketa e Turizmit në Familje “Pushimet dhe Udhëtimet” 2018, INSTAT

Fig.5 Shpërndarja e udhëtimeve sipas qëllimit në qarqe (në %)



Burimi: Anketa e Turizmit në Familje “Pushimet dhe Udhëtimet” 2018, INSTAT

Burimi i të dhënave

- Vrojtimi pranë Strukturave Akomoduese, INSTAT
- Lëvizja e shtetasve, të dhëna administrative (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë)
- Regjistri statistikor i ndërmarrjeve, INSTAT
- Anketa e Turizmit në Familje "Pushimet dhe Udhëtimet" 2018, INSTAT

Përkufizime

Numri i dhomave: në një strukturë akomodimi apo banesë është njësia e përbërë nga një dhomë ose grupe dhomash të cilat janë të marra me qira nga vizitorët (turistët) si një e tërë (qira e pandashme)

Numri i shtretërve: në një godinë akomodimi turistik përcaktohet nga numri i personave të cilët mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përfshirë shtretërit ekstra të vendosur sipas kërkesës së vizitorit

Vizitorë: Një vizitor është një udhëtar që udhëton drejt një destinacioni kryesor jashtë mjedisit të tij / saj të zakonshëm, për më pak se një vit, për qëllime të ndryshme (biznes, pushime ose qëllime të tjera personale) duke përfshirë rastet e punësimit nga një entitet rezident në vendin e vizituar. Këto udhëtime të ndërmarra nga vizitorët kualifikohen si udhëtime turistike

Rezident: konsiderohet ai person që ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi

Jo-Rezident: konsiderohet ai person që ka banuar në Shqipëri për më pak se 12 muaj radhazi

Numri i netë qëndrimit: Një natë qëndrimi është çdo natë që një vizitor / turist (rezident ose jo-rezident) aktualisht shpenzon (fle apo qëndron) në një njësi akomodimi

Norma e shfrytëzimit të dhomave të fjetjes në një periudhë reference llogaritet si raport i numrit gjithsej të dhomave të zëna gjatë periudhës së referencës (d.m.th. shuma e dhomave të zëna në ditë) me numrin i përgjithshëm i dhomave të disponueshme për vizitorë (d.m.th. shuma e dhomave të disponueshme në ditë, duke zbritur mbylljet sezonale dhe mbylljet e tjera të përkohshme). Rezultati shumëzohet me 100 për të shprehur shkallën e shfrytëzimit si përqindje

Norma e shfrytëzimit të shtretërve të fjetjes në një periudhë reference llogaritet si raport i numrit gjithsej të shtretërve të zëna gjatë periudhës së referencës me numrin e përgjithshëm të shtretërve (d.m.th. përfshirë shtretërit ekstra) dhe me numrin e përgjithshëm të shtretërve të disponueshme për vizitorë (d.m.th. shuma e shtretërve të disponueshme në ditë, duke zbritur mbylljet sezonale dhe mbylljet e tjera të përkohshme). Rezultati shumëzohet me 100 për të shprehur shkallën e shfrytëzimit si përqindje

STATISTIKAT E TURIZMIT (NË FAMILJE)

Turizmi është veprimtaria e vizitorëve duke ndërrmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vend-banimit të zakonshëm ku jeton, për më pak se një vit, për çfarëdo qëllimi kryesor, duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekti rezident në vendin e vizituar.

Vizitor është klasifikuar një turist (ose vizitori për një ose më shumë netë), në qoftë se udhëtimi i tij / saj përfshin një qëndrim me fjetje.

Vizitor një ditor është një udhëtar ose turist i cili nuk qëndron gjatë natës në vendin ku ka udhëtuar.

Udhëtar do të konsiderohet individ i cili lëviz në vendeve të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje.

Udhëtimi i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.

Turizëm i brendshëm, përfshin aktivitetet e një vizitori rezident brenda vendit.

Turizëm i jashtëm, përfshin aktivitetet e një vizitori rezident jashtë vendit të referencës.

Udhëtim për qëllime biznesi ose pune: Udhëtime për qëllime biznesi janë ato udhëtime jashtë vend-banimit të zakonshëm të individit, të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj (kongrese dhe konferenca, panaire dhe ekspozita, bisedime për biznes dhe misione, udhëtime me qëllim të mbylljes biznesit ose kontrate, bashkimin ose riparimin e pajisjeve teknike, tregtare (shitjen ose blerjen), udhëtime profesionale (të ndërrmarra nga përfaqësuesit e kulturës apo religjionit, etj), trajnimin, shoqërimin e personave të tjerë, etj).

Destinacioni kryesor: në rastin e një udhëtimi jashtë vendit, individ deklaron se ku ka qëndruar. Në qoftë se udhëtari nuk është në gjendje për të vendosur, udhëtari do vendosë si destinacionin kryesor vendin ku ai ka shpenzuar kohën më të madhe të netëve të qëndrimit; në qoftë se ka shumë vende me numër të njëjtë të qëndrimeve me fjetje atëherë do vendoset destinacioni më i largët apo vendi ku i udhëtari ka shpenzuar më shumë para



15. TRANSPORTI

Statistikat rajonale të transportit kanë si qëllim të përcaktojnë flukset e udhëtarëve dhe të mallrave si brenda rajoneve ashtu edhe ndërmjet tyre. Këto lëvizje shpesh janë të lidhura ngushtë me nivelet e aktivitetit ekonomik të këtyre rajoneve. Statistikat e transportit mbështeten në të dhënat që merren nga burimet administrative dhe mbulojnë: transportin rrugor të përfaqësuar me numrin e mjeteve për pasagjerë dhe mallra, transportin detar, transportin ajror, transportin hekurudhor dhe aksidentet rrugore.


Mjetet rrugore për pasagjerë kanë një shpërndarje gjeografike në të gjithë territorin e vendit. Siç vihet re në grafikun e mëposhtëm, gjatë të dhënave tre vjeçare 2016-2018, vihet re se mjetet rrugore për pasagjerë për 1.000 banorë kanë një tendencë rritje në numrin e tyre. Qarku i Tiranës zë 38,3 % të mjeteve për pasagjerë për 1.000 banorë për vitin 2018, me 215 mjete për pasagjerë për 1.000 banorë në vitin 2018 duke mbetur e pandryshuar me vitin 2016.

Gjatë periudhës 2016-2018, qarku me rritjen mesatarisht më të lartë të numrit të mjeteve për pasagjerë llogaritur për 1.000 banorë është qarku i Kukësit me mesatarisht 10,3 % mjete për 1.000 banorë i ndjekur nga qarku i Dibrës me 10,1 % mjete për 1.000 banorë. Qarku me rritjen mesatarisht më të ulët të numrit të mjeteve për pasagjerë është qarku i Tiranës me 2,5 % mjete për 1.000 banorë. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, qarku me rënien mesatarisht më të lartë paraqitet qarku i Gjirokastrës me 2,2 % mjete më pak për 1.000 banorë.

Në kategorinë “Automjete” të mjeteve rrugore për pasagjerë, qarku i Tiranës zë 38,0 % të automjeteve për 1.000 banorë në vitin 2018, me 196 autovetura për 1.000 banorë në 2018 nga 195 në vitin 2016.

Gjatë periudhës 2016-2018, qarku me rritjen mesatarisht më të lartë të numrit të autoveturave llogaritur për 1.000 banorë është qarku i Kukësit me 10,5 %, ndërsa qarku me rritjen mesatarisht më të ulët është qarku i Tiranës me 2,3 %. Ndërkohë qarku me rënien mesatarisht më të lartë është qarku i Gjirokastrës me 2,0 %.

Fig.1 Numri i mjeteve transporti rrugor për pasagjerë sipas qarqeve për 1.000 banorë, 2016-2018



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Mjetet e transportit rrugor për mallrat ashtu si dhe mjetet e transportit rrugor për pasagjerë, gjejnë një shpërndarje në të 12 qarqet e vendit. Nga grafiku i mëposhtëm, gjatë periudhës 2016-2018, ka pasur një rënie në numrin e mjeteve të transportit rrugor për mallra për 1.000 banorë.

Qarku i Tiranës zë 32,8 % të mjeteve gjithsej për mallra për 1.000 banorë për vitin 2018 me 28,6 mjete për mallra për 1.000 banorë në vitin 2018.


Gjatë periudhës 2016-2018, qarku me rritjen mesatarisht më të lartë të numrit të mjeteve për mallra për 1.000 banorë është qarku i Beratit me mesatarisht 3,5 % mjete për 1.000 banorë i ndjekur nga qarku i Dibrës dhe i Durrësit me 3,0 % mjete për 1.000 banorë. Qarku me rritjen mesatarisht më të ulët të numrit të mjeteve për mallra për 1.000 banorë është qarku i

Tiranës me 0,4 % mjete për 1.000 banorë. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, qarku me rënie mesatarisht më të lartë paraqitet qarku i Gjirokastrës me 6,8 % mjete më pak për 1.000 banorë.

Në kategorinë “Kamiona, Traktorë dhe mjete për përdorim të veçantë”, qarku i Tiranës zë 33,0 % të kësaj kategorie mjeteve për 1.000 banorë në vitin 2018.

Gjatë periudhës 2016-2018, qarku me rritjen mesatarisht më të lartë paraqitet për kategorinë “Kamiona, Traktorë dhe mjete për përdorim të veçantë” është përsëri qarku i Beratit me 3,2 % mjete të kësaj kategorie për 1.000 banorë, i ndjekur nga qarku i Dibrës me 2,7 % mjete të kësaj kategorie për 1.000 banorë. Qarku me rritjen më të ulët të kësaj kategorie është qarku i Elbasanit me 1,0 %, ndërsa qarku me rënie mesatarisht më të lartë paraqitet qarku i Gjirokastrës me 7,1 % të kësaj kategorie mjeteve për 1.000 banorë.

Fig.2 Numri i mjeteve rrugore për mallra sipas qarqeve për 1.000 banorë, 2016-2018




Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Aksidentet rrugore


Mundësitë për ndodhjen e aksidenteve rrugore mund të lidhen me një sërë faktorësh, si numri i kilometrave të përshkruar, shtrirja dhe cilësia e infrastrukturës rrugore, kushtet klimaterike dhe gjeografike si dhe dendësia e popullsisë. Sjellja e drejtuesve të mjeteve mund të përbëjë shkak për mundësitë e ndodhjes së aksidenteve, si p.sh eksperiencia, mungesa e përqendrimit, shpejtësia tej normave të lejuara, mosrespektim i rregullave të qarkullimit si dhe konsumi i pijeve alkoolike. Numri i aksidenteve rrugore në rang vendi ka pësuar ulje në vitin 2018 krahasuar me dy vitet e tjera të marra në analizë.

Nëse do t'i referohemi numrit absolut të aksidenteve rrugore gjatë viteve 2016-2018, qarku i Tiranës shënon numrin më të lartë të aksidenteve rrugore për periudhën 2016-2018, më pas vjen qarku i Durrësit dhe Fierit, ndërsa Gjirokastra dhe Kukësi janë qarqet me numrin më të ulët të aksidenteve. Përsa i përket numrit të aksidentuarve për çdo qark, vihet re një tendencë e njëjtë sikurse tregon numri i aksidenteve. Në figurën 3, paraqetet numri i aksidenteve për 10.000 banorë. Në Shqipëri në vitin 2018 rezultojnë mesatarisht 8 të aksidentuar për 10.000 banorë. Vlera më e lartë e këtij treguesi për vitin 2018, arrin 18 të aksidentuar për 10.000 banorë në qarkun e Lezhës, ndërsa ndërsa vlera më e ulët shënohet në qarkun e Dibër dhe Berat me 4 të aksidentuar për 10.000 banorë.

Fig.3 Numri i aksidenteve sipas qarqeve për 10.000 banorë, 2016-2018



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT

Harta 1. Të aksidentuar për 10.000 banorë, 2018

Burimi të dhënave

Të dhënat statistikore mbi transportin rrugor dhe aksidentet në rrugë sipas qarqeve grumbullohen nga burime administrative për të dhëna të shprehura në njësi absolute. Insitucionet të cilat sigurojnë këto të dhëna janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Përkufizime

Transport

Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Inventari i mjeteve rrugore

Numri i mjeteve rrugore të regjistruara në datën e caktuar në një vend dhe të licencuar për të përdorur rrugët me trafik publik.

Të aksidentuar

Çdo person i vrarë ose i plagosur si rezultat i një aksidenti rrugor.

Aksidente në rrugë

Çdo aksident rrugor i ndodhur nga të paktën një mjet rrugor i cili rezulton me të paktën një person të plagosur apo të vdekur.



16. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

Në vitin 2017, sipas rajoneve statistikore niveli 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korente është 1.551,3 miliardë Lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 3,82 % krahasuar me vitin 2016.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3 (Qark), vlera më e lartë në PBB paraqitet në qarkun e Tiranës me rreth 652,1 miliardë Lekë ose 42,03 % e totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2016 PBB me çmime korente shënoi një rritje prej 8,54 %. Vlera më e ulët në PBB paraqitet në qarkun Kukës me 25,6 miliardë Lekë ose 1,65 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2016, PBB me çmime korente shënoi një rënie prej 0,29 %.

Në vitin 2017, në rritjen prej 3,82 % të PBB-së në terma reale ndaj vitit 2016, kontributi sipas qarqeve paraqitet si më poshtë: kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2017, e pati qarku Tiranë me +3,42 pikë përqindje, më pas renditet qarku Durrës


me +0,40 pikë përqindje dhe qarku Fier me +0,18 pikë përqindje. Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë qarku Vlorë me -0,19 pikë përqindje, i pasuar me qarkun Korçë me një kontribut prej -0,13 pikë përqindje dhe qarku Lezhë me një kontribut prej -0,03 pikë përqindje.

Rritja ekonomike e PBB-së

Produkti i Brendshëm Bruto në vitin 2017, shënoi një rritje ekonomike reale në krahasim me vitin 2016 me 3,82 %. Sipas qarqeve rritjen më të lartë e shënoi qarku Tiranë me një rritje në terma realë prej 8,54 %. Më tej me rritje më të lartë vijon qarku Durrës me një rritje në terma realë prej 4,09 % dhe qarku Dibër me një rritje në terma realë prej 1,92 %.

Ndër qarqet me një rënie në totalin e ekonomisë paraqitet qarku Vlorë me një rënie në terma realë prej 3,26 %. Më tej vjen qarku Korçë me një rënie në terma realë prej 2,22%. PBB reale për vitin 2017 pati variacione në nivelet e rritjes sipas qarqeve. Niveli i rritjes në disa vite të veçanta dhe në disa qarqe të veçanta varet nga kontributi individual i secilit qark në totalin e PBB-së, nga struktura e degëve të ekonomisë, etj. Në tab.2 janë paraqitur ritmet e rritjes sipas qarqeve.

Fig.1 Kontributi i qarqeve në rritjen ekonomike, në vitin 2017



Tab. 1 Treguesit kryesorë ekonomikë, viti 2017*

Qarqet	PBB çmime korente	Struktura ndaj PBB-së	Kontributi	PBB për frymë	Struktura e indeksit
	mIn Lekë	%	%	mijë Lekë	%
Shqipëria	1.551.281	100,00	3,82	540	100,00
Berat	58.523	3,77	0,06	451	83,59
Dibër	49.885	3,22	0,06	405	74,95
Durrës	153.886	9,92	0,40	536	99,24
Elbasan	106.061	6,84	0,05	377	69,87
Fier	166.933	10,76	0,18	556	102,96
Gjirokastrë	35.304	2,28	0,03	548	101,47
Korçë	85.451	5,51	-0,13	403	74,57
Kukës	25.643	1,65	-0,01	327	60,53
Lezhë	51.312	3,31	-0,03	401	74,31
Shkodër	80.364	5,18	-0,02	389	72,10
Tiranë	652.072	42,03	3,42	747	138,33
Vlorë	85.847	5,53	-0,19	454	84,12

* Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

Tab. 2 Rritja Reale e Produktit të Brendshëm Bruto

(në %)

Qarqet	2013	2014	2015	2016	2017*
Berat	0,81	3,12	2,02	5,45	1,42
Dibër	-0,01	1,20	10,01	5,67	1,92
Durrës	1,39	0,07	7,42	3,33	4,09
Elbasan	5,07	-0,48	-4,64	4,43	0,70
Fier	4,56	5,24	-5,67	-2,12	1,60
Gjirokastrë	-2,99	1,01	-6,80	1,16	1,45
Korçë	0,42	-0,44	-0,22	6,35	-2,22
Kukës	4,92	-14,51	-6,73	-2,10	-0,29
Lezhë	-5,14	9,39	0,80	7,82	-0,77
Shkodër	-3,39	-4,72	1,62	3,09	-0,46
Tiranë	0,90	3,27	6,74	3,05	8,54
Vlorë	-2,19	0,60	-1,81	9,56	-3,26
Shqipëria	1,00	1,77	2,22	3,31	3,82

* Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

PBB për frymë

Në vitin 2017 niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 (Republika e Shqipërisë) ishte rreth 540 mijë Lekë. Krahasuar me vitin 2016, PBB për frymë u rrit me 5,45 %.


Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas qarqeve, në vitin 2016, ishte qarku Tiranë me rreth 747 mijë Lekë ose 38,33 % mbi mesataren e vendit dhe pati një rritje prej 7,99 % krahasuar me vitin 2016. Më pas renditet qarku Fier me rreth 556 mijë Lekë ose 2,96 % mbi mesataren e

vendit, i cili pati një rritje prej 3,29 % krahasuar me vitin 2016. Më pas renditet qarku Gjirokastrë, me rreth 548 mijë Lekë ose 1,47 % mbi mesataren e vendit, i cili pati një rritje prej 6,45 % krahasuar me vitin 2016.

PBB për frymë për qarqet e tjera ishte nën mesataren e vendit ku më e ulta ishte ajo e qarkut Kukës me rreth 327 mijë Lekë ose 39,47 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon qarku Elbasan, me rreth 377 mijë Lekë ose 30,13 % nën mesataren e vendit.


Fig.2 PBB për frymë sipas qarqeve krahasuar me mesataren kombëtare për vitin 2017*

(në mijë Lekë)




* Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

Harta 1. PBB me çmime korrente sipas qarqeve



Harta 2. PBB për frymë sipas qarqeve



Tab. 3 Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korente

(në mln Lekë)

Qarqet	2013	2014	2015	2016	2017*
Berat	50.164	52.676	54.691	56.964	58.523
Dibër	42.600	44.031	46.850	48.940	49.885
Durrës	129.322	129.149	140.260	144.605	153.886
Elbasan	101.598	103.357	100.200	104.100	106.061
Fier	179.542	188.760	169.437	163.484	166.933
Gjirokastrë	35.219	36.269	34.309	34.469	35.304
Korçë	79.130	80.261	80.826	86.429	85.451
Kukës	30.806	27.176	26.008	25.475	25.643
Lezhë	41.642	46.666	47.513	51.183	51.312
Shkodër	74.956	73.573	77.364	79.953	80.364
Tiranë	504.196	531.419	575.735	589.670	652.072
Vlorë	80.877	81.970	81.112	87.207	85.847
Shqipëria	1.350.053	1.395.305	1.434.307	1.472.479	1.551.281

* Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

Tab. 4 Produkti i Brendshëm Bruto për frymë

(në Lekë)

Qarqet	2013	2014	2015	2016	2017*
Berat	352.063	376.955	399.488	426.089	451.265
Dibër	313.173	331.824	360.234	384.393	404.654
Durrës	470.188	466.203	502.551	511.849	535.767
Elbasan	342.119	352.992	346.549	364.351	377.195
Fier	571.020	608.646	552.703	538.116	555.840
Gjirokastrë	484.715	513.997	498.763	514.626	547.816
Korçë	352.739	362.168	369.389	400.373	402.597
Kukës	361.596	325.978	317.715	316.750	326.756
Lezhë	309.085	351.432	362.572	394.816	401.157
Shkodër	343.817	342.497	365.513	382.464	389.247
Tiranë	624.590	643.998	686.571	691.556	746.780
Vlorë	430.265	435.137	430.954	462.850	454.123
Shqipëria	466.326	482.956	497.903	511.972	539.866

* Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

Tab. 5 Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, AL=100

(në %)

Qarqet	2013	2014	2015	2016	2017*
Berat	75,50	78,05	80,23	83,22	83,59
Dibër	67,16	68,71	72,35	75,08	74,95
Durrës	100,83	96,53	100,93	99,98	99,24
Elbasan	73,36	73,09	69,60	71,17	69,87
Fier	122,45	126,03	111,01	105,11	102,96
Gjirokastrë	103,94	106,43	100,17	100,52	101,47
Korçë	75,64	74,99	74,19	78,20	74,57
Kukës	77,54	67,50	63,81	61,87	60,53
Lezhë	66,28	72,77	72,82	77,12	74,31
Shkodër	73,73	70,92	73,41	74,70	72,10
Tiranë	133,94	133,35	137,89	135,08	138,33
Vlorë	92,27	90,10	86,55	90,41	84,12
Shqipëria	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00

* Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

Tab. 6 Struktura e VSHB-së e ndarë sipas degëve të ekonomisë dhe qarqeve për vitin 2017* (Dega=100%)

(në %)

Qarqet	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
Berat	8,51	3,39	3,02	1,98	1,78	1,93	1,89	0,86	3,38	1,58	3,77
Dibër	5,77	6,79	1,29	1,29	1,37	1,84	1,54	0,50	3,44	0,63	3,22
Durrës	7,28	13,98	11,05	13,53	4,70	5,57	13,76	8,26	6,32	7,70	9,92
Elbasan	12,25	8,50	4,52	4,59	3,42	4,86	5,51	1,81	6,78	3,45	6,84
Fier	22,45	13,16	7,39	6,95	6,00	7,91	6,98	4,11	6,36	3,14	10,76
Gjirokastrë	2,97	1,42	2,60	2,33	1,66	3,00	1,64	0,85	2,71	2,36	2,28
Korçë	10,53	3,32	4,03	4,59	2,63	5,44	4,36	1,30	5,50	5,23	5,51
Kukës	3,02	1,82	0,87	0,68	1,18	1,31	1,02	0,51	2,51	0,85	1,65
Lezhë	4,84	1,98	4,89	2,76	1,49	3,50	3,11	1,09	3,57	2,21	3,31
Shkodër	7,57	6,02	4,59	3,82	2,83	4,11	5,10	2,37	5,66	3,24	5,18
Tiranë	7,68	35,17	49,92	51,81	69,53	54,95	47,69	75,95	48,37	66,25	42,03
Vlorë	7,14	4,46	5,81	5,66	3,43	5,58	7,40	2,38	5,40	3,36	5,53
Shqipëria	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00

*Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

Tab. 7 Struktura e VSHB-së e ndarë sipas degëve të ekonomisë dhe qarqeve për vitin 2017* (Rajoni=100%)

(në %)

Qarqet	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
Berat	49,12	11,52	8,40	9,70	1,67	1,46	3,22	1,63	12,00	1,28	100,00
Dibër	39,07	27,08	4,21	7,38	1,50	1,64	3,08	1,12	14,33	0,60	100,00
Durrës	15,97	18,08	11,70	25,14	1,67	1,60	8,93	5,99	8,55	2,37	100,00
Elbasan	39,00	15,94	6,95	12,39	1,77	2,03	5,19	1,90	13,30	1,54	100,00
Fier	45,40	15,68	7,21	11,90	1,97	2,10	4,18	2,74	7,92	0,89	100,00
Gjirokastrë	28,37	8,01	12,00	18,85	2,57	3,77	4,63	2,69	15,95	3,16	100,00
Korçë	41,60	7,74	7,69	15,38	1,68	2,82	5,10	1,70	13,40	2,90	100,00
Kukës	39,83	14,09	5,51	7,64	2,52	2,27	3,96	2,23	20,40	1,57	100,00
Lezhë	31,83	7,68	15,51	15,41	1,59	3,03	6,06	2,38	14,47	2,04	100,00
Shkodër	31,82	14,91	9,31	13,60	1,93	2,27	6,34	3,28	14,64	1,91	100,00
Tiranë	3,97	10,73	12,47	22,72	5,84	3,74	7,31	12,99	15,43	4,80	100,00
Vlorë	28,07	10,34	11,02	18,85	2,18	2,88	8,61	3,10	13,09	1,85	100,00
Shqipëria	21,77	12,83	10,50	18,44	3,53	2,86	6,44	7,19	13,41	3,05	100,00

*Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmë-finale
Burimi: INSTAT

INSTAT kryen vlerësimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) sipas qarqeve duke u mbështetur kryesisht në metodën e prodhimit, e cila rezulton që të shprehë më mirë PBB sipas qarqeve bazuar në informacionin e disponueshëm. Llogaritjet e PBB-së përfshijnë të gjitha prodhimet e shërbimet aktuale të destinuara

për treg si dhe ato të prodhuara për konsum vetjak nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin të cilësuar “ekonomik” të Shqipërisë. PBB me metodën e prodhimit shpreh shumë më vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ekonomisë duke shtuar taksat e tatimit dhe duke zbritur subvencionet mbi produktet.

Burimi i të dhënave

Për vlerësimin e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT-it (anketa të ndryshme) ose i institucioneve të tjera kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe të tjera.

Konceptet dhe klasifikimet e përdorura

Llogaritë Rajonale në Republikën e Shqipërisë bazohen në të njëjtat koncepte të Sistemit European të Llogarive Kombëtare (ESA), versioni kombëtar i Nomenklaturave të Veprimtarive Ekonomike të miratuara nga nomenklatura ESA dhe e përdorur gjerësisht në Llogaritë Kombëtare. Llogaritë Rajonale sigurojnë një ndarje rajonale për agregatët më të rëndësishëm si Vlera e Shtuar Bruto (VSHB), Produkti i Brendshëm Bruto, etj, sipas degëve kryesore të ekonomisë. Me vlerësimin e Llogarive Rajonale diferencat strukturore rajonale, zhvillimet e ekonomisë bëhen më të dukshme.

Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se VSHB duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Klasifikimi i njësive statistikore

Disa nga çështjet specifike të Llogarive Rajonale lidhen me klasifikimin e përshtatshëm të njësive sipas rajoneve. Në Llogaritë rajonale vetëm njësia (ndërmarrja) dhe vendndodhja e saj nuk mjafton, por kërkohet informacion tjetër më i detajuar si psh. njësitë e aktivitetit ekonomik lokal (Local KAU). KAU lokale është një njësi institucionale e ndodhur në një rajon. Kjo është e identifikuar me rajonin ku është dhe qendra e interesit: rajoni ku KAU lokale ndodhet fizikisht.

Trajtimi i njësive multi-rajonale

Mjaft njësi prodhuese kanë filiale në më shumë se një rajon dhe janë aktive në më shumë se një degë të ekonomisë. Dega ku kjo njësi do të klasifikohet duhet t'i korrespondojë njësive lokale. Trajtimi i njësive multi-rajonale dhe njësive që kanë disa aktivitete

është i njëjtë me trajtimin që bëhet nga Llogaritë Kombëtare Vjetore. Analiza fillon me përcaktimin e aktivitetit kryesor që ushtron njësia aktivitetit dytësor dhe aktivitetet ndihmëse. Aktiviteti kryesor i një njësie lokale (local KAU) është aktiviteti ku vlera e shtuar është më e lartë se në aktivitetet e tjera që ushtron njësia. Një aktivitet dytësor është aktiviteti i cili ndërmerret si aktivitet shtesë së bashku me aktivitetin kryesor.

Një vështrim i përgjithshëm i metodologjisë

Vlerësimet janë në përputhje me Sistemin European të Llogarive Kombëtare (ESA) të cilat konsistojnë në një kombinim të metodave kryesore sipas Manualit të ESA Kapitulli 13:

- Metoda Poshtë-Lart
- Metoda Lart-Poshtë
- Metoda Pseudo-Poshtë-Lart (Mikse)

Në vlerësimin e Llogarive Rajonale, Vlera e Shtuar Bruto llogaritet me çmime të vitit të kaluar. Në llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore, VSHB kalohet me çmimet e tregut. Kjo arrihet me mbledhjen e taksave dhe zbritjen e subvencioneve sipas produkteve. Taksat dhe subvencionet janë shpërndarë sipas strukturës së VSHB-së. Në llogaritjen e indikatorëve rajonalë me çmime të vitit të mëparshëm, janë përdorur deflatorët vjetorë sipas degëve të ekonomisë.

Trajtimi i aktiviteteve ndihmëse

Njësia bazë e përpilimit të Llogarive rajonale është njësia lokale. Një njësi institucionale mund të përbëhet nga më shumë se një njësi lokale, e lokalizuar në më shumë se një rajon statistikor. Në momentin aktual nuk ka të dhëna sipas njësive lokale dhe degëve të ekonomisë për aktivitetet ndihmëse.

Krahasueshmëria në kohë

INSTAT publikon treguesit rajonalë në koherencë me zhvillimet dhe revizionimet e metodologjisë së Llogarive Kombëtare Vjetore. Rezultatet për çdo vit vlerësohen nga të dhëna të detajuara. Në rast se të dhënat mbi njësitë lokale mungojnë treguesit rajonalë vlerësohen duke marrë në konsideratë strukturën e vlerës së shtuar të një viti referencë.



17. FINANCAT PUBLIKE

Qeverisja vendore luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në zhvillimin ekonomik lokal por edhe në atë kombëtar.

Financat Publike të qeverisjes vendore mundësojnë të dhëna mbi financat vendore në mënyrë sistematike dhe transparente. Menaxhimi i ketyre financave në mënyrë efëçente ka si qëllim kryesor uljen e nivelit të pabarazisë ndërmjet bashkive dhe rritjen e nivelit të shërbimeve të ofruara.

Burimi i të dhënave për financat publike për njësitë e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë (bashkitë) është Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit, SIFQ) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE).

Karakteristikat të përgjithshme sipas bashkive

Financat publike vendore janë thelbësore për një qeverisje sa më të mirë dhe të pavarur. Disa prej treguesve më të rëndësishëm që shprehin zhvillimin social-ekonomik të një njësie të qeverisjes vendore janë:

- madhësia e buxhetit të bashkive;
- totali i të ardhurave të bashkive sipas burimit të financimit;
- totali i shpenzimeve të bashkive sipas burimit të financimit;
- totali i shpenzimeve të bashkive sipas funksionit (COFOG);
- totali i investimeve të sipas bashkive.

Madhësia e buxhetit të bashkive

Burimet financiare të disponueshme për shumicën e bashkive rezultojnë të jenë rritur në terma nominalë vitet e fundit. Shpërndarja e buxhetit vendor ndërmjet bashkive evidenton qartë diferencat ndërmjet tyre në terma nominalë, duke segmentuar bashkinë Tiranë si entitetin me buxhetin më të lartë krahasuar me bashkitë e tjera.

Krahas rritjes në terma nominalë të nivelit të buxhetit mesatar, gjerësia e variacionit (diferencës mes vlerës minimale dhe maksimale) ndërmjet bashkive është zgjeruar ndjeshëm. Këto diferenca vlerësohet të jenë të ndikuara kryesisht nga popullsia dhe numri i ndërmarrjeve të përqendruara në një territor të caktuar.

Pozicioni i bashkisë Tiranë në Republikën e Shqipërisë


Bashkia Tiranë, është një ndër bashkitë më të mëdha nga 61 njësitë e qeverisjes vendore. Disa nga faktorët kryesorë që e veçojnë nga bashkitë e tjera janë:

- Këtu janë të pozicionuara shumica e institucioneve qeveritare si dhe zyrat qëndrore të kompanive më të rëndësishme. Janë të përqendruara disa prej sektorëve kryesorë të ekonomisë si: dega e ndërtimit, tregtisë, administratës publike, shërbimeve (bankat, sigurimet, si dhe telekomunikacioni) etj.
- Niveli mesatar i pagave të punonjësve është më i lartë në krahasim me bashkitë e tjera.
- Fluksi hyrës i punonjësve që vijnë nga bashkitë e tjera.

Në grafikun 1. nuk është përfshirë bashkia Tiranë, duke e konsideruar si rast i veçantë, buxheti i së cilës zë 31,3 % të buxhetit të njërive të qeverisjes vendore.

Bashkitë me buxhetin më të lartë paraqiten bashkia Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër dhe Vlorë. Ndërsa, bashkitë me buxhetin më të ulët paraqiten bashkia Pustec, Libohovë, Konispol, Këlcyrë dhe Dropull. Bashkitë e tjera janë pothuajse në të njëjtin nivel të shpërndarjes së buxhetit të disponueshëm për njësitë e qeverisjes vendore.

Fig. 1 Madhësia e buxhetit sipas bashkive, 2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Të ardhurat vendore

Të ardhurat nga burimet e veta janë thelbësore për një qeverisje vendore të mirë dhe të pavarur. Të ardhurat e njëjseve të qeverisjes vendore, sipas burimit të financimit në nivel bashkie, janë të klasifikuara në disa kategori kryesore si më poshtë:

- *të ardhura tatimore* (ku bëjnë pjesë tatimi mbi të ardhurat personale; mbi fitimin dhe të ardhurat kapitale; tatimi mbi pasurinë; tatimi mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit);

- *të ardhura jo tatimore* (ku bëjnë pjesë të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia; të ardhura nga shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare);
- *grantet dhe të ardhura të tjera* (ku bëjnë pjesë të ardhurat nga grante korente; të ardhura financiare; të ardhura të jashtëzakonshme).

Fig. 2 Të ardhurat e bashkive sipas burimit të financimit, 2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Pjesën më të madhe e të ardhurave bashkitë i realizojnë nga qeveria qendrore, të klasifikuara në kategorinë “grantet dhe të ardhura të tjera”. Përjashtim bëjnë bashkia Tiranë, bashkia Vorë, bashkia Sarandë dhe bashkia Kamëz, ku të ardhurat nga “grantet dhe të ardhura të tjera” janë më të ulta krahasuar me “të ardhurat tatimore” dhe ato “jo-tatimore”.

Zgjerimi i hendekut të të ardhurave sipas burimit të financimit nuk është një fenomen i shtrirë në mënyrë homogjene ndërmjet bashkive, por është i udhëhequr nga ecuria e të ardhurave nga burime të veta në një numër të kufizuar bashkish dhe nën efektin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe nga ndërtimet e reja.

Shpenzimet vendore

Të dhënat mbi shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore, sipas burimit të financimit në nivel bashkie, janë të ndara në dy kategori kryesore:


shpenzime të kryera me fonde të veta të bashkive (ku përfshihen të ardhurat nga burimet e veta, taksat e ndara, transfertat e pakushtëzuar dhe specifike); shpenzime të kryera nga transfertat (ku do të përfshihen ato kategori shpenzimesh të mbuluara me fonde nga transfertat e kushtëzuara nga ministritë e linjës, përfshirë fondet për investime nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR).

Në kategorinë “shpenzimeve të kryera me fonde të veta”, përfshihen ato burime mbi të cilat bashkitë kanë të drejta vendimmarrjeje relative në lidhje me mënyrën e përdorimit.

Në kategorinë “shpenzime të kryera nga transfertat”, bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrjeje në lidhje me sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve; pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës (ndryshe, me destinacion të përcaktuar).

Pjesën më të madhe të shpenzimeve të kryera nga njësitë e qeverisjes vendore e zënë kryesisht transfertat e pushtetit qëndror krahasuar me shpenzimet të kryera nga fonde të veta. Shpenzimet gjithsej të qeverisjes vendore rezultojnë të jenë rritur vitet e fundit, ku rritjen më të lartë e ka pësuar kategoria “shpenzimet e personelit”, e ndikuar kryesisht nga rritja e pagave në sektorin shtetëror, rritja e numrit të punonjësve për shkak të transferimit të funksioneve të reja etj.

Fig. 3 Shpenzimet e bashkive sipas burimit të financimit, 2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet sipas funksionit të qeverisë (COFOG)


Të dhënat lidhur me shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore sipas funksioneve të qeverisë, në nivel bashkie janë të ndara në 10 kategori kryesore:

01. Shërbimet e përgjithshme publike
02. Mbrojtja
03. Rendi dhe siguria publike
04. Çështjet ekonomike
05. Mbrojtja e mjedisit
06. Strehimi dhe komoditetet e komunitetit
07. Shëndetësia
08. Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare
09. Arsimi
10. Mbrojtja sociale

Pjesën më të madhe të shpenzimeve, bashkitë e kyejnë kryesisht për kategoritë: “mbrojtjen sociale”, “shërbimet e përgjithshme publike”, “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” dhe “edukimin”. Pjesa tjetër e shpenzimeve për nga rëndësia, shkojnë për kategoritë: “çështjet ekonomike”, “argëtimi, kultura dhe çështjet fetare”.

Shpenzimet sipas funksionit për kategoritë: “mbrojtja”, “rendi dhe siguria publike”, “mbrojtja e mjedisit” dhe “shëndetësia” janë shpenzime të cilat kryhen nga qeveria qendrore dhe për këtë arsye shpenzimet për këto kategori mungojnë ose zënë një pjesë shumë të vogël.

Fig. 4 Shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore sipas funksioneve të qeverisë (COFOG-eng), 2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Investimet e qeverisjes vendore

Investimet publike të kryera nga bashkitë rezultojnë të jenë rritur vitet e fundit, kjo si pasojë e transfertave ndërqeveritare për shpenzime kapitale.

Në grafikun më poshtë paraqitet shpërdarja e investimeve sipas bashkive.

Në grafikun 5. nuk është përfshirë bashkia Tiranë, duke e konsideruar si rast i veçantë, niveli i investimeve të së cilës zë 39,9 % ndaj totalit të investimeve të njësive të qeverisjes vendore.

Fig. 5 Investimet e qeverisjes vendore, 2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpërndarja e investimeve evidenton qartë diferencat ndërmjet bashkive më të mëdha dhe atyre të vogla (duke patur parasysh sipërfaqen dhe popullsinë). Bashkitë me buxhetin më të lartë për investime të kryera paraqiten bashkia Kamëz, Durrës, Fier, Vorë dhe Korçë. Bashkitë me investimet më të ulta të kryera paraqiten bashkia Pustec, Belsh, Kukës, Mat dhe Konispol.

Burimi i të dhënave

Ministria e Financave dhe Ekonomisë